

ETIKA

Revistë edukative-kulturore

Shqipëri: 150 Lek

Kosovë: 1 Euro

Maqedoni: 60 Den

Europa: 2 Euro

Prill 2010 • Numri: 25 • E përmuajshme

Tevhidi njësia e Zotit

Thua: "Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm"

EDITORIAL

K

riteri i lumturisë për njeriun dhe i “mungesës së kësaj qetësie shpirtërore” qëndron tek marrëdhënia e tij me Allahun. Kjo është e vërteta bazë e njeriut. Njeriu që arrin ta ndërtojë këtë marrëdhënie mbi baza të shëndosha, do ta shijojë lumturinë në këtë jetë dhe në tjetrën, ndërsa ai që nuk arrin ta krijojë atë do ta ndajë fatin bashkë me disfatën. Prandaj, njeriu nuk ka rrugë tjetër përveçse të strehohet mirë e mirë tek Allahu.


Meqë Allahu na drejtohet ne njerëzve, duke na thënë që të “vrapojmë drejt Tij”, atëherë lumturi do të thotë të jesh përherë në gjendje vrapimi drejt Allahut, vrapim, përfundimi i të cilit shpresohet të na shndërrohet në gostinë e fjalëve: “Hyj në xhenetin Tim.”

Ah ne njerëzit!

Ka prej tyre që bëjnë idhuj me duart e tyre për t’i adhuruar, madje edhe idhuj prej ëmbëlsirash që kemi për t’i ngrënë kur të jemi të uritur. Gdhendim idhuj prej druri dhe prej hekuri, duke u përkulur para tyre me qetësinë e një akti adhurimi, megjithëse e dimë shumë mirë që ata as na shohin, as na dëgjojnë.

Pastaj njeriu mendoi se çdo gjë që e frikësonte si: dielli, hëna, yjet, zjarri, reja dhe rrufeja, meritonte të adhurohej, vetëm se asnjëra prej shmangieve nga rruga e drejtë, secila më vete një model primitiv adhurimi, nuk është aq e mjerueshme sa rasti, kur njeriu shndërron vetveten në idhull. Njeriu diti ti kalojë këto modele adhurimi atëherë, kur ai arriti të zbulonte nëpërmjet vahjit margaritarin, dinjitetin që mbante përbrenda qenies së tij. Vetëm adhurimi i vetvetes, që del në pah atëherë, kur ai pandeh se është sadopak i fuqishëm mbi të tjerët, u shndërrua në shkakun e mjerimit të njeriut, veçanërisht në këto shekujt e fundit.

Do të lexoni:



- Ahmet Tashgetiren / 4** Rendje pa fund
- Medet Bala / 8** Ebu Hanife si muhadith
- Harold Bloom / 10** Muhamedi
- Gençer Dërvari / 15** Teuhidi dhe domethënia e tij
- Idris Arpat / 18** Boshti i Teuhidit
(Njësimit të Allahut)
- Nexhat Ibrahim / 22** Tevhidi (monoteizmi), bazë e feve të shpallura
- Shemsettin Kirish / 26** Besimi është dashuri
- Zymer Ramadani / 28** Besimi, përkushtimi dhe veprat
- / 30** Një ajet
- / 31** Një hadith
- Osman Nuri Topbash / 32** Parimet e moralit të lartë

Ahmet Tashgetiren /
Rendje pa fund

4



Idris Arpat /
Boshti i Teuhidit

18



Osman Nuri Topbash /
Parimet e moralit të lartë

32



Viti: V | Numri: 25 | Prill 2010

Administrator i Progresi botime:
Shuaqip Bashhan
bashan43@hotmail.com
+355 69 20 76768

Drejtor & Kryeredaktor:
Alban Kali
albankali@yahoo.com
+355 69 24 23989

Përkthyesit:
Ervin Lani
Evans Drishti
Fatmir Sulaj
Ilir Hoxha

Redaktor letrar:
Shpëtim Kelmendi
Redaktor gjuhësor:
Ma. Irida Hoti

Dizajn - Grafik:
Bledar Xama
bledar_xama@hotmail.com

Për artikuj
e-mail: revistaetika@progresibotime.com
e-mail: kosova@progresibotime.com

Prill 2010

40

Mr. sci. Flamur Sofiu /

Sanksionet dhe masat ndëshkuese për vrasjen...



Mr. sci. Flamur Sofiu /40

Sanksionet dhe masat ndëshkuese për vrasjen dhe vetëvrasjen në të drejtën islame

46

Muhamed Sytari /

Teuhidi në vargjet e Hafiz Jusuf Këlmendit



Evans Drishti /44

Pse të përçahemi?

Muhamed Sytari /46

Teuhidi në vargjet e Hafiz Jusuf Këlmendit

Ma. Artur Tagani / 48

Vlera e shkencës dhe e teknologjisë në Islam

Mag. Ermal Nurja /50

Teqja Xhelvetija në Berat

Familja / 52

Televizioni dhe ndikimi i tij në formimin e fëmijëve

Teknologji / 54

Shpikje e rrallë
Kompjuter i shpejtë sa drita

Shëndeti / 56

Xhel për kurimin
e plagëve në kokë

Aktualitet / 58

Erdogan pret Topallin
Vendet tona faktor stabiliteti
në rajon

48

Ma. Artur Tagani /

Vlera e shkencës dhe e teknologjisë në Islam



PROGRESI
BOTIME
www.progresibotime.com

Adresa:

L: Vasil Shanto / Rr: Çajupi

Shkodër / Albania

Tel: +355 22 254 534

Fax: +355 22 254 533

Zyra e përfaqësimit Maqedoni

Rr. Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25

Shkup / Maqedoni

+389 71 956 271

Zyra e përfaqësimit Kosovë:

Rr. Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin

Prizren / Kosovë

Tel: +381 29 222 795

Fax: +381 29 222 797

+377 441 63 651

Çmimi:

Shqipëri: 150 Lekë

Abonim (një vjetor) : 1500 Lekë

Kosovë: 1 Euro


Abonim (një vjetor): 10 Euro

Maqedoni: 60 DEN

Abonim (një vjetor): 600 DEN

Europë: 2 Euro

Abonim (një vjetor): 24 Euro



Rendje pa fund

Ahmet Tashgetiren

Kriteri i lumturisë për njeriun dhe i “mungesës së kësaj qetësie shpirtërore” qëndron tek marrëdhënia e tij me Allahun. Kjo është e vërteta bazë e njeriut. Njeriu që arrin ta ndërtojë këtë marrëdhënie mbi baza të shëndosha, do ta shijojë lumturinë në këtë jetë dhe në tjetrën, ndërsa ai që nuk arrin ta krijojë atë do ta ndajë fatin bashkë me disfatën. Prandaj, njeriu nuk ka rrugë tjetër përveçse të strehohet mirë e mirë tek Allahu.

Meqë Allahu na drejtohet ne njerëzve, duke na thënë që të “vrapojmë drejt Tij”, atëherë lumturi do të thotë të jesh përherë në gjendje vrapimi drejt Allahut, vrapim, përfundimi i të cilit shpresohet të na shndërron në gostinë e fjalëve: “Hyj në xhenetin Tim.”

Ah ne njerëzit!

Ka prej tyre që bëjnë idhuj me duart e tyre për t'i adhuruar, madje edhe idhuj prej ëmbëlsirash që kemi për t'i ngrënë kur të jemi të uritur. Gdhendim idhuj

prej druri dhe prej hekuri, duke u përkulur para tyre me qetësinë e një akti adhurimi, megjithëse e dimë shumë mirë që ata as na shohin, as na dëgjojnë.

Pastaj njeriu mendoi se çdo gjë që e frikësonte si: dielli, hëna, yjet, zjarri, reja dhe rrufeja, meritonte të adhurohej, vetëm se asnjëra prej shmangieve nga rruga e drejtë, secila më vete një model primitiv adhurimi, nuk është aq e mjerueshme sa rasti, kur njeriu shndërron vetveten në idhull. Njeriu diti ti kalojë këto modele adhurimi atëherë, kur ai arriti të zbulonte nëpërmjet vahjit margaritarin, dinjitetin që mbante përbrenda qenies së tij. Vetëm adhurimi i vetvetes, që del në pah atëherë, kur ai pandeh se është sadopak i fuqishëm mbi të tjerët, u shndërrua në shkakun e mjerimit të njeriut, veçanërisht në këto shekujt e fundit.

Faraoni e kishte shndërruar në idhull pushtetin që kishte dhe priste nga njerëzit që ta adhuronin, duke

menduar se fuqia politike qe një dimension prej hyjnie. Ai mendonte se mund të përcaktonte çdo gjë. Shprehej se mund të lindte njerëzit, duke mos i vrarë, dhe të shkaktonte vdekjen e tyre duke i ekzekutuar. Megjithëse nuk arrinte ta bënte diellin të lindte nga perëndonte, ai mendonte se mund t'i pengonte njerëzit ndaj besimit. Fundi i tij qe disfata para ujit që Allahu e bëri më të fuqishëm se Faraoni.

Karuni kishte shndërruar në idhull pasurinë. Ai besonte se paratë i fitonte vetëm në sajë të fuqisë së tij dhe se paraja ishte vlera më e lartë, duke e shndërruar atë në simbolin e fuqisë që mund të përcaktojë çdo gjë. Megjithëse vetja i dukej i plotfuqishëm, në të vërtetë ai qe bërë skllavi i parasë. Edhe ai nuk mundi ta shpëtonte veten nga fundosja brenda tokës, me gjithë thesarin që kishte. Ajo që ai mori me vete, ashtu siç ngjan edhe me të gjithë ata që nxjerrin në pah egon e tyre përpara Allahut, qe vetëm mjerimi.

Që nga shekulli XIX njeriu u njoh më nga afër me fuqinë shkencore dhe filloi të zbulojë njëra pas tjetrës ligjin e Allahut të vendosur tek çdo krijesë. Mjeti që përdorte teksa zbulonte, ishte mendja e dhuruar nga Allahu. Zbulimet e tij qenë kriteret që fuqia hyjnore kishte vendosur në thelbin e krijesave. Allahu dëshironte që njeriu t'i zbulonte ato, në mënyrë që të përfitonte prej tyre. Me kohë, Ai kishte shpallur se çdo gjë që ka krijuar ia kishte paraqitur njeriut për të mirën e tij. Madje edhe kur e krijoi njeriun e parë, i mësoi atij emrat e të gjitha sendeve; kushedi, mbase edhe ia kishte gdhendur në kujtesën e tij. Njeriu e kishte harruar edhe këtë program hyjnor dhe kishte pandehur se çdo gjë ekziston vetvetiu. Mendja ishte si të thuash një dhunti e krijuar vetvetiu për njeriun..., edhe gjithësia po ashtu. Për këtë arsye, njeriu mbetej i habitur përpara çdo gjëje të re që zbulonte, duke i hiperbolizuar zbulimet që bënte. Në fund fare, ai anoi drejt adhurimit të intelektit të tij, duke u arratisur nga shtëpia e Allahut dhe duke e harruar Atë i tha: "Unë". Zoti na kishte treguar për këtë dobësi të njeriut: **"Për vërtetë që njeriu shkel çdo cak, kur mendon se është i vetëmjaftueshëm."** (Alak, 6-7.)

Ai kishte imituar zogun për të ndërtuar avionin, kishte imituar peshkun për të ndërtuar anijen. Dukej se mund të zëvendësonte me anë të protezave dorën dhe këmbën e humbur. Ai e përkufizonte veten si "kri-




jesa që di të ndërtojë mjete". Prodhimin e mjeteve dhe pajisjeve ai e shihte si një akt krijimi, si edhe zbulimet e tij në fushën elektroniko-kompjuterike, prodhimet e robotëve. Kushedi sa shpresa mbante edhe për realizimin e ëndrrës së njeriut artificial, por përbrenda kishte një brengë që quhej vdekje, të cilën ai nuk mund ta harronte, ndonëse Allahun e kishte harruar. Vdekja ia prishte të gjithë ëndrrat e tij për fuqinë hyjnore të njeriut. Edhe njerëzit që ishin treguar aq kokëfortë përpara mesazhit të Allahut, kishin vdekur që të gjithë njëri pas tjetrit.

Për ku udhëtonin?

Po të kishte edhe një botë tjetër përtej vdekjes. Po të gjenin në atë anë Allahun duke u thënë: **"Për ku po shkoni?"** (Tekvir, 26.)

"Në të vërtetë, kthimi është te Zoti yt!" (Alak, 8.)

Njeriu nisi të mendonte për një kohë të gjatë në lidhje me këtë. Ai duhet të triumfonte mbi vdekjen. Ndoshta atëherë ai bënte llogari të thoshte me zë të lartë: "Nuk do të vij tek bota jote, ku do të më duhet



të jap llogari.” dhe u përpoq ta arrinte këtë gjë. Punoi në lidhje me qelizat, me gjenet, me të moshuarit dhe të rinjtë.

Vallë a nuk do të mund të zbulonte eliksirin e pavdekshmërisë?

A mund të shpresohet tek bio-teknologjia?

Nëse në një anë njeriu kërkonte eliksirin e pavdekshmërisë, në mënyrë që të zotëronte fuqinë e Allahut për të krijuar dhe për të zhdukur, si dhe për të zhdukur nga bota e tij ditën e llogarisë, nga ana tjetër ai pa se përherë e më shumë ai po e shndërronte veten në një makinë vdekjeje. Ai mund të vriste llojin e tij, madje edhe të vetëvritej. Përfundimet shkencore që ai i arrinte me qëllim që ti falte përjetësinë qenies njerëzore, ktheheshin në njësi teknologjike që e vinin më shpejt në punë makinën e vdekjes.

Dy luftërat botërore shkaktuan vdekjen dhjetëra miliona njerëzve, në sajë të teknologjisë moderne. Pa dyshim që fuqia nukleare nuk qe zbuluar në mënyrë që ta shndërronte në pluhur njerëzimin, Hiroshimën dhe Nagasakin vetëm për tre sekonda, por ky qe rezultati. Edhe bimët narkotike nuk u kultivuan për t'u bërë një asgjësues vrasës për trurin e të rinjve, por ato shkatërronin aq jetë njerëzish, po aq sa shpëtonin. Teknologjia moderne përpigëj të përgatiste një horizont pavdekësie për njeriun, por nga ana tjetër zhvishte shpatën për të mbytur edhe embrionin në bark të nënës. Transplantimi i organeve qe një arritje në mjekësinë moderne, por ama kush do t'i pengonte ata që do t'i përdornin njerëzit që jetonin si “depo e organeve rezervë”, me qëllim që të gjendej organi i duhur për t'u transplantuar. Kush duhej të jetonte?, Kush duhej të vdiste?, Kush duhet të vendoste për këtë?

Më në fund pyetja mori trajtën: A ishte fuqia diçka që do t'i jepej njeriut, pa e bërë atë të varur nga ndonjë kriter?

Kjo pyetje u bë shtylla themelore në gjithë fushat e jetës moderne të njeriut që kishte marrë arratinë nga shtëpia e Allahut, sepse njeriu filloi t'i formonte vepimet e tij në një fushë që formësohej prej forcës dhe fuqisë. I forti meritonte të merrte pjesën e luanit në çdo gjë, “egoja” përcaktonte çdo gjë. Procesi që zinte fill prej shekullit të XIX-të, me mohimin e një fuqie madhështore, që sundonte gjithësinë, do të formonte

një tablo vlerash që fillonin dhe arrinin tek njeriu dhe do të shndërrohej në një sistem ku të dilte në pah hegjemonia e njeriut të fortë. Çdo shpirt do ta shpallte veten “Perëndi”, ndërsa më të fortët ndërmjet tyre do të diktonin rregullat. Kjo do të thoshte luftë e pandërprerë, kaos. Me fjalorin e Kuranit, “fesad”. Për shkak të zgjedhjes që kishte bërë, njeriu do të kishte kishte këtë përfundim. Disa naivë shpresonin në formimin e një strukture morale që përjashtonte “të shenjtën”. Kjo strukturë do të ishte “moral i laik”. Njerëzit do të formonin një tablo vlerash madhështore në mesin e tyre, të cilat nuk do të kishin asnjë referim tek hyjnorja. Kjo nuk ngjau. Nuk mund të ngjante. Si mund të mos e frymëzonte “epshi” i kthyer në idhull, dëshirat “epshore” të njeriut. Çdo njeri apo shoqëri njerëzore u pri drejt shndërrimit të epsheve në vlera madhështore. Po që se zotëronte fuqi atëherë kërkonte nënshtrim në mënyrë të ndërgjegjshme apo të pandërgjegjshme. Në fund, njeri i takoi të përdorte dhunë, ndërsa tjetrit të dhunohej. Kjo ishte gjendja e njeriut modern. Tashmë formimi i vlerave sublime përcaktohej sipas vullnetit të atij që kishte para, ushtri dhe medie më të fuqishme se sa të tjerët.

A u bë i lumtur njeriu?

Jo! Ai tani gjendet i zhytur në një krizë të thellë.

Tani njeriu është edhe një herë tjetër në provë. “Shekulli i vrasjeve me ndërgjegje të ftohtë”, do ta cilësonte një mendimtar këtë shekull. Njeriu siguroi mundësi të mjaftueshme teknologjike që të mund të vriste tjetrin, ndoshta edhe për ta shuar fare racën njerëzore. Popujt e vjetër u varrosën, si rezultat i fatkeqësive natyrore. Njeriu që e kishte kthyer në idhull vetveten dukej sikur do ta ngulte me dorën e vet thikën në zemër. Ose njeriu do të provojë të zbulojë sërish natyrën e tij të pastër me të cilën është krijuar, ose rregulli që “njeriu është ujë për njeriun” do të vazhdojë të veprojë derisa ta shuajë fare racën njerëzore.

Sa bomba atomike mjaftojnë që ti japin fund kësaj bote?!

Zoti i bën thirrje njeriut me këto fjalë: “Vraponi drejt Allahut!”. Në një ajet tjetër ai thërret “Vraponi drejt xhenetit!”.

Sa madhështore është kjo ftesë! Si mund të qëndrojnë njeriu moskokëçarës ndaj kësaj ftese? T’ju thërrasë



Zoti juaj dhe ju mos t’ia vini veshin. Kjo s’mund të bëhet.

Allahu thotë: *“Unë i krijova xhindët dhe njerëzit që vetëm të më adhurojnë, prandaj mos i bëni shok Allahut.”* (Dhariat, 56, 51)

Ai vendosi në thelbin tonë ndërgjegjen e të qenit rob.

Njeriu ekziston vetëm së bashku me Allahun. Nëse ai krijon një lidhje me zemër me Allahun, do të bëhet i lumtur. Vrap i njeriut drejt Allahut është vrap që Zoti i tha të fillonte që në botën e shpirtave. Nëse njeriu del jashtë kësaj rruge, nuk do të bëjë gjë tjetër përveçse padrejtësi ndaj vetes së tij. Allahu nuk dëshiron që njeriu ta bëjë këtë gjë.

Sa i mëshirshëm dhe i dhembshur është Ai me robërit e Tij.

Ebu Hanife si muhadith

Rrustem Spahiu

MUSNEDI I EBU HANIFES

Përmbledhjet më të njohura të hadithit të krijuara në këtë mënyrë janë:

1. *Kitabu-l-asar*, i Ebu Jusufit,
2. *Kitabu-l-asari-l-merfu'a* i Muhammed b. Hasan esh-Shejbanit,
3. *Kitabu-l-asari-l-merfu'ati ve-l-mevkufe*, të të njëjtit mbledhës,
4. *Musnedi* i Hasan b. Zijad el-Lu'lu'it,
5. *Musnedi* i Hammadit, djalit të Ebu Hanifes.

Ebu-l-Muejjid el-Havarizmi (vd. 665 H.) në librin e tij të vëllimshëm, rreth 800 faqe, titulluar *Xhamiu'u-l-mesani*d, të cilin e ka klasifikuar sipas çështjeve të fikhut, duke lënë mënjanë senede që përsëriten, deklaroi: *I kam dëgjuar në Sham disa injorantë duke minimizuar dhe ulur vlerën e Ebu Hanifes, duke i atribouar atij njohje të dobët të hadithit, duke konsideruar se nuk ka musned të vetin, siç ka imam Shafiu apo Muvetta, apo çfarë ka krijuar imam Malik. Kjo më shtyu të përmbledhja pesëmbëdhjetë musnedë të Ebu Hanifes, të cilët i kanë mbledhur ekspertë të shquar të hadithit.*

Muhadithi i shquar i Shamit Shemsuddin b. Tuluni në veprën e tij *El-Fehrestu-l-evasatu* dhe hafëzi i njohur Egjiptit i hadithit, Muhammed b. Jusuf es-Salihani, në librin e tij *Ukudu-l-xhiman*, theksojnë se i kanë dëgjuar dhe shënuar hadithet që transmeton

Ummeti islam ka nxjerrë nga gjiri i vet një numër të madh dijetarësh të shquar, të cilët me jetën, punën dhe vlerat morale, e veçanërisht me fuqinë intelektuale, kanë lënë gjurmë të thella e të pashlyeshme në faqet e historisë së gjatë të njerëzimit. Mes këtyre dinjitarëve, gjithsesi, duhet përmendur Ebu Hanifen, personin me fuqi të jashtëzakonshme intelektuale, thellësi të pashembullt shpirtërore dhe tipare të veçanta karakteristike.

Vendimet e veta, Ebu Hanife i ka marrë duke shfrytëzuar ajetet kuranore dhe shumë hadithe. Ai, si rrallë kush i ka shfrytëzuar të mirat e aftësive intelektuale me të cilat e ka pajisur Allahu. Në të vërtetë, ky është virtyti që i karakterizon njerëzit e urtë! Allahu u ka dhënë mendjen njerëzve që ta shfrytëzojnë. Prandaj imam Maliku, duke folur për përfundimet logjike dhe superioritetin me rastin e diskutimeve të Ebu Hanifes, kishte deklaruar: *Sikur të donte ta bindte personin me të cilin diskutonte, se një shtyllë e thjeshtë është prej ari, ai mund ta bënte këtë!*

Dallimi ndërmjet Ebu Hanifes dhe muhadithëve të tjerë qëndron në faktin se ai nuk ka shkruar hadithe dhe nuk ka sajuar përmbledhje hadithesh, siç kanë bërë Maliku dhe Ahmedi, por këtë punë ia kishte lënë në dorë nxënësve të vet. Kështu, theksohet se nxënësit e tij, duke e dëgjuar, kanë krijuar një numër të konsiderueshëm musnedësh.

Ebu Hanife. Kështu Es-Salihani deklaroi: *Ebu Hanife ka qenë një prej hafidhëve të mëdhenj dhe sikur të mos ekzistonte interesimi i tij i jashtëzakonshëm për hadithin, nuk do të ishte e mundur të zgjidhte shumë çështje juridike të Sheriatit.*

Disa njerëz mendojnë se Ebu Hanife e ka shfrytëzuar shumë pak hadithin, gabim në të cilin janë zhytur falë supozimit që në Kufa hadithi njihej shumë pak, meqenëse ajo ishte qendër e hadithit dhe muhadithëve. Mirëpo, është e qartë se harrohet që Kufa, pikërisht në kohën e Ebu Hanifes, ka qenë qendër e madhe shkencore islame, harrohet fakti se Ebu Hanife ka udhëtuar shumë edhe në qendra të tjera të kësaj kohe dhe se, në këtë mënyrë, ka mësuar shumë versione të hadithit.

Nga ana tjetër, me themelimin e Kufës, në vitin 17 H., ky qytet do të shndërrohet në epiqendër të sahabëve të shquar. Dihet se Omeri, (r.a.), e kishte dërguar në Kufa Abdullah b. Mes'udin, (r.a.), i cili ka qenë njohës i shquar i një numri të madh të transmetimeve që janë përmendur në shumë përmbledhje të hadithit. Përndryshe, ai vetë transmeton 848 hadithe nga Pejgamberi, (s.a.v.s.) Krahës kësaj, dihet që Ibni Mes'udi, (r.a.) është konsideruar si një ndër sahabet më të ditur të Pejgamberi të Allahut (s.a.v.s.). Nëse përmendet edhe fakti se ky sahab i shquar ka vdekur në Kufa në vitin 32 H., atëherë kjo e plotëson në masë të madhe tablonë për mundësinë e veprimtimit të tij në atë vend dhe lënien e ndikimit të madh dhe gjurmëve të thella tek dijetarët, të cilët do të jetojnë më pas.

A E KA PREFERUAR EBU HANIFE ANALOGJINË NË RAPORT ME HADITHIN?

Ibni Abdu-l-Berri thekson një transmetim të Ebu Hanifes, në të cilin ai e nënvizon në mënyrë të qartë qëndrimin e tij në lidhje me këtë çështje, ku bën fjalë për paqëndrueshmërinë e akuzës, e cila përmendte disa burime. Ebu Hanife deklaroi: *Allahu e mallkoftë atë që e kundërshton Pejgamberin e Allahut (s.a.v.s.) me të cilin Allahu na ka nderuar dhe shpëtuar.*

INTERESIMI I EBU HANIFES PËR HADITHIN DHE SHKENCËN E HADITHIT

Që në rini Ebu Hanife kishte filluar të interesohet për hadithin dhe shkencën e hadithit. Muhadithët e shquar dhe kritikët e hadithit përmendin interesimin

e tij për hadith dhe udhëtimet në kërkim të haditheve të reja. Kështu, hafëzi i njohur i hadithit Edh-Dhehebi pohon se Ebu Hanife ka treguar interes të jashtëzakonshëm ndaj transmetimeve të hadithit dhe se ka udhëtuar shumë në kërkim të tyre.

Në një vend tjetër pohon: *Ebu Hanife me të vërtetë ka hequr shumë mund në kërkim të haditheve dhe kjo është vërejtur në veçanti pas vitit 100 H.*

Imam Abdu-l-Vehab esh-Sha'rani thekson se Ebu Hanife i kishte mësuar hadithet përmes mësuesit të tij Ata's, dhe se Ata's ka qenë nxënës i Ibni Abbasit (r.a.)

FAMA E EBU HANIFES NË SHKENCËN E HADITHIT

Numri më i madh i dijetarëve, në veprat e tyre e konfirmojnë imametin e këtij gjeniu në hadith dhe në shkencën e hadithit. Kështu, Ebu Davud es-Sixhistani, autori i shquar i *Sunenit*, i njërës prej gjashtë përmbledhjeve më të njohura të hadithit, pohon: *Allahu e mëshiroftë Malikun, Shafiun dhe Ebu Hanifen, të cilët kanë qenë imamë në hadith!*

Ibni Tejmijje flet me respekt të madh për Ebu Hanifen, duke e konsideruar atë një prej imamëve më të shquar dhe duke përmendur faktin se është më i ditur dhe fakih më i mirë se Tahavi dhe të ngjashmit me të! Në një vend tjetër, Ibni Tejmijje thekson se katër imamet e shquar kanë qenë imamë edhe në hadith, edhe në tefsir, edhe në tesavvuf edhe në fikh!

Njohja e hadithit në mënyrë të jashtëzakonshme është theksuar në mënyrë të qartë nga imam Es-Serhasi, i cili pohon: *Ebu Hanife ka qenë njohësi më i mirë i hadithit në kohën e vet! Mirëpo, për shkak të kriterëve të tij të rrepta në lidhje me saktësinë e ravigjës dhe kujdesit të tepruar që tregonte, me synimin që transmetimet e dobëta të mos ngatërrohen me ato autentike, ka transmetuar pak hadithe.*

MUSNEDI NË GJUHËN BOSHNJAKE DHE SHQIPE

E gjithë kjo që u tha më sipër lidhur me këtë dijetar të shquar islam është shumë pak dhe e parëndësishme kundrejt veprës që e ka lënë pas vete dhe ndikimit të cilin e ka ushtruar tek miliona myslimanë anë e kënd botës, e në veçanti tek ne myslimanët e Ballkanit, që kemi përvetësuar shkollën e tij juridike që prej ardhjes së Osmanlinjve e deri në ditët e sotme.



MUHAMEDI

Muhammedi (a.s.) dhe Kurani parë me syrin e një perëndimori

Harold Bloom

vijon nga numri i kaluar

Iezusi, fjala mëshirëplotë, e ndërroi Torën me Krishtërimin e Sh. Palit; Muhamedi e ktheu prapë këtë ndërrim, por jo duke u kthyer përsëri te Tora, por duke bashkuar Shkrimin e Shenjtë me Shkrimin e tij. Kurani nuk është as zëvendësim i vërtetë i Biblës Hebraike, as komentues i saj, por më tepër një recital përsiatës që nuk lodhet kurrë duke qortuar dhe aluduar ato histori, të cilat tregojnë për profetë – për Adamin, Noen, Moisiun, Jezuin – dhe për disa patriarkë, mbretër dhe personazhe të tjerë të rëndësishëm çifutë dhe pastaj për sekuestrimin e arabëve myslimanë: Historitë për Abrahamin, Jozefin, Davidin dhe Solomonin. Megjithëse, sfondi çifut mbetet gjithnjë i dukshëm, tekefundit në Kuran nuk ka asgjë që lexuesve jomyslimanë të mos u kujtohet Shkrimi i vjetër i Shenjtë. Sipas Muhamedit, Bibla Hebraike kthehet sërish nga e kaluara vetëm si mbartës i ngjyrave, i tingujve dhe i kup-timeve të vetë shpalljes së tij – si një keqkuptim krijues i shpalljes së Adamit, Noes, Moisiut dhe Jezuit. Një pjesë përbërëse thelbësore e këtyre deformimeve të shëmtuara është shndërrimi i zhvilluar në një rrafsh të gjërë nga rrëfimi në lirikë: Gjithçka bëhet psalm, bëhet poezi pro-

zaikë e Zotit, i cili veç se hedh shikimin edhe njëherë nga të dërguarit e mëparshëm për t'i dhënë fund njëherë e përgjithmonë rapsodisë së Tij të përpunuar.

“Populli i Kuranit”, një komunitet i pavlerësuar në krahasim me të mbijetuarit e “Popullit të Librit”, ka një lidhje shumë të ngjashme me Shkrimet e tij, ashtu siç e kanë pasur edhe besimtarët çifutë me Shkrimet e tyre. Të dy Shkrimet e Shenjta rrethohen nga një oqean i fuqishëm komentesh dhe trajtohen si vepra të Zotit, pra si krijime ende të gjalla. Të dy këto Shkrime përshkohen nga lutja dhe përgjigjja hyjnore e lutjes, por megjithatë ka një ndryshim vendimtar mes Biblës Hebraike dhe Kuranit: Vetë Muhamedi mbahet si interpretuesi kryesor i librit, të cilin Zoti ia diktoi përmes Gabrielit. Kjo do të thotë se trashëgimia e profetit dhe e shoqëruesve të tij ka një autoritet të pashoq, kur bëhet fjalë për ekspozimin e Kuranit. Megjithatë në lidhje me këtë ka padyshim analogji në Judaizëm, por për çifutët as edhe Moisiu nuk e merr atë lloj pozicioni vetmitar dhe vendimtar siç e merr Muhamedi për Islamin. Ndaj shumë lexues jomyslimanë e përceptojnë edhe si diçka misterioze faktin që Kurani na transmeton aq pak për personalitetin e Muhamedit në krahasim me ndërmjetësimin e detajuar dhe nënshtrues së natyrës dhe mëshirës së Zotit. Nga këndvështrimi i Islamit, kjo është padyshim e caktuar, por sidoqoftë mbase shtohen edhe vështirësi të tjera, të cilat për një individualist këtu* është e vlefshme t'i kapërcejë.

Në librin e tij “Studimet e Kuranit” (Qur’anic Studies), John Eansbrough e rendit botën e Kuranit në katër kategori bazë: Ndëshkim, shenjë, syrgjyn dhe bashkim. Ndëshkimet e lëshuara nga Zoti vulosin gjithnjë fatin e kombeve, qyteteve dhe popujve, të cilët nuk përballuan sprovat e Zotit; shenjën e jep Zoti, ose Ai autentizon profetin; syrgjyni, veçoria e të drejtit Abraham, përsëritet te Hixhri i Muhamedit, ose te arratisja nga Meka në Medinë, gjë që e karakterizon tradicionalisht fillimin e epokës islame; dhe së fundi, bashkimi lidhet në mënyrë qartë me profetët e vjetër – Noen, Abrahamin, Moisiun dhe Jezusin, por theksi vihet mbi Moisiun, i cili me sa duket Muhamedit i ngjall më shumë respekt se gjithë të tjerët. Secila nga këto katër kategori, për nga forma, duken jo vetëm tepër hebraike, por mua më duket se edhe në Kuran nuk kanë qenë kurrë tamam të Muhamedit. Megjithatë, origjinaliteti i Kuranit nuk ka të bëjë aspak me



çështje idesh apo personash. Ai mbështetet te diçka tjetër, pikërisht në rolin absolut dhe pa kompromis të Profetit si një enë gjaku që përcjell zërin e Zotit. Forca retorike dhe depërtuese e Muhamedit dëshmon intensitetin e plotë të saj përmes atij fakti që do mund të quhej krijimi i ri i besimit të Abrahamit, pavarësisht se si mund të jetë dukur ky besim në zanafillën e tij. I detyruar të biesh në gjunjë nga barra e fuqishme e zërit të Zotit, lexuesi është së fundi më se i bindur, që shenjat e bashkimit sillen kundër tij dhe që ai kërcënohet me ndëshkim dhe syrgjyn, nëse nuk e pranon nënshtrimin ndaj Zotit:

Bismil – lahirr Rrahmanirr Rrahim

1. Beto hem në Ditën e Kiametit!
2. Beto hem në shpirtin qortues!
3. A mendon njeriu se nuk do të mund t'i mbledhim eshtrat e tij?!
4. Po, si jo! Ne jemi të Zotë t'ia ribëjmë bashkë me përsosmëri edhe majat e gishtave të tij.
5. Por njeriu dëshiron të gabojë sa të jetë gjallë dhe pyet: “Kur do të jetë Dita e Kiametit?”



6. Por, kur sytë t'i verbohën dhe të zihet Hëna dhe Dielli e Hëna të bashkohen atë ditë njeriu do të thotë: "Ku të iki?"

7. Askund! S'ka strehë!

8. Atë ditë, streha është te Zoti yt.

9. Atë ditë njeriu do të vihet në dijeni për veprat që ka bërë dhe për ato që ka lënë pa bërë.

(Surja 75, El-Kijame)

Fuqia dhe ana direkte e kësaj Sureje duket e paarritshme, por nuk është burimore, ngaqë ka ngjashmëri me precedentin biblik. Këtu është origjinale vetëm mënyra karakteristike e zbutur dhe e thurur për të trajtuar premisat biblike. Toni i tij përmban gjithnjë një kulm polemik. Kjo i jep dhe i siguron autoritet Muhamedit, ngaqë nuk e lejon lexuesin të gjejë rehati për asnjë çast. Natyrisht që fshikullimet janë një karakteristikë retorike e shpeshtë si te Bibla Hebraike, ashtu edhe e Dhjata e Re, por të dy këto shkrime mezi e vijnë në këtë frymë kaq të palodhur si në Kuran. Autoriteti spiritual i palodhur kërkon dhe provon, sido që të jenë implikimet politike, përputhshmërinë në stilin e veçantë të Kuranit, prej të cilit mund të tërhiqesh

veç me shumë mundim. Larmia e formave është një pretendim stilistik, të cilit në mundohemi t'i përshtatemi kudo, por që ka më pak kuptim, nëse kërkohet prej nesh të dëgjojmë zërin e Allahut.

Lufta e Muhamedit përmban vetëm rrallë konfrontime direkte me tekstet e Torës apo t'Ungjijve. Mbase ai i është shmangur atyre, por ka më shumë mundësi që të mos i ketë njohur fare. Ai dinte rreth trashëgimisë rabinike me shkrim dhe me gojë, e ato ishin gjithçka ai donte apo çka i nevojitej. Sidomos Suret e hershme në Mekë kanë një madhështi konstante:

Bismil-lahirr Rrahmanirr Rrahim

1. Betohem për muzgun e agimit dhe për dhjetë netët (e para të muajit Dhul Hixhxe)!

2. Betohem për çiftin dhe tekun dhe për natën kur largohet!

3. A nuk janë këto betime të mëdha për njerëzit e mençur?!

4. Vallë, a nuk e di ti se çfarë ka bërë Zoti yt me fisin Ad, banorë të Iremi me pallate shumëshyllëshe, të atillë që nuk janë krijuar askund tjetër në tokë si ata?!

5. Dhe me fisin Themud, që gdhendi shkëmbinjtë në luginë?

6. Dhe me Faraonin, njeriun e hunjve (ku torturon-te njerëzit)?

7. Të gjithë këta shkelën çdo kufi në vendet e tyre, duke shtuar atje shthurjen dhe korrupsionin, ndaj Zoti yt lëshoi mbi ta kamxhikun e dënimit.

8. Vërtet, Zoti yt është gjithnjë në pritë!

9. Sa i takon njeriut, kur Zoti i tij e sprovon atë, duke e ngritur lart dhe duke i dhënë mirësi, ai thotë: "Zoti im më ka nderuar."

10. Por, kur e sprovon atë, duke ia ngushtuar mjetet e jetesës, ai thotë: "Zoti im më ka poshtëruar."

(Surja 89, El-Fexhr)

"Dhjetë netët e para" janë dhjetë netët e para dhe të fundit të muajit sipas kalendarit hënor dhe shenja e krijimit dhe e shkatërrimit të gjithçkaje nën hënë, edhe të kopshteve legjendare të fisit Ad nga Iremi, edhe Themudit, qytetit të shkatërruar nga tërmeti, apo edhe shkatërrimi i faraonit që tallej me Moisiun. Krijimi dhe shkatërrimi paralel i fatit të çdo njeriu transmetohet në formë të pamëshirshme dhe me ekonomi të madhe retorike përmes fjalisë: "Vërtet, Zoti yt është gjithnjë në pritë." Ashtu si Surja 75, e cila na flet po

shkoqur për një shpallje të hershme në Mekë, ky psalm përfaqëson atë që do mund ta quanim Muhamedi në fillimin e vet, se ai e theksonte pakrahasueshmërinë me Allahun dhe krijesat e tij dhe në të gjitha shpalljet e tij më të hershme, Muhamedi ngjan me faktin paradoks të Jahvistin, të autores së teksteve të mahnitshëm, që krijuan themelin e atyre librave, të cilët sot i njohim si: Gjeneza, Eksodi dhe Numeri. Allahu, “i vetmi Zot”, ka qenë më i madhi shumë kohë përpara Muhamedit dhe i vetmi, të cilit nuk i është krijuar një imazh idhulli në Mekën pagane. Francis E. Peters e mban këtë shmangie të imazhit të Allahut në librin e tij “Muhamedi dhe origjinat e Islamit” si provë ndikimi gjithnjë në rritje, të cilën kristiano-çifutët e kishin në Arabi para epokës së Muhamedit, se në Ka’bë, vendi i shenjtë i Mekës, që qe ndërtuar nga Abrahami dhe i biri i tij Jishmaeli, të parët e gjithë myslimanëve të Arabisë, njerëzit kishin ndarë edhe imazhe të zotave të tjerë me pronën e Allahut. Thuhet se shtëpia e Zotit në Mekë qe rindërtuar nga Abrahami gjatë një vizite të i biri i tij Jishmaeli, në po atë vend ku Adami kishte ndërtuar një faltore. Dhe me sa duket, ndërtesa prej guri e Ka’bës në Mekën e vjetër kishte strehuar statujat e Abrahamit dhe Jezuit, që do të thotë se paganizmi paraislamik në Mekë kishte qenë shumë eklektik dhe kundrejt elementeve të tij çifut dhe kristian mbahet dukshëm si paraardhës i Islamit, por megjithatë, Allahu, i cili flet përmes Sureve të hershme të Muhamedit në Mekë, nuk ishte më Allahu i paganëve të Mekës, por tashmë Zoti biblik i Abrahamit, Noes, Moisiut dhe Jezuit, ai Zot çifuto-kristian, i cili në formë paradoksale është si krejtësisht transhendent, ashtu sikundër edhe plotësisht imanent.

Muhamedi ishte profet dhe jo teolog. Kurani na mëson për personalitetin dhe karakterin e Allahut, por nuk denjon që me shkrimet deskriptive dhe argumentuese të na bëjë të ditur diçka edhe për natyrën e brendshme të Zotit. Megjithëse dy rrymat kryesore të Islamit, që herë pas here janë në konflikt me njëra-tjetrën, Sunitë dhe Shiitë, provojnë kundrejt Kuranit ortodoksinë e tyre dhe e shohin njëri-tjetrin si bashkësi heretikësh, një jomysliman nuk do mundej kurrë të gjykonte se kush i qëndron më shumë besnik Kuranit, Kajro apo Teherani. Muhamedi na shpjegon pa rezerva, se ai është vula e profetëve, krahas së cilit nuk mund të ketë asnjë tjetër; dhe me të vërtetë që atëherë nuk u shpall si Profet qoftë edhe një mysliman, pavarësisht cilës rrymë i takon. Të gjitha herezitë myslima-



ne (nëse mund t'i quajmë kështu) lindin nga çështje interpretimi, jo ndryshe nga Judaizmi postbiblik dhe nga Krishtërimi. Natyrisht që Islami është aq i rreptë, sa që vetëm ekspozimi i Islamit klasik mbase na largon më shumë nga recitimi i Muhamedit se sa ç'mund ta bënte çdo ekspozim çifut apo kristian i Biblës Hebraike. Kurani nuk përshkohet vetëm nga një plotësim dhe përfundim retorik, por edhe nga një thjeshtësi që kërkon nderim aq të thellë, sa që lexuesi fillimisht reagon i zemëruar ndaj komenteve. Bibla Hebraike, e parë si në tërësi ashtu edhe në pjesët e saj, është një tekst jashtëzakonisht i vështirë; Dhjata e Re ka shumë pjesë konfuze dhe kontradiktore. Ndërsa Kurani na duket çuditërisht i kthjellët, i qartë dhe si një vepër më se konsistente në vetvete dhe jashtëzakonisht koherente. Megjithëse ky efekt retorik është padyshim një iluzion, por është gjithashtu një karakteristikë e rëndësishme e Kur'anit, ashtu si përpunimi këmbëngulës i Muhamedit, që thuhet se ka lidhje me historitë dhe episodet biblike. Si *lakuriqësia* e palatuar (le ta quajmë kështu) e vizioneve të Kuranit, ashtu edhe kthimi revizionist i tij te feja autentike e Abrahamit, janë aq absolute, sa që një lexues jomysliman, kur nde-



shet me teologjinë islame, mezi mund ta lidhë atë me origjinën kur'anike.

Nga përvoja ime e pasur me letërsinë më duhet të pohoj tani që Bibla Hebraike mezi më lë të njëjtën përshtypje ashtu si Kurani, sidomos në rrafshin estetik. Nganjëherë, kur thellohem në të, më kujtohet Ëilliam Blake, apo Ëalt Ëhitman; në momente tjera më shkon mendja te Dante, të cilit me siguri do t'i ishte dukur blasfemike. Pjesërisht këto analogji dalin në pah nga autoriteti personal i një zëri profetik: Dante, Blake, edhe Ëhitman-i në pasazhet e tij të vetëdijshme, i afrohen një zëri hyjnor, dhe është pikërisht ky zë, të cilin e dëgjojmë pandërprerje nga Kurani, por ka edhe një element të dytë dhe ky ka të bëjë me shpalljen e Profetit, që madje edhe në Kuran vringëllon, por te Dante, Blake dhe Ëhitman-i paraqitet më haptazi. Kurani është një poezi prozaike, profetike dhe voluminoze, që thekson qendrën dhe vijueshmërinë e traditës së profetëve. I dërguari i Allahut, i cili në fillim të misionit të tij ishte aq i vetmuar, i drejtohet ndërkaq një komuniteti besimtarësh dhe barra e profecisë së tij qëndron si në rikrijimin e traditës, ashtu edhe në syni-

min për të shkuar përtej traditës dhe për të mbërritur atje, ku vetë profecia do mbetet prapa përmbushjes së saj. Këtu Kurani shfaqet misterioz dhe, sipas mistikëve islamë dhe Sufive ai ofron ndoshta më shumë autorizim se sa teokratët islamë të të gjitha tipeve dhe kombeve. Po ç'është Kurani vallë? Mund të jetë gjithçka tjetër, përveçse një libër i mbyllur, edhe nëse nxjerr në pah vulën e çdo profecie. Ashtu si Bibla, apo si vepra e Dantes, madje edhe si ajo e Shekspirit, Kurani është libri i jetës dhe po aq vital si çdo njeri i çfarëdo ngjyreje dhe meqë Zoti i drejtohet të gjithëve, që janë të gatshëm ta dëgjojnë, edhe Kurani është një libër universal e gjithashtu i hapur e dorëdhënës, ashtu si veprat e mëdha të letërsisë sekulare, si kryeveprat e Shekspirit dhe Servantesit. Sufitë e gjetën qendrën e tyre te Surja 24, paragrafi 35; një fragment madhështor për "Dritën" e Zotit, një Pean (hymn) mbi universalizmin bindës të Profetit poet, Muhamedit.

Allahu është Drita e qiejve dhe e Tokës. Drita e Tij shëmbëllen me atë të një kamareje, në të cilën ndodhet një llambë. Llamba është brenda një kristali, kurse kristali është si një yll i shndritshëm. Ajo (llamba) ndizet nga druri i bekuar i ullirit, që nuk rritet as në lindje, as në perëndim, ndërsa vaji i saj shkëlqen pa e prekur zjarri. Dritë mbi dritë! Allahu udhëzon drejt Dritës së Tij kë të dojë dhe nxjerr shëmbëllime për njerëzit. Dija e Allahut mbulon gjithçka. (Surja En-Nur)

Kjo është poezi perfekte, një mrekulli, dhe natyrisht aspak sektare: "Dritë mbi dritë!" Ndoshta me "Kamarenë" nënkuptohet zemra e Muhamedit, por tekefundit nënkuptohet çdo zemër që kupton. "Allahu udhëzon drejt Dritës së Tij kë të dojë." "Druri i bekuar i ullirit" nuk është as i Orientit, as i Oksidentit, ai është kudo dhe askund, kudo dhe kurdo të shkëlqejë një vizion i kulluar. Po ta shohim këtë rapsodi entuziaste të Dritës si një provokim për ndjesinë e pastër estetike, atëherë ajo mund të jetë e krahasueshme vetëm me teofaninë domethënëse të Dantes, Blake-ut, apo apostrofët biblike dhe postbiblike, të cilat luten për ndriçim çlirues. Kjo mrekulli është vetëm një fragment nga Kurani dhe një provë e mëtëjshme e domethënies së tij, si libër themelor për çdo njeri.



Tevhidi dhe domethënia e tij

Gëzicer Dërvari

“Zoti juaj është një Zot i vetëm! S’ka Zot tjetër (të denjë për adhurim), përveç Atij, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit!” (El Bekare, 163)

Sipas kuptimit etimologjik, Tevhid do të thotë: Të bërit e një sendi një të vetëm, duke e ndarë nga të tjerat.

Sipas kuptimit terminologjik është besimi në Allah në mënyrë absolute se Ai është një, nuk ka të adhuruar përveç Tij, dhe se Ai është larg në njësim nga të tjerët, ndërsa në kuptim të gjerë Tevhidi është:

Besimi në Njësinë e Allahut, në krijimin (Rububijen) e Tij, në adhurimin (Uluhijen) e Tij, në emrat dhe cilësitë e Tij (Esma ve Sifat). Qëllimi i Tevhidit

është njësimi i Allahut dhe të pranuarit e Tij si të vetëm. Sipas thënies së Kuranit Famëlartë, të mos ketë në asnjë mënyrë diçka të ngjashme me Atë.

Tevhidi është detyra më e rëndësishme, nevoja më e domosdoshme, qëllimi më i madh dhe parësor, me të cilin Allahu i Madhëruar krijoi krijesat. Pra, Ai i krijoi ata për vënien në jetë të njësimin të Allahut.

Allahu xh. sh. thotë: ***“Thuaj: ‘Çdo lavd e falenderim i përket Allahut, i Cili nuk ka bir, nuk ka ortak në pushtet dhe nuk është i pafuqishëm, që të ketë nevojë për ndihmës’ dhe madhëroje Atë, duke ngritur lart madhësitinë e Tij!’*** (Isra, 111)



Detyra më e madhe me të cilën Allahu i detyroi robërit e Tij është Tevhidi. Për këtë arsye, Ai dërgoi pejgamberët, zbriti librat nëpërmjet të cilëve shpalli lumturinë në këtë botë dhe në botën tjetër. Lumturia në këtë botë dhe në botën tjetër arrihet me njësimin e Allahut të Madhëruar.

Allahu xh. sh. thotë: **“Ata që besuan dhe besimin e tyre nuk e përzien me besim të kotë...”**, pra, nuk e përzien njësimin e tyre me shirk.

Allahu i Madhëruar i krijoi **xhindët dhe njerëzit** duke u dhënë çdo gjë që u nevojitet për ekzistencën e tyre, me qëllim që ata ta adhurojnë Atë.

Allahu xh. sh. thotë:

“Xhindët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë. Une nuk kërkoj prej tyre risk, as nuk dëshiroj që të Më ushqejnë. Vërtet, Allahu është Furnizuesi i vetëm, i Fuqishmi, i Plotpushtetshmi.” (Dharijat, 56 - 58.)

Pra, qëllimi i krijimit të njerëzve dhe të xhindëve

është vetëm adhurimi i Allahut xh. sh. Ai nuk është nevojtar për krijesat e tij, nuk është nevojtar për adhurimet e tyre. Ai meriton lavdërime dhe falënderime dhe vetëm urdhërat e tij zbatohen.

E që të gjitha këto nuk i bëjnë dobi Allahut të Madhëruar, pasi Ai është i begatshëm, i falënderuar. Allahu nuk i bën dobi dëgjueshmëria e atij që i bindet dhe as nuk dëmtohet nga mosbindja e keqbërësit.

Të Lartmadhëruarit nuk i bën dobi njësimi i atij, i cili e njëson Atë, ashtu siç nuk i bën dëm as mosbesimi i ndokujt. Allahu xh. sh. thotë: **“Kush zgjedh rrugën e drejtë, e ka për veten e vet e kush i largohet asaj, i largohet në dëm të vetvetës...”** (Isra, 15.)

Nuk gabojmë nëse themi se kuptimi i tevhidit është hyrja nga dera e Islamit, por ata që hyjnë nga kjo derë duhet të zbatojnë çdo kusht themelor të besimit dhe Ai ka premtuar se do ta zbatojë atë në jetën e përditshme.

Tevhidi është të jetuarit, duke filluar që nga përditshmëria, nënshtrimi ndaj urdhërave të Allahut të Madhëruar e mbrojtja e rregullave dhe e ligjeve të parashtruara nga Allahu (xh.sh.)

Besimi nuk realizohet pa iu nënshtruar Allahut (xh.sh.), pa besuar në cilësitë absolute të Tij, pa besuar në faktin se Ai as nuk ka lindur e as nuk është i lindur, dhe se askush nuk është i barabartë me Të. Tevhidi ndahet në dy lloje:

1. Tevhidi Rububije
2. Tevhidi Uluhije

Tevhidi Rububije është Njësimi, të veçuarit e Allahut në veprat e tij. Për t'a kuptuar këtë lloj tevhidi duhet të dimë kuptimin e fjalës Rububije. Fjala Rububije rrjedh nga fjala Rabb, që ka kuptimin Terbije - edukim. Po ashtu, përveç kësaj ka kuptimin e përmirësimit, rregullimit, të përfunduarit të një sendi, të udhëhequrit, të qenët pronar, të dhënit furnizim etj.

Tevhidi Rububije do të thotë që krijuesi i tokës dhe i qiejve është Allahu dhe se vetëm Atë duhet të adhurojmë, duke mos i bërë ortak-Shirk në asnjë send ndaj Krijuesit. Ky lloj Tevhidi është futur nga Allahu në zemrat e njerëzisë, ndërkohë që edhe nga mushrikët politeistë është pranuar Tevhidi Rububijen. Gjatë historisë janë devijuar vetëm pak njerëz nga Tevhidi Ru-

bubije, duke besuar dhe respektuar pastaj vetëm zotat e tyre të rremë.

Lidhur me këtë temë, Allahu (xh.sh.) ka thënë:

“Nëse ti i pyet ata: ‘Kush i krijoi qiejt e tokën, kush i nënshtroi (të lëvizin) diellin dhe hënën?’, Ata do të thonë: ‘Allahu’, e si prapësoheni, pra? Allahu i jep furnizimin atij që do nga robët e vet dhe ia pakëson (shtrëngon) atij që do. Vërtet, Allahu është i gjithëdijshtëm për çdo gjë.”

Dhe nëse ti i pyet Ata: “Kush e lëshon shiun nga qielli dhe me të e ngjall tokën pas vdekjes së saj?” Ata do të thonë: “Allahu”. Thuaj: “Falënderimi i qoftë Allahut, por shumica e tyre nuk mendojnë.” (Ankebut 61- 63.)

Nga këto ajete kuranore kuptojmë se njeriu nuk mund të hyjë në Fenë Islame vetëm me besimin në këtë lloj tevhidi. Nga ajetet e përmendura, edhe idhujtarët e Mekkes kanë dëshmuar Tevhidin Rububiye, që Ai është krijuesi dhe sunduesi i gjithësisë. Këtu hyn në lidhje lloji i dytë të tevhidit, për të qenë mysliman që beson në një Zot dhe për të shpëtuar nga dënimi i Xhehenemit.

Tevhidi Uluhije do të thotë: njësimi i Allahut në adhurim dhe të mos bërit ortak Atij. Të adhurojmë Allahun sipas caktimit të Tij dhe të jemi të lidhur me një zemër të sinqertë, duke shpresuar në mëshirën e Tij.

Kjo bëhet e mundur kur robi synon gjithmonë kënaqësinë e Allahut (xh.sh.) dhe i drejtohet vetëm Atij në çdo gjë, duke mos bërë asnjë ibadet për dikë tjetër përveçse për Allahun.

Allahu i Lartësuar thotë:

“Thuaj: **Namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për Allahun, Zotin e botëve.**” (En’amë, 162.)

Në lidhje me këtë lloj tevhidi ndodhi kundërshtimi i politeistëve (mushrikëve), kundërshtim që kishte të bënte me adhurimin vetëm të Allahut (xh.sh.), arsye për të cilën Allahu dërgoi Pejgamberë, në mënyrë që t’ua tërhiqte vëmendjen që të mos adhuronin askënd tjetër përveç Allahut (xh.sh.)

Allahu i Lartësuar thotë:

“Ne dërguam në çdo popull të dërguar që t’u thonë:



Adhuron vetëm Allahun, e largojuni djajve (adhurimit të tyre)!’, por pati nga ata që Allahu i udhëzoi dhe pati nga ata që ishin gjykuar me humbje.” (Nahl, 36.)

“Ne e patëm dërguar Nuhun te populli i vet, e Ai tha: O populli im, adhuron Allahun, nuk keni Zot tjetër përveç Tij. Unë kam frikë për dënimin tuaj në një ditë të madhe.” (A’raf, 59.)

Thelbi kryesor i Tevhidit është fjala Lâ ilâhe il-lâllâh. Kjo shprehje ka si qëllim lënien e çdo sendi jashtë Allahut (xh.sh.) dhe “Tevhidin uluhije” - adhurimin vetëm për Allahun (xh.sh.)

Allahu i Lartësuar thotë: ***“Kjo ngase Allahu është Ai i vërteti dhe atë që lusin ata përveç tij është kot. Allahu është vërtetë Ai i larti, i madhi.”***

Nga ajetet e përmendura kuptojmë se duhet të adhurojmë Allahun (xh.sh.) me sinqeritet, duke lënë jashtë besimit të gjithë llojet e shirkut. Bukuria e robit është të adhurojë Allahun Famëlartë vetëm sepse Ai është ZOT.

Boshti i Teuhidit

(Njësimit të Allahut)

Idris Arpat

Në themel të luftës së Profetëve ka dy parime universale të cilat nuk ndryshojnë asnjëherë: Teuhidi përballë shirkut (bërja shok Allahut), dhe drejtësia përballë dhunës.

Fjala teuhid do të thotë të njësosh, të bësh një, ndërsa si term, teuhid do të thotë të pranosh se Allahu Teala nuk ka të ngjashëm as në thelbin ekzistencial dhe as në thelbin cilësor. Fraza e teuhidit është një aforizëm, i cili shpreh obligimin që ka myslimani për të njësuar Allahun Teala dhe për këtë arsye, Profeti (s.a.u.s.) thotë: *“Ai që thotë, La ilahe il-lallah, shpëton.”*

Kur themi njëshmëria e Allahut, ajo që na vjen në mendje në fillim është njëshmëria në esencën e besimit, ndërsa njëshmëria me vepra është pika e dytë, e cila do të thotë se rregullat e vlerësimit të të gjitha veprimeve tona merren nga një burim i vetëm dhe ajo që është e lejueshme, përcaktohet nga këto rregulla.

Meqënëse tokat, qiejt, pasuria dhe bota e ekzistencës, bota e dukshme dhe e padukshme janë të Allahut Teala, edhe autoriteti dhe pushteti janë të Tijat.

Allahu Teala nuk ka të ngjashëm as në thelbin ekzis-

tencial dhe as në thelbin cilësor. Ai nuk është i lindur dhe s’ka lindur askënd. Cilësitë e Tij nuk kanë fund e kufi. (Shih. Sure Ihlas.)

Allahu Teala është Qenia Madhështore të cilin Kur’ani dhe Sunneti e përshkruajnë me 99 emrat më kryesorë. Ashtu sikur nuk e dimë se sa janë në të vërtetë emrat e Allahut, ashtu nuk mund të dijmë në mënyrë

“Thuaj: Namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për All-llahun, Zotin e botëve. Ai nuk ka shok (nuk adhuroj tjetër). Me këtë (thjeshtësi të adhurimit vetëm për Zotin) jam i urdhëruar dhe jam i pari i myslimanëve (i pari që pranoj dhe bindem)!”

të saktë se ç'kuptim kanë dhe se ç'farë ndikim ka pasqyrimi i tyre në jetën njerëzore dhe në univers. Kështu që, ato që dijmë për Allahun Teala nuk janë të qarta dhe të mjaftueshme. Sikur t'i njihnim të gjitha dimensionet e "Esmau'l Husna" (Emrat më të bukur të Allahut) dhe të merrnim mësim prej kësaj njohurie, do të zotëronim një botëkuptim më të bukur se atë që kemi sot dhe do të kishim një jetë më cilësore. Botëkuptimi ynë njerëzor dhe shikimi ynë kundrejt materiales do të ishte shumë më i ndryshëm dhe më me nivel.

Kuptimi i teuhidit (njëshmërisë) është i lidhur me kuptimin e "Esmau'l Husna". Nuk na hyn në punë një teuhid i kuptuar si: "Allahu është një dhe nuk është dy". Ç'është përmbajtja e kësaj njëshmërie dhe si pasqyrohet ajo në jetë? Çfarë botëkuptimi zgjon tek ata që e pranojnë? Kjo pra është edhe pika më e rëndësishme.

Allahu është zotërues i vullnetit dhe Krijuesi Madhështor. Ashtu siç ka caktuar ekzistencën e gjithçkaje, po ashtu cakton edhe qëllimin e saj. (Shih: Sure Nahl, 9.) Allahu rregullon të gjitha çështjet e jetës. Flamurtarët e teuhidit meditojnë për të gjitha çështjet që përmbajnë jetë. Ata zotërojnë një mënyrë shikimi kritik.

E kundërta e teuhidit është adhurimi i tagutit. Tagut është çdo lloj fuqie, institucion apo person, që merr mbi vete kompencat e Allahut dhe mundohet t'i skllavërojë dhe t'i bëjë njerëzit adhurues të tij. Taguti e vazhdon sundimin e vet duke prishur dhe shtrembëruar rregullat e besimit.

"Ju, në jetën tuaj mund të mos kryeni adhurime ndaj njerëzve sikur dilni përpara Allahut dhe falni namaz. Mund të mos prisni kurban për ta, mirëpo, kur këto njerëz ndalojnë diçka kundër vullnetit dhe dëshirës së Allahut, ju nuk i veproni dhe ruheni prej tyre. Dhe, megjithëse këto urdhëra dhe ndalesa bien në kundërshtim me urdhërat dhe ndalesat e Allahut, ju u bindeni atyre. Ja pra, kjo do të thotë shirk (t'i bësh shok Allahut)." (Prof. Dr. H. Karaman, Ensar Vakfi Bülteni Mart-Nisan 1993. s.6.)

Teuhid do të thotë, t'i bëhesh rob vetëm Allahut.

"Thuaj: Namazi im, kurbanimi im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për All-llahun, Zotin e botëve. Ai nuk ka shok (nuk adhuroj tjetër). Me këtë (thjeshtësi të adhurimit vetëm për Zotin) jam i urdhëruar dhe jam i pari i myslimanëve (i pari që pranoj dhe bindem)!" (En'am, 162-163.)



Profeti ynë (s.a.u.s.), urdhërohet që krahas adhurimit që bënin mushrikët ndaj putave (zota), tërë jetën e Tij t'ia përkushtonte vetëm Allahut Teala, me namazet, me kurbanet dhe me gjithë qenien e Tij, deri në vdekje, dhe të jetë myslimani i parë që e merr mbi vete këtë detyrë. Kështu, që të deklarojë me besim të plotë dhe të sigurt se kurrë nuk do të njohë zot tjetër përveç Allahut Teala. (Kur'an Yolu, 2. C.)

Pjesa "...Vetëm Ty të adhurojmë" do të thotë, besim, adhurim dhe rregull social. Fjalja "vetëm prej teje kërkojmë ndihmë", shpreh singleritetin dhe njësimin e Allahut me vepra (të mos e ulim kokën para askujt përveçse para Tij dhe të mos njohim askënd tjetër me cilësitë dhe kompetencat që i takojnë vetëm Atij). Fjalja "Udhëzoni (përforconi) në rrugën e drejtë!" mbart në vetvete, adhurimin, disiplinën, mendimin dhe moralin. (Kur'an Yolu, Shpjegimi i Sures Fatiha)

Meqenëse ne kemi premtuar se do të adhurojmë vetëm Allahun dhe jemi shprehur se jetën tonë ia kemi kushtuar vetëm Atij, do të thotë se ne kërkojmë një jetë, boshti i së cilës të jetë Allahu. Jeta që ka si bosht Allahun, është një jetë që ka për bosht Kuranin, Sun-



netin, natyrshmërinë dhe ndërgjegjen. Kurani dhe Sunneti janë shpallja e vullnetit hyjnor. Natyrshmëria është gjendja e parë e njeriut, e cila është rregulluar nga Allahu. Ndërsa ndërgjegjja është zëri i Allahut brenda nesh, i cili është futur në zemrën tonë.

“Jetën time ia kushtova Allahut” do të thotë: “Për mua, kënaqësia e Allahut është gjithmonë në plan të parë.”. Por ç’është e kundërta e kësaj? Ajo është të kushtuarit e jetës vetëm njeriut ose gjërave të tjera që janë nën nivelin e tij ose e thënë ndryshe të shpërdoruarit e jetës pas dëshirave dhe epsheve. Të kushtuarit e jetës një krijese me të njëjtin nivel, apo edhe më të ulët, nuk përputhet me urtësinë, por gjithashtu nuk është as diçka e logjikshme dhe e natyrshme.

Meqenëse zotëruesi i Tokës dhe i gjithë universit është Allahu i Madhëruar, ndërhyrja në to bëhet vetëm me vullnetin e Tij dhe me aq sa lejon Ai.

“La ilahe” është refuzimi i gabimeve dhe “il-lallah” është pranimi i së drejtës. Shkrimtarë dhe mendimtarë si Niçja, Sartri, Kamy dhe të tjerë, parullën “la ilahe” e përhapën në një fushë të gjerë, por nuk mundën të hynin në kopshtin e “il-lallah”. Kjo i çoi ata nga gabimi

në gabim. Dhe më në fund, ata u përpëlitën në moçalin e të pashpresëve dhe vuajtën shumë.

Nëse pranohen të drejtat pa u refuzuar gabimet, ndodh përplasja midis të vërtetës dhe të gabuarës. Kjo është një sintezë (lidhje) që tashmë e ka humbur interesin për të vërtetën. Ne myslimanët, ashtu siç jemi të urdhëruar të mos e fshehim të vërtetën, po ashtu jemi urdhëruar edhe të mos e ngatërrojmë të vërtetën me të pavërtetën. (Shih: Bakara, 42.)

E vërteta është ajo, e cila i përshtatet caktimit të Allahut, ndërsa e pavërteta është ajo e cila nuk i përshtatet atij. Teuhidi nuk i pranon as idetë e paqarta që do t’i ngatërrojnë mendjet. Çdo të thotë të rrih e të thuash “la ilahe”, ndërsa je duke i hedhur me dhjetra heshta të helmatisura mendjes dhe zemrës? Ashtu siç shprehet dhe Imam Gazzaliu, “Nëse ti nuk e kupton të vërtetën e teuhidit dhe të ndarjes që përmban “kelime-i teuhid” (fjala e njësimit të Allahut), atëherë ti nuk je duke thënë “la ilahe il-lallah”. Për këtë e ka fjalën edhe ajeti i nderuar kur shprehet: *“Mjerë për ata, të cilët nuk falen, janë të pakujdesshëm ndaj namazit”* (Maun 4-5.) Ne jemi të obliguar që më parë të kuptojmë pastaj të përkuptojmë, të dimë pastaj të flasim.

Ashtu si shprehja “Eudhu bil-lahi mineshejtani rrahim” nënkupton strehimin tek Allahu për t’u shmangur gabimeve, ashtu edhe shprehja “Bismil-lahi Rrahmani Rrahim” nënkupton pranimin e gjërave të drejta. Nga një këndvështrim, teuhid do të thotë, të jetosh jetën me qëllime të pastra, me rregulla të drejta dhe ndjenja të bukura. Për ne, burimi i së drejtës dhe së bukurës është Kurani Famëlartë dhe Sunneti i Profetit tonë (s.a.u.s.). Çdo rregull që përshtatet me Kuranin dhe Sunnetin është brenda kornizës Islame. Si myslimanë që jemi, duhet të studiojmë të gjithë kulturën botërore, dhe duke e pranuar çdo gjë të drejtë mund ta pasurojmë në përmasa të mëdha kulturën dhe botë-kuptimin tonë.

Teuhidi pasqyrohet në jetën tonë edhe si drejtësi dhe sinqeritet. Dhe nga ky pasqyrim, lind një pavarësi nga të tjerët, përveç Allahut, dhe një cilësi e mrekullueshme e jetës, sepse gjëja kryesore është që Allahu të pëlqejë qëllimin dhe veprën tonë. Veprat dhe qëllimet që do të paraqiten në një post më të lartë, duhet të jenë pa të meta. Nuk kërkohet pëlqimi i njerëzve, por i Allahut.

Ekzistenca dhe njëshmëria e Allahut e përfshin njeriun nga jashtë dhe nga brenda. *“Vërtet, ata dyshojnë në takimin me Zotin e tyre, por le ta dinë se Ai ka nën*


E ka përfshirë aq shumë sa që nuk ka asnjë gjethe që bie nga pema dhe Ai të mos e dijë. (Shih: Sure En’am 59.) Për këtë arsye, ashtu si zemra e myslimanit është e mbushur vazhdimisht me dashurinë ndaj Allahut, ashtu edhe çdo mrekulli në këtë botë ia mban gjallë emocionin hyjnor, ndërsa fryti i kësaj është mosdhënia rëndësi gjërave të kësaj bote, ose thënë ndryshe, të kalosh përfundimisht nga bota e vdekshme dhe të qëndrosh tek Allahu.

Teuhidi është përqendrimi i miliarda njerëzve në një qendër dhe në një zë dhe nga kjo, lindin rregulla dhe emocione të përbashkëta.

Njeriu do të përqendrohet tek zëri, i cili tregon për ngjarje shumë të rëndësishme si: ardhja dhe ikja nga kjo botë, një zëqë tregon një nga një çdo gjë që ka lidhje me jetën tjetër. Ky është një zë që e qetëson mendjen dhe shpirtin e njeriut.

Një pasqyrim tjetër i teuhidit në jetën e myslimanit është ajo që e bën atë (myslimanin) të marrë pjesë në korin kozmik. Teuhidi me gjithë universin rrotullohen vazhdimisht në të njëjtën qendër tërheqjeje. Besimtari, i cili mendon dhe e di se i gjithë universi i përshtatet ligjeve të Allahut, e ndien veten si vëllai i universit, ndërsa njeriu i përkulet ligjeve të shkruara, të gjitha krijesat e tjera u përkulen ligjeve të cilat Allahu ka caktuar për natyrën. Megjithatë, edhe në trupin e njeriut ka pjesë, të cilat u përkulen ligjeve natyrore si, rrahjet e zemrës, lëvizja e gjakut etj. Njeriu nuk duhet t’i bindet vullnetit të vet, por vullnetit të Allahut dhe nga kjo sigurisht që do të lindi vëllazëria fetare. Kështu që, midis njeriut dhe natyrës (botës) ka një lidhje vëllazërore dhe jo një luftë e përgjakshme për mbijetesë ashtu sikur pretendon filozofia materialiste. Nëse e shikojmë nga pikëpamja Islame, vëmë re se midis njeriut dhe natyrës nuk ka asnjë lloj përplasjeje, por në të kundërtën, shohim një sakrificë vëllazërore. Bota dhe krijesat që ndodhen në të, i janë vënë në shërbim njeriut dhe kaq! Në të njëjtën kohë, kjo është një kompetencë e kufizuar që i është dhënë njeriut, sepse, njeriu nuk është zoti i të gjitha këtyre krijesave, madje as edhe i trupit të tij, por veçse një ruajtës amaneti dhe patjetër që ruajtësi i amanetit duhet të jetë i sigurt (që e mban amanetin). Më i rëndësishëm është vullneti i Atij që jep amanetin.

Teuhid do të thotë, të dalësh prej moçalishtes së shumës dhe të futesh në ujërat e qarta dhe të ëmbla të njësisimit.



Teuhid do të thotë, qartësim i të vërtetave, metodave dhe rrugëve.

Teuhid do të thotë, të ecësh me hapa të sigurma në këtë botë.

Teuhid do të thotë, të përqafosh universin me një emocion të pasqor, të cilin na e ka futur në zemër zotëria e tij (universit).

Teuhid do të thotë, të shohësh botën e ngurtë dhe të ngushtë materiale nga majat e larta dhe madhështore të shpirtit.

Teuhid do të thotë të refuzosh shndërrimin në një qenie mekanike dhe të qëndrosh në rrugën e të qenit njerëzor.

Të gjitha krijesat iu bindën me dëshirë thirrjes së Allahut, gjithashtu edhe një pjesë e njerëzve, mirëpo, iblisi dhe shumica e njerëzve nuk morën pjesë në korin e teuhidit, madje nuk u mjaftuan me kaq, por u munduan ta sabotonin atë.

Sa guxim i çmendur!

Tevhidi (monoteizmi), bazë e feve të shpallura

اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ

Nexhat Ibrahim

1. Hyrje

Studimi më i hollësishëm i doktrinave të shumicës së feve botërore nxjerr në pah bazën e tyre të përbashkët; një pikënisje, një rrënjë, një burim, nga e cila ato pastaj degëzohen në forma të shumta, të cilat mund t'i vërejmë në historinë e religjionit njerëzor. Edhe pse kjo rrënjë dhe pikënisje e përbashkët shihet mjaft qartë në *fetë qiellore* (edjan'us-semavij), kjo nuk do të thotë se edhe fetë e tjera botërore, të cilat kanë pjesëtarë prej disa milionë banorësh, në lashtësi të mos kenë prejardhje të përbashkët. Për më tepër, kur Allahu xh. sh. në Kuran thotë:

وَإِنْ مِنْ أُمَّةٍ إِلَّا خَلَا فِيهَا نَذِيرٌ

“...nuk ka pasur asnjë popull që të mos i ketë ardhur paralajmërues.” (Fatir, 24)

وَلَقَدْ بَعَثْنَا فِي كُلِّ أُمَّةٍ رَسُولًا...

“Çdo popull i Ne i çuam një të dërguar...” (En-Nahl, 36)

Ky unitet *transhendent* i feve, siç quhet shpesh herë, që historikisht ka zgjuar interesimin e shumë filozofëve, ka ndezur entuziazmin fetar të mistikëve të të gjitha grupeve religjioze dhe është bërë objekt i studimeve të shumë ezoteristëve, si burim i pashtershëm i komentimeve të ndryshme sekrete dhe domethënies simbolike. Filozofët e quajnë zakonisht *filozofi e shpalljes* (Philosophia Perennis), kurse myslimanët ezoteristë e përcaktojnë si *tesavuf* vetvetiu. Sidoqoftë, ndonëse emërtimet ndryshojnë, neve na intereson se si e emërtoi Shpallja këtë pikënisje unike të të gjitha feve.

2. Feja si model

Si myslimanë, soditjet e sipërme do t'i ilustrojmë me ajetin fisnik të Kuranit:

فَأَقِمْ وَجْهَكَ لِلدِّينِ حَنِيفًا فِطْرَتَ اللَّهِ الَّتِي فَطَرَ النَّاسَ عَلَيْهَا لَا

تَبْدِيلَ لِحَلْقِ اللَّهِ ذَلِكَ الدِّينُ الْقَيِّمُ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ .

“Drejtobu me përkushtim në fenë e pastër monoteiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. S’ka ndryshim të krijimit të Allahut. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë.” (Er-Rrum, 30).

Ajeti kuranor provon qartë se së pari Allahu i madhërishëm e përcaktoi fenë e Tij dhe vetëm pastaj, sipas saj, e përshtati krijimin e Njeriut (Ademit), i cili këtë fe në këtë krijim do ta manifestojë.

Ekziston një fe model sipas së cilës është krijuar njeriu dhe e cila së këndejmi është burimore, natyrore e njeriut. Me këtë fe si prirje të tij kongjenitale lind çdo njeri, por të cilën mund ta ndryshojë familja, mjedisi dhe rrethanat e tjera të fuqishme ndikuese në të cilat jeton, zhvillohet, vepron dhe vdes njeriu.

Meqë krijues i kësaj feje universale të njeriut është Allahu i madhërishëm, së këndejmi del krejt e qartë se kjo është feja e vetme të cilën Ai e pranon dhe me të cilën Ai është i kënaqur.

إِنَّ الدِّينَ عِنْدَ اللَّهِ الْإِسْلَامُ ...

“Feja e vërtetë tek Allahu është vetëm islami...” (Ali Imran, 19.)

وَمَنْ يَتَّبِعْ غَيْرَ الْإِسْلَامِ دِينًا فَلَنْ يُقْبَلَ مِنْهُ وَهُوَ فِي الْآخِرَةِ مِنَ الْخَاسِرِينَ .

“Kush kërkon tjetër fe përveç islamit, nuk do t’i pranohet dhe ai në botën tjetër do të jetë i humbur.” (Ali Imran, 85.)

Islami, është feja e Allahut, sipas së cilës është formësuar krijimi i njeriut dhe e cila i është mbëltuar në natyrën e njeriut. Njeriu lind me Islam dhe pritet që me të jetojë dhe të vdesë. Por, a do të mbetet i tillë apo jo, kjo varet nga fakti se ku dhe në çfarë mjedisi jeton njeriu, gjë për të cilën flet qartë hadithi i njohur në mesin e dijetarëve, transmetuar nga Ebu Hurejre, e në të cilin Muhammedi (a.s.) thotë:

عن أبي هريرة رضي الله عنه قال: قال النبي صلى الله عليه وسلم:

كل مولود يولد على الفطرة فأبواه يهودانه أو ينصرانه أو يمجسانه ... متفق عليه.



“Çdo njeri lind në natyrën e pastër (në Islam), por janë prindërit ata që e hebreizojnë, e kristianizojnë ose e bëjnë zoroastrian (mexhus, adhurues të zjarrit)...” (Muttefekun alejh)

3. Esenca dhe forma e pikënisjes së përbashkët

Mos vallë përfundimi ynë do të thotë se religjionet e tjera në botën aktuale nuk kanë kurrfarë prejardhje qiellore?! Edhe pse mund të formohet një bindje e tillë, megjithatë mund të themi se Kurani e thotë qartë se librat e shenjtë fetare hebraike dhe kristiane, Tevratit dhe Inxhilit, janë të shpallura dhe myslimanët në këtë nuk mund të dyshojnë në asnjë mënyrë. Po ashtu, edhe dilemën se në një vend thuhet se *fe e pranuar është vetëm Islami*, kurse në vendet e tjera thuhet se Musai (a.s.), Davudi (a.s.), Isai (a.s.) kanë pranuar shpalljen e Tevratit, Zeburit dhe Inxhilit, mund ta sqarojmë se të gjithë peygamberët e Allahut nga Ademi (a.s.) e deri te Muhamedi (a.s.) kanë predikuar Islamin (monoteizmin) e mirëfilltë dhe se pjesa e ajetit kuranor *se vetëm islami do të pranohet*, por jo edhe fetë e tjera, nënkupton se do të refuzohen të gjitha ndërhyrjet njerëzore



që janë bërë në librat e shenjtë, Tëvrat, Zebur dhe Inxhil. Kjo do të thotë se termi “feja e Allahut, Islami si feja natyrore e njeriut” duhet të kundrohet në thelbin e saj, në formën e saj jashtëkohore, kundrejt formave historike, njerëzore, të cilat i njohim në historinë e kulturës dhe qytetërimit njerëzor.

Prandaj, Islami si fe natyrore e njeriut e ka formën e tij burimore, të pandryshueshme, të pandërhyrë historikisht, i cili i ruan shtyllat e tij nga Ademi (a.s.) e deri te Muhamedi (a.s.), por ka pasur disa paraqitje historike, të cilat kanë evoluuar në aspekt të dytësive dhe të praktikës, të cilat morën formën përfundimtare me Pejgamberin e fundit, Muhamedin (a.s.), si forma përfundimtare e Islamit, respektivisht si feja burimore, natyrore e njeriut.

Ky thelb i Islamit, përbëhet prej dy elementeve themelore dhe të amshueshme:

1) *Tevhidit (monoteizmit), njësisë së qenies së Allahut të madhërishëm.*

Feja natyrore e njeriut kërkon që të besohet në Një,

të vetmin Zot, që Atij mos t’ia konsiderojë në asnjë mënyrë dhe në asnjë formë të barabartë me Të (sepse të gjithë përveç Atij janë vetëm krijesa dhe robër të Tij dhe për Të të varura), dhe që askënd të mos e konsiderojë ndërmjetës ndërmjet Atij dhe krijesave të Tij.

2) *Dorëzimit dhe nënshtrimit të plotë, të singertë dhe të pakusht ndaj Allahut të madhërishëm.*

Njeriu duhet t’i dorëzohet krejt singërisht Zotit dhe këtë ta konfirmojë me nënshtrim dhe me pasimin e Pejgamberit të caktuar, të dërguar në kohën e caktuar dhe me pasimin e feligjit të shpallur në këtë kohë.

Në këtë aspekt, të gjithë ata që e pasuan thirrjen e Musait (a.s.) dhe e besuan si të vetëm, të Madhin Zot duke e pasuar Tëvratin si libër të Allahut dhe duke e zbatuar feligjin e Musait (a.s.), kanë qenë “të nënshtruar, dorëzuar Zotit”, respektivisht kanë qenë myslimanë. Po ashtu, edhe të gjithë ata që e pranuan dhe ndoqën Isain (a.s.) dhe Inxhilin dhe adhuruan Një Zot sipas feligjit të atëhershëm që e ndiqte edhe Isai (a.s.), kanë qenë myslimanë.

Kjo na jep të kuptojmë se feja e Musait dhe Isait (a.s.) janë vetëm dy forma historike të një feje natyrore, burimore të Allahut të Madhërishëm, por që kanë qenë të kufizuara në kohë e hapësirë. Edhe shpallja e dërguar Muhamedit (a.s.) është një nga këto forma historike, por është forma përfundimtare, gjithëkohore dhe gjithëhapësinore deri në Ditën e Gjykimit.

Gjithashtu, kuptojmë se format religjioze nën emrat judaizëm dhe krishterizëm në bazën, rrënjën dhe thelbin e tyre, jashtë shtresimeve historike, njerëzore, kanë formën e vjetër të Islamit, formën e fesë natyrore të njeriut. Këtë bazë e zotërojnë të gjitha fetë qiellore, pra edhe ato që sot nuk i njohim, apo i njohim në forma të deformuara, por këtë bazë nuk e zotërojnë vetëm idetë (religjionet), të cilat nuk janë bazuar në Shpallje qiellore, por në idetë njerëzore, fiksionet dhe fantazitë botërore.

Meqë nuk mund të zgjerohemi më tepër, lexuesve ju rekomandojmë shkrimin tonë me titull: “*Njoftime pejgamberike për ardhjen e Muhamedit (a.s.)*” dhe “*Muhamedi në Bibël*” të ish -klerikut katolik Atë David Benjamin, i kthyer në Islam me emrin Abdulahad Davud dhe disa shkrime e vepra të tjera sidomos të

4. Përfundim

Në themel të të gjitha religjioneve të bazuara në Shpalljen, ekziston një themel i përbashkët, i përbërë prej **dy elementeve themelore të thelbit të Islamit** si fe natyrore e njeriut:

1. Tevhidit, monoteizmit **të pa kompromis**, të qartë dhe të saktë.
2. Përkushtimit, nënshtrimit dhe dorëzimit të plotë e të pakusht ndaj Zotit.

Dallimet ndërmjet feve rezultojnë për shkak të dy faktorëve themelore:

1. Për shkak të formave të ndryshme të sheriave të tyre.
2. Për shkak të ndërhyrjes njerëzore në fe dhe në librat bazë fetarë.


Elementet e përbashkëta në themelet e këtyre feve paraqesin bazë të mirë dhe cilësore për afrimin e tyre të ndërsjellë:

قُلْ يَا أَهْلَ الْكِتَابِ تَعَالَوْا إِلَى كَلِمَةٍ سَوَاءٍ بَيْنَنَا وَبَيْنَكُمْ أَلَّا نَعْبُدَ إِلَّا اللَّهَ وَلَا نُشْرِكَ بِهِ شَيْئًا وَلَا يَتَّخِذَ بَعْضُنَا بَعْضًا أَرْبَابًا مِنْ دُونِ اللَّهِ فَإِنْ تَوَلَّوْا فَقُولُوا اشْهَدُوا بِأَنَّا مُسْلِمُونَ .

“Thuaj: ‘O ithtarët e librit, ejani të biem në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe jush: se do të adhburojmë vetëm Allahun, se nuk do t’i shoqërojmë atij asgjë (në adhurim) dhe se njëri-tjetrin nuk do ta mbajmë për zot, në vend të Allahut!’ Nëse ata nuk pranojnë, atëherë thuaj: ‘Dëshmoni se ne i jemi nënshtruar Allahut!’ (Ali Imran, 64.)

Nga ajeti kuranor shohim se Allahu kërkon që ky afrim të bëhet mbi të vërtetën e tevhidit /monoteizmit/, i cili është bazë e të gjitha feve të shpallura, në të cilën nënkuptohet sinqeriteti së pari ndaj Allahut dhe së dyti në marrëdhëniet e ndërsjella. Nën këto kushte, dallimet ndërmjet feve nuk duhet të jenë pengesë për bashkëjetesën në paqe dhe tolerancë të bazuar të marrëveshjet e drejta:

وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ مُصَدِّقًا لِمَا بَيْنَ يَدَيْهِ مِنَ الْكِتَابِ



وَمُهَيِّمًا عَلَيْهِ فَاحُكُم بَيْنَهُمْ بِمَا أَنْزَلَ اللَّهُ وَلَا تَتَّبِعْ أَهْوَاءَهُمْ عَمَّا جَاءَكَ مِنَ الْحَقِّ لِكُلِّ جَعَلْنَا مِنْكُمْ شِرْعَةً وَمِنْهَاجًا وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ لَجَعَلَكُمْ أُمَّةً وَاحِدَةً وَلَكِنْ لِيَبْلُوَكُمْ فِي مَا آتَاكُمْ فَاسْتَبِقُوا الْخَيْرَاتِ إِلَى اللَّهِ مَرْجِعُكُمْ جَمِيعًا فَيُنَبِّئُكُمْ بِمَا كُنْتُمْ فِيهِ تَخْتَلِفُونَ .

“Ne të kemi zbritur ty (o Muhamed) Librin me të vërtetën, si përmbushës të shkrimeve të mëparshme dhe mbrojtës të tyre. Prandaj gjykoji ata sipas asaj që të ka zbritur Allahu dhe mos ndiq dëshirat e tyre, duke u shmangur kështu nga e Vërteta që të është shpallur. Ne për secilin nga ju kemi sjellë një ligj dhe një rrugë të qartë. Sikur të donte Allahu, do t’ju kishte bërë një popull të vetëm, por Ai kërkon që t’ju provojë në atë që ju ka dhënë, andaj bëni gara për punë të mira! Të gjithë do të ktheheni te Allahu e Ai do t’ju lajmërojë për çështjet, rreth të cilave kishit kundërshti.” (El-Maide, 48.)



Besimi është dashuri

Shemsettin Kirish

Formulën magjike që do t'i bashkonte besimtarët me njëri-tjetrin nuk e dimë, por mbase gjurmët e saj duhet t'i kërkojmë tek dashuria. Sistemi global ka për qëllim prishjen e zemrës së besimtarit. Ata i përçanë mendjet tona dhe tani duan të përçajnë edhe zemrat tona. Më parë kemi nevojë për një rezistencë të fortë brenda vetes. Nuk duhet që shkakun kryesor të përçarjes sonë ta kërkojmë tek ndryshimi i mendimeve. Nuk është ky shkak kryesor i përçarjes sonë, por mosgjettja e fjalëve dhe e shikimeve magjike për të treguar dashuri ndaj njëri-tjetrit. Zemrat tona nuk rrezatojnë dashuri për njëri-tjetrin. Dashuria është një përrua, i cili shndërrohet në ujëvarë duke rrjedhur.

Përpara nesh qëndron shembulli i fiseve Evs dhe Hazrexh të Shekullit të Artë. Ata ishin dy fise që nuk merreshin vesh me njëri-tjetrin në asnjë çështje dhe shpatat e tyre ishin gjithmonë të gjakosura. Kur erdhi Islami, me mirësinë e Allahut u bënë si vëllezër gjaku. Ata u bënë vëllezër me mirësinë që Allahu u fali, kështu që edhe bashkimi ynë do të bëhet me mirësinë e Allahut. Nuk dimë të ketë ndonjë formulë të dashurisë. Kodet e saj janë të fshehura tek "Levhi Mahfudh". Detyra e çdo besimtari është të jetë i hapur ndaj dashurisë së vëllezërve të tij, të cilët janë udhëzuar me Islam dhe të kërkojnë dashurinë gjatë marrëdhënieve me ta. Është shumë e rë-

ndësishme që në bisedat tona të kërkohet dashuria, para se të kërkojen mendimet e përbashkëta. Para bashkimit të mendjeve duhet të kërkohet bashkimi i zemrave, shpallja e dashurisë sonë, para shpalljes së mendimit.

Nëse nuk kemi dashuri, çdo të bëjmë?

Nëse nuk kemi dashuri, do të kërkojmë prej Allahut, sepse mungesa e dashurisë është një sëmundje, një problem. Kush e di, mbase shumë prej problemeve tona rrjedhin prej mungesës së dashurisë. Profeti ynë i dashur (s.a.u.s.), duke thënë se "*Nuk do të keni besuar plotësisht derisa ta doni njëri-tjetrin*", na ka dhënë një shenjë se e kemi për detyrë të kërkojmë mënyrën për të dashur njëri-tjetrin.

Dashuria kërkon sinqeritet. Dashuria e vërtetë dhe e pastër ka një fuqi të mrekullueshme. Askush nuk mund të qëndrojë përpara kësaj fuqie, e cila çan malet dhe kalon pengesa të pakalueshme. Vetëm dashuria e vërtetë kërkon sinqeritet. Sa e drejtë mund të jetë të thuash, "e dua", nëse nuk e ndjen dhe nuk e do me të vërtetë dikë. Kuptimin e vërtetë dashuria e fiton me sinqeritetin dhe ndjenjën. Njerëzit që shfaqin komplimente dhe dashuri që në të vërtetë nuk ekzistojnë, nuk duken aspak të sinqertë dhe të moralshëm. Dashuria kërkon ekuilibër midis ndjenjës dhe veprimeve tona.

Përpara meje kam librin e këshillave me titull “Ej ihvan-i din” (O vëllai im i fesë) të një poeti analfabet që quhet Mehmet Çobani prej Kozanës. Sipas atyre që e kanë parë, ai ka qenë njeri i urtë e i ditur dhe ka ndërruar jetë rreth të pesëdhjetave. Megjithëse ishte analfabet, dashurinë për Allahun dhe detyrat që ka një besimtar kundrejt Allahut i ka treguar (kënduar) në formë poezie. Më tërhoqi vëmendjen një fjali të cilën e ka përdorur shpesh: “*Përmende Allahun në çdo zemër.*”. Ta kujtosh Allahun në zemrën tënde e kuptoj, por përmendjen e Allahut në zemrën e të tjerëve nuk e kuptova me leximin e parë. Vetëm duke menduar pak, arrita ta kuptoj. Allahu e di më mirë, por mos e shiko zemrën të përbërë vetëm prej zemrës tënde, edhe zemrën e të tjerëve shikoje si zemrën tënde dhe Allahun mos e përmend vetëm në zemrën tënde por edhe në ato zemra. Ëmbëlsinë dhe hidhërimin që përjeton zemra jonë e përjetojnë edhe zemrat e të tjerëve. Ashtu si mërzitet dhe thyhet ndonjëherë zemra jonë, edhe zemra e të tjerëve shijon të njëjtat gjëra, prandaj hape zemrën e të tjerëve në mënyrë të atillë, sa të mund ta përmendësh Allahun edhe në zemrën e tyre.

Sa prej vëllezërve myslimanë kemi mundur t’u hapim zemrën?

Sa prej vëllezërve myslimanë kemi mundur t’u kuptojmë hallet që kanë në zemra?

Në sa prej zemrave të vëllezërve tanë myslimanë kemi përmendur Allahun?

Dashurinë duhet ta kërkojmë. Besimtari është gjuetar zemrash. Zemrat besimtare janë gjuetare të njëra-tjetres. Zemrat, maturinë e gjejnë në besim dhe njerëzit e zemrës e kuptojnë njëri-tjetrin. Zemrat besimtare e vënë re dhe duhet ta vënë re njëra-tjetrën, mbase do të jetë e vështirë dhe do të marrë shumë kohë, por ato duhet t’i vënë re edhe afresket hyjnore që gjenden në zemrat e secilit prej tyre dhe duhet të falënderojë Allahun për këtë mënyrë kuptimi që i ka falur.

Nuk arrij t’i kuptoj ata që thonë se ndryshimi ynë qëndron tek mendimet tona, mbase ndonjëherë mendimet mund të vijnë para dashurisë, por asnjëherë nuk do ta arrijnë fuqinë e saj. Idetë pretenduese, mund ta rëndisin bashkimin e zemrave pas bashkimit të mendjes, por në fushën e mendjes asgjë nuk është e qëndrueshme. Çdo gjë është në gjendje të lëvizshme, ndërsa në fushën e zemrës çdo gjë është e qëndrueshme dhe në vendin që i takon. Kërkohet një gjuhë dashurie, sepse vetëm ajo mund t’i hapë zemrat tona dhe ato zemra besimtare që lahen dhe pastrohen në ujëvarën e dashurisë, mund të përshtaten në në çdo aspekt. Duhet të lahemi në ujëvarën e një dashurie dhe jo në ujëvarën e një mendimi. Besimi është dashuri.



Nëse dashuria do të kishte gojë, do të fliste me zemër dhe shpirt e jo me mendje. Nuk do pyeste si e përse.

Nëse dashuria do të përhapej midis nesh, do të na lidhte si tutkalli.

Nëse dashuria do të vinte midis nesh, as që nuk do ta kuptonim se si erdhi, por do të jetonim mrekullira.

Ka prej nesh që thonë se “Problemi i myslimanëve është tek imazhi”, ka të tjerë që thonë se “është në pjekurinë e besimit”, por problemi ynë kryesor është ai i zemrës. Është mirë të meditojmë pak mbi përgjigjen që i japim pyetjes: “Sa e duam njëri-tjetrin?”. Imazhi, është një temë të cilën na e kanë injektuar zotërinjtë globalë dhe myslimanët të cilët rrinë e mendojnë për këtë temë, këputin lidhjet e zemrës me myslimanët e tjerë, ndërsa pjekuria e besimit duhet të jetë me zemrat e pastra, si duart që lajnë njëra-tjetrën.

Sado që i madh të jetë shërbimi ynë ndaj Islamit, nuk kemi të drejtë t’i shpëputim lidhjet e zemrës me myslimanët. Nuk kemi të drejtë as ta shikojmë të ardhmen e myslimanëve të varur nga shërbimi ynë. Kjo varet nga ndihma hyjnore që do të vijë prej Allahut, ndërsa për ta merituar ndihmën hyjnore, është diçka që varet nga zemrat tona të hapura për njëri-tjetrin dhe dashuria që zien në to.

O Zot! Na jep një dashuri që do t’i lajë dhe pastrojë zemrat tona. Ruaji vëllezërit tanë të cilët i shërbejnë Islamit, që të mos u rrëshqasë këmba në rrugë të shërbimit dhe na ruaj neve nga punët që Ti nuk i pëlqen. Na e bëj të mundur që t’i përqafojmë të gjithë vëllezërit tanë besimtarë në horizontin e dashurisë Tënde të gjerë. Amin!



BESIMI, PËRKUSHTIMI DHE VEPRAT

Mr. Zymer Ramadani

Në lidhje me besimtarët e devotshëm, Krijuesi Absolut thotë kështu në librin e Tij fisnik, Kuranin:

“Vërtet, ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, Zoti i tyre do t’i udhëzojë në rrugë të drejtë, për shkak të besimit të tyre. Pranë tyre do të rrjedhin lumenj në kopshtet e kënaqësisë dhe lutja e tyre aty do të jetë ‘Qofsh i lavdëruar, o Zot!’ Përhëndetja e tyre do të jetë ‘Selam’ dhe lutja e tyre e fundit ‘Falënderuar qoftë Allahu, Zoti i botëve!’”¹

Nga Abdullah ibni Abbasi (r. a.), transmetohet se kur e kishte dërguar Muadh ibni Xhebel në Jemen, Pejgamberi a. s. i kishte thënë:

“Ti po shkon te një popull që janë ehl-i kitab (besojnë në libra hyjnorë). Pasi të arrish aty, ftoi ata që të dëshmojnë në Njeshmërinë e Allahut dhe se Unë jam i dërguari i Tij. Nëse ata e besojnë dhe pajtohen me këtë, informoi ata se Allahu ka bërë farz – obligim për ta pesë kohë të namazit në çdo ditë e natë. Nëse ata e besojnë dhe pajtohen me këtë, informoi ata se

1. Jûnus, 10/ 9,10.

Allahu ka bërë obligim për ta që të merret zekat nga të pasurit për t’u dhënë të varfëve. Nëse ata edhe në këtë pajtohen, atëherë mos merr pasurinë e tyre më të vlefshme! Ki kujdes nga lutja e të shtypurit (atij që i është bërë zullum), sepse në mes lutjes së tij dhe Allahut xh. sh. nuk ka perde.”²

Thelbi dhe qëllimi kryesor i krijimit të njeriut është që ai të jetë mirënjohës ndaj Krijuesit të tij të vetëm, i Cili është i Gjithmonshëm, Ekzistues, pa fillim dhe pa mbarim. Në Librin e Tij Fisnik, Allahu xh. sh. thotë: ***“Ai është i Pari dhe i Mbrami, i Dukshimi (me argumente) dhe i Padukshmi (me sy). Ai është i dijsbëm për çdo gjë!”***³ Përndryshe asnjë krijues tjetër nuk e meriton mbështetjen dhe përkuljen e njeriut. Në qoftë se njeriu i përkulet dikujt përveç Krijuesit Suprem që mbizotëron gjithë këtë horizont, atëherë edhe besimi i tij është i kotë dhe përveç kësaj edhe veprat dhe humanizmi i tij janë të humbura: ***“...por keqbërësit janë vërtet në***

2. Buhârî, Zekât 1, Megâzî 60; Muslim, Îmân 29; Ebû Dâvûd, Zekât 5, (1584); Tirmidhî, Zekât 6 (625); Nesâî, Zekât 1, 46; Ibni Mâxhe, Zekât 1 (1783); Ahmed Ibni Hanbel, Musned 1.233.

3. Hadîd, 57/ 3.

humbje të plotë".⁴ Të gjithë Pejgamberët që Allahu xh. sh. i dërgoi tek njerëzimi, kishin si parim dhe thelb kryesor të misionit të tyre që *"t'i ftojnë njerëzit në besimin e pastër në Allahun (xh.sh.)"*. Ata asnjëherë nuk kërkuan nga paria e tyre ndonjë shpërblim apo përfitim të kësaj bote, përveç që të dëshmonin se Allahu është Një, i pafillim dhe i pambarim... Veprat si: namazi, agjërimi, bamirësia, studimi i shkencave, që janë në dobi të të gjithë njerëzve, janë aq të vlefshme dhe të rëndësishme për inkadrimin e popullit në një jetë të lumtur dhe aq me peshë të madhe tek Krijuesi, sa i përngjajnë farës së shëndoshë të një bime që mbillet në vendet e tropikale dhe që jep fryte të shijshme e aromë të këndshme, të pëlqyer nga të gjithë njerëzit.

Në hadithin e mësipërm, të transmetuar nga Abdullah ibni Abbasi r. a., vërejmë se Pejgamberi a. s. e ka urdhëruar që së pari ata të besojnë Allahun Një dhe pasi ta bëjnë këtë, atëherë do të kenë vlerë dhe dobi veprat e tyre. Kjo na lidh të gjithëve në një pikë të përbashkët, në besimin e pastër në Allahun, sepse pa këtë, as namazi dhe as obligimet tjera nuk kanë peshë dhe kuptim. Po ashtu, në fund të hadithit vihet re edhe një tërheqje vëmendjeje ndaj myslimanëve, që të mos abuzojnë, të mos manipulojnë dhe të mos ia hanë hakun të shtypurit dhe të dëmtuarit. Veprimi i kësaj do të jetë në vlerën e të shtypurit dhe në asnjë mënyrë në favor të shtypësit. Allahu xh. sh. e ka nën kujdesin e tij këtë, sepse hadithi përfundon me shprehjen *"...Ki kujdes nga lutja e të shtypurit (atij që i është bërë zullum), sepse në mes lutjes së tij dhe Allahut xh. sh. nuk ka perde."*

Besimtarët me një besim kristal, të pandotur, Kuranin i përgëzon duke thënë se ato janë të shpëtuarit dhe si shpërblim kanë xhenete në të cilët rrjedhin lumenj. Bazë kryesore e kësaj është edhe besimi në *sekretet* e Allahut xh. sh. – në *"gajb"*⁵ dhe vetëm pas kësaj obligohen veprat e tjera për të cilat personi do të shpërblehet apo ndëshkohet.

Veprat e njeriut janë të lidhura me besimin e pastër, ashtu sikurse rrënjët e një bime. Shpeshherë njeriu fundoset në pesimizëm dhe ndihet i pashpresë apo i ligështuar, pa ndihmën e askujt. Në këto çaste ai mund të humbë shpresën edhe më tepër ndaj Krijuesit, e harron atë dhe kështu shkatërron besimin ndaj Tij. Si rezultat i kësaj, si shpresë kryesore dhe si ilaç shërues ai kërkon një fuqi që ta ndihmojë në ato çaste. Në momentet e liga, në trurin e tij depërton djalli, i cili dëshiron t'i prijë. Kështu besimtari i lig mund të kërkojë ndihmë nga dikush tjetër e jo nga Allahu xh. sh. Më pas, do t'i nënshtrohet atij dhe do të sakrifikojë për të. Këto sjellje, këto besime të kota dhe gjëra të ngjashme me këto, Allahu xh. sh. i ka ndaluar rreptësisht, e po ashtu edhe Pejgamberi a. s., i cili gjatë gji-

thë jetës është munduar t'i eliminojë këto vese të njerëzve. Me shpresë se ndonjë i devotshëm apo ndonjë lloj druri, guri, lumi, qiriu etj. mund t'u sjellë dobi dhe t'i shpëtojë nga kthetrat e stresit dhe të ankthit, ka nga ata njerëz që e braktisin bindjen e pastër në Allahun e Madhëruar dhe vërsulen pas këtyre gjërave. Duke qenë se të gjitha këto janë të ndaluara dhe persona të tillë mund të humbasin edhe dëshirën për jetë nëse nuk u plotësohet dëshira, atëherë si vend shprese qëndron vetëm ajo që na ka porositur Krijuesi dhe Pejgamberi i Tij.

Besim dhe bindje e vërtetë është vetëm ajo që ka lënë i dërguari i Allahut dhe pasuesit e tij, sahabitë e ndershëm, të cilët sakrifkuan jetën e tyre vetëm për ta lartësuar të vërtetën hyjnore që solli Muhammedi a. s. Për këtë besim të pastër, ata lanë pasuritë, karrierën, sjelljet e kohës së injorancës dhe filluan një jetë që kërkonte islami. *Kështu që Tevhidi – Njeshmëria i përngjan zemrës së njeriut; po që se zemra është e sëmurë, atëherë organet tjera trupore edhe pse funksionojnë nuk kanë rolin e duhur.* Për këtë shkak, njerëzit me zemra dhe bindje të pastër, islami ua lartësoi vlerën dhe personalitetin në një shkallë të lartë. Ai ua formu-loi atyre programin e jetës së kësaj bote, në mënyrë që të mund ta fitojnë edhe botën tjetër. Me një fjalë, ai kërko vetëm bindje, përkushtim dhe vepra të shëndosha nga besimtarët. E gjithë ajo që ndot tevhidin/njeshmërinë e Allahut, jo vetëm që nuk pranohet, por edhe ndëshkohet rëndë, si në këtë botë ashtu edhe në botën tjetër.

"Vetëm për Atë është lutja e vërtetë! Kurse idhujt, të cilëve jobesimtarët u luten në vend të Allahut, nuk u përgjigjen lutjeve të tyre aspak. Rasti i tyre është si rasti i atij që zgjat duart tek uji, për t'i ardhur te goja, por ai kurrësi nuk i vjen. Lutja e jobesimtarëve është e kotë".⁶

Veprat e shëndosha i përkasin gjithashtu edhe shiut që ushqen bimët, dhe në kohën kur ato duhet të ofrojnë fryte, japin fryte më të mira se sa bimët tjera që nuk janë ujitur. Duke qenë se gjithçka që ekziston në këtë horizont e madhëron Atë, Ai i furnizon të gjithë; si shpagim për këtë Ai kërkon nga njerëzit vetëm përkushtim dhe bindje, duke kryer veprat që Ai ka përkshkruar në Kuranin Fisnik. Në këtë kontekst, Allahu i madhëruar thotë:

"Atë e madhërojnë shtatë qiejt, Toka dhe gjithçka gjendet në to. Dhe nuk ka asgjë që nuk e madhëron Atë, duke e lavdëruar, por ju (o njerëz) nuk e kuptonin madhërimin që i bëjnë ata. Ai, me të vërtetë, është i Butë dhe Falës."⁷

4. Lukman, 31/11.
5. Bekare, 2 / 4 – 6.

6. Ra'd, 13/14
7. Isra, 17 / 44



Një Ajet

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit!

1. Thuaj: “Ai është Allahu, Një dhe i vetëm.”
2. “Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim.”
3. “Ai nuk lind, as nuk është i lindur.”
4. “Dhe askush nuk është i barabartë me Atë!”

Kjo sure flet për Qenien e Allahut dhe cilësitë e Tij, prandaj është titulluar “**Surja e Tevhidit**” (surja e njësisë), “**Surja e Tefritit**”, “**Surja e Texhridit**” (surja e veçimit, e ndarjes) si dhe për arsye se shpëtimi arrihet me besimin në tevhid, është quajtur “**Sureja e Nexhatit**” (surja e shpëtimit). Kjo sure gjithashtu përpiket të na shpjegojë në njohjen thelbësore të Allahut dhe kjo është një ndër arsyet për të cilën është emërtuar edhe si “**Surja e Marifetit**” (surja e njohjes). **Allahu i Lartmadhëruar e ka emërtuar këtë sure “Sureja e Ihlasit”** (surja e sinqeritetit), sepse vërtetësia e sinqeritetit të imanit arrihet vetëm me tevhid. Në këtë sure me katër ajete, Allahu i Lartmadhëruar përshkruan Vetën e Tij dhe gjashtë cilësitë e Tij thelbësore (qenësore).

Me shpalljen e Kuranit, Allahu i Lartmadhëruar ka pasur tre qëllime kryesore. I pari është **Tevhidi** (njësia), i dyti është **Ahireti** (bota e përtejme), i treti është **Drejtësia** dhe **Ibadeti** (adhurimi). Kjo sure përqendrohet në qartësimin e të parës, prandaj Hazreti Pejgamberi, sallallahu alejhi ve sellem, ka thënë: “**Surja e Ihlasit është sa një e treta e Kuranit**”. (Buhari, Fadailu’l-Kur’an, 13; Muslim, Musafirin 259; Tirmidhi, Fadailu’l-Kur’an, 11.)

Dijetarët islamë dhe komentuesit e Kuranit kanë thënë: “**Katet e tokës dhe të qiellit janë ndër-tuar mbi suren ‘Kul huvalahu Ehad’**. (Zamahsheri, Keshshaf, 4:450.) Ai që rrok kuptimin e kësaj sureje ka njohur edhe Zotin e tij. Një ditë, Hazreti Pejgamberi shikoi një person që po lexonte Suren Ihlas dhe u shpreh: “Ky njeri (rob i Allahut) e ka njohur Zotin e tij”. (Alusi, Tefsir, 2:341.) Për këtë arsye, kësaj sureje i është dhënë emri “**Sureja e Imanit**” (surja e besimit).

Shkaqet e zbritjes së kësaj sureje

Mushrikët shkuan tek Hazreti Pejgamber dhe i thanë: “Na e përshkruaj Zotin tënd! Na mëso diçka në lidhje me Qenien e Tij!”. Atëherë zbriti Xhebraili (a.s.) dhe i shpalli këtë sure Hazreti Pejgamberit, sallallahu alejhi ve sellem. Sipas një transmetimi tjetër, mushrikët i drejtuan Hazreti Pejgamberit, sallallahu alejhi ve sellem, pyetje të tilla si: “Ti thua se gjithësinë e krijoi Allahu. Po Allahun kush e krijoi?”. Hazreti Pejgamberi u mërzi të tepërmi nga kjo pyetje, aq sa ju skuq fytyra nga zemërimi. Ja behu Xhebraili (a.s.), që e ngushëlloi Hazreti Pejgamberin dhe e këshilloi duke i thënë “Hapi krahët e dhembshurisë, ej Resulullah”. Pastaj Allahu i Lartmadhëruar shpalli “Suren Ihlas”. (Sujuti, Durru’l-Mensur, 8:671.)

Një Hadith



Sipas një transmetimi të Enesit (r.a.) një herë tek kishin hipur mbi një deve së bashku me Resulullahun (a.s.),

Resulullahu (a.s.) i është drejtuar Muadhrit tre herë:

“O Muadh!” dhe Muadhi i është përgjigjur tre herë:
Urdhëro, o i Dërguari i Allahut! Jam nën urdhrat e tua!
Më pas Hazreti Pejgamberi ka vazhduar:

“Ai që dëshmon me zemër se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob i dërguari i Allahut, i është bërë haram zjarrit të xhehenemit.” Më pas Muadhi e ka pyetur Hazreti Pejgamberin:

O i Dërguari i Allahut, a t’ia jap këtë sihariq myslimanëve, që të gëzohen? Hazreti Pejgamberi është përgjigjur:

“Atëherë ato do t’i besojnë kësaj të vërtete dhe do të bien në dembeli (nuk do të bëjnë vepra të mira).”

Muadhi, për t’i shpëtuar mëkatit të fshehjes së diturisë, pak para se të vdiste ia transmetoi shoqëve të tij këtë hadith.

Koment

Hazreti Pejgamberi, ashtu siç e shohim në këtë hadith, në udhëtime të ndryshme hipte në të një njëjtën kafshë edhe sahabet e tij të dashur. Muadhi është njëri nga ato sahabe që ka përjetuar tre herë udhëtimin me Resulullahun në të njëjtën deve.

Thirrja tre herë e Muadhrit në emër ka pasur si qëllim tërheqjen e plotë të vëmendjes drejt fjalëve që Hazreti Pejgamberi do t’i thoshte. Muadhi në të tre herët që profeti e ka thirrur, i është përgjigjur “Urdhëro o i Dërguari i Allahut, po ju dëgjoj me të gjithë qenien time”, duke shprehur përqendrimin e tij të plotë ndaj temës që do të flitej. Ky hadith lidhet me shpresën që duhet të kenë njerëzit tek Zoti e që duket qartë në fjalët që Hazreti Pejgamberi, sallallahu alejhi ve sellem, i thotë Muadhrit: “Ai që dëshmon me zemër se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob i dërguari i Tij, i është bërë haram zjarrit të xhehenemit.”

Këtu ia vlen të përmendet se kur u pyet Hazreti Pejgamberi, pra ai i cili e dha këtë sihariq, se pse falej aq shumë kur atij i ishin falur të gjitha gjynahet që i përkisnin të kaluarës dhe të ardhmes, ai i është përgjigjur: “A të mos jem unë një rob falënderues”.

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Tevhidi është një shkak dhe sihariq shpëtimi.
2. Dituria u duhet dhënë njerëzve të konsoliduar, të pjekur dhe inteligjentë.

PARIMET E MORALIT TË LARTË

Personalitetin shembullor të Profetit duhet ta kemi udhërrëfyes të vazhdueshëm në çdo etapë të jetës sonë. Selamet që vërshojnë nga shpirttrat tanë, salavatet (besnike), duhet të na përçojnë në reflektimet e çdo indi të Tij shpirtëror. Ai që zotëron nga morali i lartë i profetit Muhamed (a.s.) përkorësinë, dorëzimin tek Allahu, si dhe cilësi të tjera të ngjashme me këto, ka arritur lumturinë e vërtetë.

Për t'u zhvilluar shpirtërisht në rrugën e përsosmërisë, një besimtar duhet të përvetësojë jetën shpirtërore dhe morale të profetit Muhamed - salallahu alejhi ve sellem. Kjo gjendje arrihet varësisht prej faktit se deri në ç'masë arrin të shkrihet besimtari në dashurinë për Profetin dhe për botën e Tij shpirtërore.

Njerëzimi ka dëgjuar nga gjuha e mrekullueshme e

të Dërguarit të Allahut - salallahu alejhi ve sellem, pëshpëritjet Hyjnore që përçojnë shërim dhe qetësi shpirtërore. Njerëzimi e ka përfituar oqeanin e faljes dhe të mirësisë në sajë të Nurit të asaj Qenieje. Për hatër të Atij, gjithë gabimet e shumta, njerëzimi meritoi që Allahu t'i drejtohej me shprehjen: **"O Robërit Mi"**.

Përballë gjithë kësaj mirësie, bujarie, dhe përkujdesjeje, neve si ummet i Muhamedit na bie për detyrë ta kalojmë jetën brenda atmosferës shpirtërore të synnetit të Tij, duke iu bindur tërësisht urdhëresave, ndalesave dhe këshillave të Tij.

Zoti ynë i ka dhuruar Profetit tonë gradën më të lartë shpirtërore "Makam-i Mahmud" dhe e ka këshilluar në bazë të këtij makami dhe Ai, duke qenë **"shumë dashamirës dhe i mëshirshëm"** ndaj ummetit të Tij, ka dëshiruar që edhe ummeti i tij t'i dëgjonte dhe t'i zbatonte këshillat që i jepeshin nga Allahu. Një pjesë e këtyre këshillave janë:

Profeti ynë alejhis selatu ve selam urdhëron:

Allahu (xh.sh.) më urdhëroi t'i frikësohem Atij për çdo punë të hapur dhe të fshehur, (të njëjtën gjë jua këshilloj edhe juve).

Pejgamberi ynë i dashur, ashtu si ndaj çdo urdhëri tjetër, ishte i përpiktë edhe ndaj frikës së Allahut. Ai thotë:

"Betohem në Allahun (xh.sh.) që unë jam ndër ju

**“Kurse ai që i është frikësuar
madhërisë së Zotit të tij dhe
e ka frikësuar veten nga
dëshirat, pa dyshim pa
dyshim që do të ketë për
strehë Xhennetin.”**

(en-Naziat, 40-41)

*ai që i frikësohet më shumë Allahut, që i përulet Atij
e që gjithashtu e nderon dhe e madhëron më shu-
më Atë.” (Buhari, Nikah)*

Kur dëshironte të ngrihej nga ndonjë kuvend
miqsh, lutej duke thënë:

*“O Zoti im! Na dhuro frikë, që të bëhet perde ndër-
mjet nesh dhe gjynaheve tona! (Tirmizi, Deavat,
79), sepse Pejgamberi (a.s.) ka përjetuar majat e
manifestimeve të njohjes më nga afër të të Madhë-
rishmit. Një ditë, ai u tha shokëve të Tij:*

*“Sikur të dinit ato që di unë, shumë do të qanit e
pak do të qeshnit.” Në atë çast sahabet filluan të
qanin me dënësë.*

Allahu i Lartmadhëruar i ka premtuar xhenetin
të gjithë atyre që i frikësohen Atij haptas, fshehtas
dhe në çdo gjendje. Në Ku’ran thuhet:

**“Kurse ai që i është frikësuar madhërisë së Zo-
tit të tij dhe e ka frenuar veten nga dëshirat, pa
dyshim që do të ketë për strehë Xhenetin.” (en-
Naziat, 40-41.)**

*“(që do t’u thuhet) Kjo është premtuar për ju, për
këdo që është penduar dhe ruajtur (nga gjynahet),
që e ka pasur frikë të Gjithëmëshirshmin, edhe
atëherë kur nuk e shihte kush, e që ka ardhur me
zemër të kthyer (nga Allahu). ” (Kaf, 32-33.)*

**“Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me
frikë e shpresë dhe japin nga ajo që u kemi dhënë
Ne.” (es-Sexhde, 16.)**

Për këtë arsye, pejgamberët dhe miqtë e
Hakut i gjallëronin netët e tyre duke iu frikë-
suar Allahut dhe duke shpresuar në rahmetin
e Tij. Netët e tyre ishin më të ndriçuara se di-
tët e tyre, sepse ishin të mbushura me qetësi
dhe përsëritshmëri sexhdesh të bëra me sy
të përlotur.

Pejgamberi i njerëzimit thotë:


***Zoti im më urdhëroi që të gjykoj me
drejtësi si në gjendje zemërimi ashtu
edhe në gjendje pëlqimi, (të njëjtën gjë
jua këshilloj edhe juve.).***

Çastet e zemërimit janë çaste në
të cilat njeriu has vështirësi për të
ruajtur ekuilibrin dhe aftësinë për
të përballur të vërtetën, kur mund
ta humbë drejtpeshimin e gjërave
duke u shmangur nga drejtësia.
Në situata të tilla Allahu dhe Ahi-
reti duhen kujtuar me më shumë
durim, si dhe duhet ruajtur qe-
tësia që të mos biem në pozita
padrejtësie.

Allahu (xh.sh.) urdhëron:

***“O besimtarë! Bëhuni zba-
tues të palëkundur të drej-
tësisë, duke dëshmuar në
emër të Allahut, qoftë edhe
kundër jush ose kundër pri-
ndërve dhe të afërmeve tuaj.
Qoftë i pasur ose i varfër
ai (për të cilin dëshmoni),
Allahu është për ata vlerë-
suesi më i drejtë. Dhe mos
shkoni pas epsheve tuaja
e të shtrembëroni drejtë-
sinë! Nëse ju ngatërroi
drejtësinë ose i shmange-
ni asaj, vërtet që Allahu e
di se çfarë bëni ju.” (en-
Nisa, 135.)***

***“Nëse dy palë besimta-
rësh bëjnë luftë midis tyre,***



pajtojini ata. Por, nëse njëra palë sulmon tjetrën, atëherë luftoni kundër sulmuesit, derisa të kthehet në urdhërat e Allahut. E, nëse kthehet, atëherë pajtojini ata midis tyre, me drejtësi dhe paanësi, sepse Allahu i do ata që veprojnë me drejtësi." (el-Huxhurat,9)

Resulullahu (a.s.) në një hadith që cek tema të ndryshme, thotë:

Ekzistojnë tre punë (vepra) që sigurojnë shpëtimin:

1. Të jesh i drejtë si në gjendje zemërimi ashtu edhe në gjendje pëlqimi.

2. Të respektosh parimin e masës, si në gjendje pasurie ashtu edhe varfërie.

3. Të kultivohet frika ndaj Allahut, si haptazi ashtu edhe fshehurazi...." (Hejsemi, I, 90.)

Një herë, ndërsa dikush po dënohej, sepse kishte kryer një vjedhje, personit që kishte ardhur për të penguar zbatimin e dënimit, Profeti (a.s.) i tha duke sjellë shembull më të dashurën, vajzën e Tij:

"Betohem në Zotin Tim, që sikur edhe vajza ime, Fatimeja ta kishte bërë këtë vjedhje, do t'ia prisja dorën." (Buhari, Enbija, 54; Muslim, Hudud, 8, 9)

Lumturia personale dhe shoqërore bazohet në drejtësi. Këtë të vërtetë, Hazret-i Omeri (r.a.) e shpreh në këtë formë:

"Drejtësia është themeli i atdheut (shtetit, lirisë dhe ekonomisë së një



vendi)."

Në periudhën e emvitëve, në një hark kohor prej dy vite e gjysëm të hilafetit të Omer bin Abdulaziz, i cili sipas historisë islame konsiderohet halifi i pestë për nga vlerat, në një kohë kur kufijtë e shtetit islam ishin zgjeruar aq shumë sa në to qe përfshirë edhe Spanja, populli jetonte në siguri dhe qetësi, si rezultat i shpërndarjes në mënyrë të saktë së të vërtetës dhe drejtësisë në tërë shtetin e tij. Ashtu si nuk mund të arrihet zhvillimi (lulëzimi, ndërtimi ose mirëqënia) nëpërmjet dhunës edhe shtetet nuk mund të qëndrojnë në këmbë pa drejtësinë.

Nga historia jonë kemi shembullin e Sulltan Fatih Mehmetit, i cili për një çështje konflikti me një arkitekt të krishterë cakton mikun e tij, Hizir Bej si kadi për çështjen në fjalë. Hizir Bej, pasi shqyrton çështjen nga afër, gjykon juridikisht jo në favor të sulltanit por të palës tjetër. Ky rast është vetëm një shembull i drejtësisë që sundonte kudo në Shtetin Osman, gjë e cila siguroi vazhdimësinë shekullore të këtij shteti.

I dërguari i Allahut (a.s.) thotë:

Allahu më urdhëroi të respektoj parimin e masës (kursimit) si në gjendje pasurie ashtu edhe në gjendje varfërie (të njëjtën gjë jua këshilloj edhe juve).

Allahu më urdhëroi të respektoj parimin e masës (kursimit) si në gjendje pasurie ashtu edhe në gjendje varfërie (të njëjtën gjë jua këshilloj edhe juve).

Njeriu duhet të jetë i matur në jetën e tij, qoftë i pasur apo i varfër. Ai nuk duhet ta kalojë masën në asnjë çështje. Profeti Muhamed (a.s.) na këshillon vazhdimisht që t'ia dimë vlerën pasurisë pa ardhur ende varfëria.

Në lidhje me të qenit të kujdesshëm dhe të kursyer (të matur në shpenzime), Allahu (xh.sh.) thotë:

“Jepuni të afërmve, të varfrit dhe udhëtarit të drejtën e tyre, por mos bëni shpenzim të tepruar.” (el-Isra, 26.)

“Dorëshpuarit me të vërtetë janë vëllezërit e djallit dhe djalli është mosmirënjohës ndaj Zotit të tij.” (el-Isra, 27.)

“Mos e shtrëngo dorën, as mos u bëj dorëshpuar e të mbetesh i qortuar dhe i mjerë.” (el-Isra, 29)

I Dërguari i Allahut - sallahu alejhi ve sellem – thotë sërish:

“Ata që janë të matur dhe nuk shpenzojnë pa kriter, nuk bëhen kurrë nevojtarë të tjerëve” (ibn-i Hanbel)

“Ai që bën istihare nuk do ta provojë kurrë idhtësinë e humbjes (pra nuk humbet kurrë), ai që konsultohet nuk do të pendohet, harxhuesi me kriter nuk varfërohet kurrë.” (Hejsemi, Mexhmau'z-Zevaid, II, 280)

Prandaj, besimtari duhet të jetë i vetëdijshëm se Allahu është pronari i çdo pasurie, duhet ta shohë veten si ruajtës (amanetqar) i pasurisë që i është dhuruar, ta përdorë atë me kriter për nevojat e veta dhe pjesën tjetër ta harxhojë në rrugë të Allahut. Allahu i lartmadhëruar thotë:

“...Të pyesin se çfarë duhet të japin si lëmoshë, thuaju: ‘Tepricën!’ Ja, kështu jua shpjegon Allahu shpalljet e Tij, që të mund të mendoni.” (el-Bekare, 219.)

Duke këshilluar pasurinë shpirtërore në raste ngushticash ekonomike, Profeti ynë Muhamed (a.s.) thotë:

“Ruajuni zjarrit qoftë edhe me një gjysëm hurmi. Ai që s'mund ta sigurojë as këtë, të ruhet me fjalën e mirë e të bukur.” (Buhari, Edeb, 34.)

Lumturia e të zotëruarit të diçkaje fitohet me dhurimin e saj në rrugë të Allahut. Për të pasur mundësi dhurimi dhe shërbimi në rrugën e Allahut, duhet që pasuria të fitohet në rrugë të pastër hallalli dhe të harxhohet pa lejuar të hyjnë në zemër lakmitë materiale.

Pejgamberi ynë (a.s.) thotë:

“Sa bukur kur malli i dobishëm dhe hallall ndodhet në duart e vepërmirit” (Ibn-i Hanbel, IV, 202.), sepse një mirëbërës është i mëshirshëm dhe i dhembshur. Mëshirë do të thotë, atë të cilën e ke në zotërim t'ia dhurosh atij që nuk ka. Me fjalë të tjera, mëshira është vrapimi për të

ndihmuar të tjerët në përballimin e skamjes. Në këtë botë, mëshira dhe bujaria janë qetësim i ndërgjegjes, ndërsa në botën tjetër janë sihariq lumturie të pafundme.

Në shoqëri janë shumë të rrallë **“agnija-i shakirin”**, të pasurit falënderues dhe dhurues, si dhe **“fukara-i sabirin”**, të varfërit e durueshëm. Për këtë arsye, të dy këto grupe besimtarësh pranohen nga Allahu. Të pasurit bujarë dhe falënderues, si dhe të varfrit e durueshëm e të ndershëm fitojnë pëlqimin e njerëzve dhe të Allahut, por në islam janë përçmuar të pasurit mendjemëdhenj e dorështrënguar, si dhe të varfrit që nuk kënaqen me caktimin e tyre hyjnor, të cilët nuk tregojnë durim dhe rebelohen. Prandaj, Hazreti Pejgamberi (a.s.) ka bërë vazhdimisht këtë dua:

“Zoti im! Të mbështetem vetëm Ty nga ngatërresat (të këqijat, përçarjet, sprovat) e varfërisë dhe të pasurisë.” (Muslim, Zikir, 49.)

Prandaj themi se kush i zotëron cilësitë e përkorësisë, të dorëzimit, si dhe cilësi të tjera të larta shpirtërore, është vërtet i pasur. Mbretëria e vërtetë e pasurisë qëndron në këmbë vetëm në sajë të lumturisë së dhurimit (infak).

Kur filluan përgatitjet financiare për luftën e Tebukut edhe sahabet që nuk kishin mundësi të mjaftueshme financiare u mbushën me ndjesinë e mundësisë së sakrifikimit të pasurisë dhe jetëve të tyre në rrugë të Allahut.

Një nga këto ishte Ebu

“Zoti im! Të mbështetem vetëm Ty nga ngatërresat (të këqijat, përçarjet, sprovat) e varfërisë dhe të pasurisë.”

(Muslim, Zikir, 49.)

Akil (r.a.), i cili punoi gjithë natën për të fituar dy masë hurma. Njëren masë ia dha familjes, ndërsa tjetrin ia dhuroi ushtarëve që do të merrnin pjesë në luftën e Tebukut.

Në lidhje me këtë, i Dërguari i Allahut (a.s.) tha:

“Allahu e begatoftë atë që solle këtu dhe atë që e mbajte.” dhe i hodhi ato hurma mes ndihmave të grumbulluara për luftën në fjalë. (Taberi, Tefsir, X, 251.)

Një ditë, profeti Muhamed (a.s.) tha:

“Një derhem është më i madh se sa njëqind mijë derhem.”

Shokët e Profetit e pyetën:

“Si ka mundësi kjo, o Resulullah?” Përgjigja që dha Profeti ishte kjo:

Një burrë kishte dy derhem. Më të mirin e tyre e dhuroi për hir të Zotit. (Pra dhuroi gjysmën e pasurisë së tij.), kurse një tjetër (që ishte shumë i pasur) dhuroi nga pasuria e tij njëqind mijë derhem.” (Nesai, Zekat, 49.)

Pra i pari, megjithëse ishte nevojtar dhuroi gjysmën e asaj pasurie që zotëronte; kurse i dyti, edhe pse kishte më shumë pasuri se sa i pari, dhuroi vetëm një pjesë të vogël të asaj pasurie. Nga kjo



kuptojmë se pranimi (ose sevapi, shpërblimi) i dhurimit të diçkaje për hir të Allahut nuk është i lidhur me sasinë, por me nivelin e sakrificës shpirtërore që përjetohet gjatë dhurimit të saj.

Po japim sërish një shembull që përforcon këtë të vërtetë:

Një herë, një person erdhi tek Hazret-i Osmani (r.a.) dhe filloi të fliste:

“-O ju të pasur! I morët të gjitha veprat e mira; nga pasuria juaj jepni vazhdimisht lëmoshë, lironi shumë skllevër, shkoni në haxh dhe dhuroni nga pasuria juaj në rrugë të Allahut...”

Hazreti-i Osmani (r.a.) e pyeti:

“A na keni zili ne për këtë?”

“Po, ne ju kemi zili.”

Atëherë hazreti Osmani (r.a.) i dha këtë përgjigje:

“Betohem në të Madhin Zot, që dhurimi edhe i një derhemi nga një besimtar në kushte të vështira ekonomike, është më i pranuar tek Allahu se sa dhurimi i një sasie të konsiderueshme nga një besimtar i pasur.” (Ali el-Muttaki, VI, 612/17098.)

Në lidhje me këtë të vërtetë, Sheh Sadi ka thënë:

“Allahu nuk ia ka mbyllur askujt derën e mirësisë. Dije mirë se mirësia e çdokujt është në varësi të fuqisë së tij. Një kandar me ar që jep një i pasur nuk është i njëjlojtë me një karat të fituar me mundin e krahëve, të cilin e jep një i varfër. Këmba e karkalecit është një peshë e rëndë për milingonën.”

Një vepër e mirë shpërblehet ose ka vlerë aq sa ç’është sakrifica ndjesore-shpirtërore. Për shembull, në luftën e Jermukut, tre shehidët (dëshmorët), edhe pse të tharë deri në vdekje për një pikë ujë, nuk pranuan ta pinin gotën e ujit, ngaqë donin t’ia dhuronin njëritjetrit. Kjo tregon ndjenjën e fortë të dhurimit që ato kishin kultivuar thellë në zemrat e në shpirtrat e tyre. Ky shembull përbën modelin e një niveli shpirtëror që nuk arrihet dot.

Ja pra ideali i brezit të sahabeve, i atyre që ishin ushqyer me moralin e Profetit Muhamed (a.s.). Për këtë arsye, mëshira dhe zuhdi i tyre arriti majat, sepse ajo shoqëri jetonte në një gjendje përkorësie. Brezi i sahabeve nuk e njihte aspak filozofinë e konsumit, harxhimit pa kriter, babëzinë, luksin, shpenzimet e tepërta për dukje si stil jetese. Të pasurit e tyre ishin **agnija-i shakirin**, ndërsa të varfërit e tyre ishin **fukara-i sabirin**. Pejgamberi përbën në mënyrë absolute shembullin më të mirë të **agnija-i shakirin**, kur merrte atë që meritonte nga trofetë e luftës, si dhe shembullin **fukara-i sabirin**, kur nuk kishte as çfarë të hante në shtëpi, kur detyrohej të lidhte gurë në stomak



për të përballuar urinë.

I Dërguari i Allahut (a.s.) ka thënë:

Zoti im më urdhëroi që të ruaj (të kujdesem për) lidhjet farefisnore, me ato që kërkojnë vetë t'i këpusin (madje edhe atëherë kur ato kërkojnë t'i këpusin medoemos) (të njëjtën gjë jua këshilloj edhe juve).

Allahu i Lartmadhëruar i ka urdhëruar me ngulm besimtarët të ruajnë lidhjet farefisnore, si dhe ka urdhëruar ata që të jenë mirëbërës e bujar më të afërmit e tyre, ndërsa Pejgamberi ynë (a.s.) ka thënë:

“Unë jam dërguar nga Allahu (xh.sh.) me detyrën për të shpjeguar domosdoshmërinë e ruajtjes dhe të përkujdesjes ndaj të afërmve, për të thyer idhujt dhe për t’ju mësuar njësinë e Zotit si të pa ortak.” (Muslim, Musafirinë, 294.). Me këtë hadith, Profeti ynë thekson në mënyrë thelbësore rëndësinë e ndërtimit të marrëdhënieve sa më të rregullta me të afërmit, duke i bërë vizitë, duke u kujdesur dhe duke i ndihmuar ata në çdo situatë.


Të afërmit, edhe sikur të mos na shprehin të njëjtin interesim dhe mirënjohje, e madje edhe sikur t’i këpusin fare lidhjet me ne, është detyrë që rrjedh nga imani të përpiqemi përsëri t’i ruajmë lidhjet, t’i këshillojmë për të mirë me një gjuhë të ëmbël dhe t’i ndalojmë nga e keqja.

Në një hadith tjetër thuhet:

“Ai që ia kthen mirësinë të afërmve me të njëjtën monedhë mirësie, nuk konsiderohet si përkujdesës dhe ruajtës i lidhjeve farefisnore. (Me të vërtetë) Njeri që përkujdeset për lidhjet farefisnore konsiderohet ai i cili edhe kur të afërmit e tij i këpusin lidhjet me të, vazhdon t’u bëjë mirë atyre.” (Buhari, Edeb, 15; Ebu Davud, Zekat, 45.)

Në lidhje me këtë temë, shembullin kulmor e përbën profeti Muhamed (a.s.) , kur ai priste kurban, një pjesë të mishit ia shpinte edhe të afërmve të Hatixhes. Ai ka thënë:

“Mësoni prejardhjen tuaj farefisnore, që të keni mundësi t’i vizitoni, të përkujdeseni dhe t’i ndihmoni ata...” (Ali el-Muttaki, Kenz, X, 220, nr: 29162)



Allahu i Lartmadhëruar flet në Kuran për shkatërrimin e atyre që anashkalojnë detyrën e përkujdesjes, të ndihmës dhe të vizituarit të të afërmeve në ajetet:

“...të cilët shkelin besën e Allahut, pasi e patën dhënë, ndërpresin atë që e ka urdhëruar Allahu për ta mbajtur lidhur dhe bëjnë ngatërresa në Tokë; Ata janë njëmend të shkatërruar ” (el-Bekare, 27.)

“Nëse ju (o hipokritë) i ktheni shpinën besimit, atëherë do të bënit ngatërresa në Tokë dhe do t’i shkatërronit lidhjet farefisnore. ” (Muhamed,22.)

“Këta janë ata, të cilët Allahu i ka mallkuar, i ka bërë të shurdhër dhe ua ka verbuar shikimin.” (Muhamed, 23.)

Profeti Muhamed (a.s.) e shpreh në këtë mënyrë humbjen e madhe në të cilën kanë rënë ata që lënë mbas dore të afërmit e tyre:

“Ai që shkëput lidhjet me të afërmit nuk mund të hyjë në xhenet.” (Buhari, Edeb,11.)

“Përveç dënimit në botën tjetër, i cili do të jepet pavarësisht dënimeve që jepen në dynja, gjynahet që përshpejtojnë dënimin hyjnor në këtë botë janë padrejtësia dhe braktisja e të afërmve.” (Ebu Davud, Edeb, 43; Tirmidhiu, Kijame, 57.)

“Nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë mik i ngushtë ”

(Fussilet, 34)

I dërguari i Allahut (a.s.) thotë:

Zoti im më urdhëroi t'i jap atij që më varfëron, (të njëjtën gjë jua këshilloj edhe juve.)

Në një ajet kuranor thuhet:

“Nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë mik i ngushtë.” (Fussilet, 34.)

Ndërsa në një hadith profetik thuhet:

“Ti mos i shkëput lidhjet me atë që i ndërpret ato! Jepi atij që nuk të jep gjë! Fale atë që të bën keq!” (ibn-i Hanbel, IV, 148, 158.)

Në vitin e shtatë hixhri, në Meke pllakosi një thatësirë dhe varfëri e madhe. I Dërguari Allahut i ndihmoi mekasit, pra ata që për njëzet vjet e kishin luftuar kafshërisht, duke u dërguar atyre ar, elb dhe hurma. Pasi i mori në dorëzim këto ndihma, Ebu Sufjani ua shpërndau të varfërve Kurejshit.

Njeriu, mundet nga mirësia, bujaria dhe mirësia zbut madje edhe armiqësinë e armikut. Nga dhurimi që profeti u bëri të varfërve të Mekës, edhe në zemrën e Ebu Sufjanit u zbut ashpërsia dhe armiqësia që ushqente. Kënaqësinë që ndjeu, ai e shprehu me këto fjalë:

“Allahu e shpërbleftë me të mira djalin e vëllait

tim, sepse ai u kujdes për të drejtën e të afërmeve!” (Ja’kubi, Tarih, II, 56.)

Përballë këtyre mirësive dhe virtyteve të larta njerëzore që profeti Muhamed (a.s.) gëzonte në genien e Tij, shumë njerëz u nderuan me Islam.

Edhe Jusufi (a.s.) është një shembull shumë i mirë në lidhje me këtë temë. Edhe pse vëllezërit e tij e hodhën në pus, ai u tregua bujar ndaj tyre, nuk ua përplasi fytyrës gabimin, por i fali. Duke u prekur nga kjo, ata thanë:

“Betohemi për Allahun, vërtet që Allahu të ka ngritur ty mbi ne dhe ne paskemi qenë vërtetë të gabuar.” (Jusuf, 91.)

Për t'i drejtuar njerëzit drejt Zotit dhe drejt mirësisë duhet gjetur damari që kalon nga zemra. Dhe rruga më e shkurtër e kësaj është bujaria, dhembshuria e të falurit. Pra, të mund t'i dhurohen këto virtyte krijesave të Allahut.

Për t'u ngritur në nivelin e një besimtari të arrirë si dhe për të merituar dashurinë e Allahut, duhet ta bartim vazhdimisht në zemër **“frikën ndaj Tij”**, nuk duhet ta braktisim asnjëherë **drejtësinë**, si në gjendje zemërimi ashtu edhe në gjendje pëlqimi, duke qenë **të kujdesshëm dhe të matur** si në gjendje varfërie ashtu edhe në gjendje pasurie, duhet të dimë të dhurojmë në rrugë të Allahut brenda mundësive tona ekonomike; **nuk duhet t'i ndërpresim marrëdhëniet farefisnore me të afërmit**, por duhet të tregohemi **bujarë** qoftë edhe ndaj atyre që s'janë treguar të tillë ndaj nesh, si dhe **të mund ta falim** me zemërgjerësi edhe **atë që na dhunon**.

Allahu (xh.sh) na bëftë nga robërit që kanë fituar pëlqimin e Tij dhe që i binden pa bërë asnjë lëshim, ashtu sikundër ndjek hija të zotin e saj, duke zbatuar urdhrat dhe këshillat e të Dashurit më të Moralshëm! Na dhëntë moralin e të Dërguarit të Tij, të cilin vetë e pajisi me moral të lartë e të shëndoshë, duke e bërë Personalitetin Shembullor për tërë njerëzimin, dhe na përfshiftë në bashkësinë e robërve mirëbërës që dëshmojnë (dëshmitarë) Atë!

Amin!



Mr. sci. Flamur Sofiu

Sanksionet dhe masat ndëshkuese për vrasjen dhe vetëvrasjen në të drejtën islame

Sheriati islam është i vetmi shariat i përkryer dhe pa të meta, arsye që mbështetet në faktin se ligjet dhe vendimet e këtij shariati i ka përcaktuar Allahu i Lartësuar. E drejta islame ka përcaktuar sanksionet dhe dënimet në lidhje me fenomenin e vrasjes dhe vetëvrasjes, dënime, të cilat janë shumë të ashpra e madje mund të jenë edhe fatale për ata që kryejnë vepra të tilla. Ligjet islame janë në dobi të muslimanëve dhe të mbarë njerëzimit, ngase të gjitha ligjet e caktuara nga Krijuesi janë në dobi të njeriut, pavarësisht nëse njeriu është apo jo në gjendje të kuptojë urtësinë e ligjeve të shariatit islam. Prandaj, e drejta islame i ka kundërshtuar që kur vrasjen dhe vetëvrasjen, duke e konsideruar këtë lloj mëkati një nga më të rëndët, duke përcaktuar dënim shumë të ashpër në botën tjetër, si dhe sanksione e

masa ndëshkuese shumë efektive në këtë botë.

Duhet theksuar se shejtani gjithmonë mundohet të ndikojë për keq tek njeriu dhe veçanërisht në çështjen e mbytjes së tjetrit apo të vetvetes, duke futur tek mbytësi bindjen se, nëse e kryen këtë akt të ndaluar do të lirohet nga telashet e jetës. Kështu, duam t'i rikujtojmë personave të tillë se me kryerjen e kësaj veprë të rëndë telashet nuk përfundojnë, por përkundrazi fillojnë, për të pasuar me një dënim shumë të ashpër dhe të dhimbshëm në botën tjetër. Gjithashtu duhet pasur parasysh, se nëse goditet nga ndonjë fatkeqësi apo ndonjë telash në këtë jetë, besimtari duhet të durojë dhe ta përballojë të keqen. Ai duhet të kërkojë shkaqet e së keqes që e ka goditur, që të mund të shpëtojë prej saj. Ai

që e ka frikë Allahun duhet të ruhet nga ky mëkat i madh. E jo vetëm kaq, por duhet të frikësohet nga hidhërimi i Allahut dhe nga dënimi i Tij.

Ajetet dhe hadithet që ndalojnë vrasjen e tjetrit dhe vetëvrasjen

Ajetet që flasin për këtë dukuri janë të shumtë. Po përmendim disa prej tyre:

1. *"Nuk bën që besimtari të vrasë besimtarin, përveçse gabimisht. Kush vret një besimtar gabimisht, duhet të lirojë një besimtarë të robëruar dhe t'u paguajë gjakun trashëgimtarëve të të vrarit, përpos rastit kur familja e të vrarit ia fal gjakun. Nëse i vrari është nga një popull që e keni armik e njëkohësisht është besimtar, duhet të lirohet një besimtar i robëruar. Nëse i vrari është nga një popull me të cilin ju keni lidhur marrëveshje, i duhet paguar gjaku familjes së tij, duke liruar edhe një besimtar të robëruar. Ai që s'mund të gjejë rob, duhet të agjërojë dy muaj rresht. (Kjo është bërë) në shenjë pendimi para Allahut. Se Allahu është i Gjithëditshëm dhe i Urtë."* (En-Nisa: 92.)

"Kushdo që vret një besimtar me qëllim, ndëshkimi i tij është Xhehenemi, në të cilin do të qëndrojë përgjithmonë. Allahu është zemëruar me atë, e ka mallkuar dhe i ka përgatitur një dënim të madh." (En-Nisa: 93.)

2. *"Mos ia merrni jetën njeriut, gjë që Allahu jua ka ndaluar ta bëni, përveçse kur e kërkon e drejta! Nëse dikush vritet padrejtësisht, Ne i kemi dhënë pushtet trashëgimtarit të tij (të kërkojë shpazim). Por edhe ai të mos e teprojë në vrasje, sepse ai është i ndihmuar (nga ligji dhe drejtësia islame)." (El-Isra: 33.)*

3. *"...dhe mos vritni veten (dhe njëri-tjetrin)! Vërtet, Allahu është i mëshirueshëm me ju."* (En-Nisa: 29.)

4. *"...dhe që të mos ia merrni tjetrit jetën, të cilën Allahu e ka shenjtëruar, përveçse kur e kërkon drejtësia (e ligji). Këto ju porositi Ai, me qëllim që të kuptoni."* (El-En'am: 151.)

Hadithet që trajtojnë këtë tematikë janë të shumtë dhe ne po citojmë këto:

1. Në koleksionin e Buhariut dhe Muslimit gjendet ky hadith: *"Kush hidhet prej kodrës dhe mbyt veten, ai do të jetë përgjithmonë në zjarrin e xhehenemit. Kush pi helm dhe e mbyt vetveten, ai do të mbajë në dorën e tij helmin (në xhehenem) dhe kështu ai do të qëndrojë përgjithmonë në xhehenem. Kush e mbyt veten me hekur, me atë hekur do t'i mëshojë pa ndërprerje barkut të tij dhe do të jetë përgjithmonë në xhehenem."*

2. Transmetohet në sahihun e Muslimit nga Xhabir bin Sumrete (r.a.) se *"E kanë sjellë tek i Dërguari (s.a.v.s.) një njeri i cili e kishte mbytur veten me shigjetë dhe Ai nuk ia kishte falur këtij njeriu namazin e xhenazes (i Dërguari (s.a.v.s.)."*



3. *"Kush mbyt veten e tij me ndonjë gjë, ai do të dënohet me po atë gjë në ditën e kiametit."*

Kategoritë e vrasjes dhe masat ndëshkuese

Sipas Medh'hebit hanefitë vrasja kategorizohet në këto kategori:

1. Vrasje me paramendim

Vrasja konsiderohet me paramendim, kur dikush godet tjetrin me armë apo me ndonjë mjet që shkakton vdekjen, si: p.sh.: shpata, sëpata, thika etj., goditje pas së cilës personi vdes.

Vrasja me paramendim duhet të plotësojë këto kushte:

- I mbyturi të jetë njeri i gjallë dhe që gjaku i tij të jetë i siguruar sipas sheriatit islam.
- Mbytja të shkaktohet nga dora e dikujt në mënyrë të drejtpërdrejtë.
- Mbytësi të ketë për synim mbytjen.

Vrasja me paramendim konsiderohet një prej mëkateve të mëdha, kështu që mbytësi dënohet në mënyrë shumë të ashpër në ahiret. Po ashtu, mbytësi do të ekzekutohet, nëse këtë e kërkon familja e viktimës dhe nëse familja e viktimës nuk kërkon ekzekutimin e vrasësit, atëherë ajo ka

"Kushdo që vret një besimtar me qëllim, ndëshkimi i tij është Xhehenemi, në të cilin do të qëndrojë përgjithmonë. Allahu është zemëruar me atë, e ka mallkuar dhe i ka përgatitur një dënim të madh."

(En-Nisa: 93.)

të drejtë të kërkojë kompensimin. Gjithashtu, si mbytje me paramendim konsiderohet edhe rasti kur dikujt i ndalohet ushqimi, uji, rrobat gjatë acarit, raste të ngjashme me këto. Vrasësi, që shkakton mbytjen e ndonjërit që është trashëgimtar, privohet nga trashëgimia.

2. Vrasje që i përngjan vrasjes me paramendim.

Një vrasje konsiderohet e tillë kur pason vdekja e ndokujt për shkak të lëndimeve trupore të kryera nga vrasësi, qofshin ato plagë të shkaktuara me dorë, apo me ndonjë mjet që në të shumtën e rasteve nuk shkakton vdekjen, si p.sh.: një thupër e thatë, një gur i lehtë etj.

Një mbytje e tillë konsiderohet mëkat i madh, por vrasësi nuk mbytet, e nëse familja e të mbyturit kërkon dëmshpërblim, duhet t'i paguhet dëmshpërblim i rëndë. Gjithashtu, kur vrasësi ka mbytur ndonjë trashëgimtar, atëherë privohet edhe ai vetë nga trashëgimia.

3. Vrasje pa dashje.

Me këtë nënkuptohet ajo vrasje që kryhet duke mos pasur për qëllim vrasjen, por ndodh pa dashje. Ky lloj i mbytjes përfshihet në dy kategori:

a. Kur dikush gjuan për ta mbytur gjahun, por godet pa dashje njeriun, apo mendon se personi të cilin po gjuan është në luftë kundër myslimanëve, por që më vonë vërehet se është mysliman.

b. Kur njeriu ka si qëllim të godasë gjahun, por godet njeriun pa dashje, ose ka për qëllim të godasë ndonjë njeri dhe godet dikë tjetër në vend të tij.

Vrasësi në këtë rast duhet të bëjë shpagimin e gjakut,

nëse familja e viktimës e kërkon këtë. Duhet të bëjë keffaretin (të lirojë një rob nëse ka mundësi dhe nëse për këtë nuk ka mundësi atëherë duhet të agjërojë dy muaj pa ndërprerje) dhe privohet nga trashëgimia, nëse viktimë është prej atyre që ka drejtë trashëgimie.

4. Vrasje e ngjashme me atë pa dashje.

Si vrasje e tillë mund të konsiderohet, kur dikush, duke fjetur, rrokulliset e bie mbi tjetrin dhe e mbyt.

Për këtë lloj mbytjeje vlejné të gjitha rregullat sanksionuese që zbatohen për kategorinë mbytjeje pa dashje.

5. Mbytja në rastet kur dikush bëhet shkak për vdekjen e dikujt.

Hapja e ndonjë grope, hapja e një pusi, e gjëra të ngjashme me këto, në rastet kur nuk i ka rrethuar dhe siguruar që të mos bjerë njeri brenda.

Si sanksion për këtë lloj mbytjeje është që personi, i cili e ka shkaktuar këtë vdekje të bëjë shpagimin e gjakut, por ai nuk quhet mëkatar, sepse ky nuk mund të konsiderohet as mbytës duke qenë se nuk ka pasur si qëllim një akt të tillë. Ky nuk privohet nga trashëgimia nëse viktimë është prej atyre që janë trashëgimtarë dhe nuk është i obliguar të bëjë keffaret (duke liruar një rob, e nëse për këtë nuk ka mundësi atëherë duhet të agjërojë dy muaj pa ndërprerje).

Norma e faljes së namazit ndaj atij që ka bërë vetëvrasje

Dijetarët islamë kanë mendime të ndryshme rreth faktit nëse lejohet t'i falet namazi i xhenazes atij që ka mbytur veten. Ne do të përmendim disa nga këto mendime:

1. Umer bin Abdulazizi (r.a.) dhe imam el-Euzaiu (r.a.) janë të mendimit se nuk duhet t'i falet namazi i xhenazes atij që ka mbytur veten. Këta e mbështesin mendimin e tyre në thënien e të Dërguarit (s.a.v.s.): *"E kanë sjellë tek i Dërguari (s.a.v.s.) një njeri i cili e kishte mbytur veten me shigjetë dhe Ai nuk ia kishte falur këtij njeriu namazin e xhenazes (i Dërguari (s.a.v.s.)."*

Sipas këtyre dijetarëve, nuk duhet t'i falet namazi i xhenazes atij që bën vetëvrasje, për shkak të mëkatit që ka bërë.

2. Dijetarët el-Hasani, en-Nehiju, Katade, imam Mali-ku, Ebu Hanifeja, Shafi'iu dhe shumica e dijetarëve, janë të mendimit se atij që ka bërë vetëvrasje duhet t'i falet namazi. Mendimin e tyre e mbështesin në faktin se i Dërguari (s.a.v.s.) nuk ia ka falur namazin e xhenazes atij që e ka mbytur veten, vetëm e vetëm që të nxjerrë në pah se sa mëkat i madh është fenomeni i vetëvrasjes, por përveç kësaj i Dërguari (s.a.v.s.) i ka urdhëruar sahabët që t'i falin namazin personit që kishte bërë vetëvrasje. Po ashtu, imam

Neveviu nga el-Kadij Ijadi ka thënë: “Pjesa dërmuese e dijetarëve janë të mendimit se i duhet falur namazi çdo myslimani, që vdes nga shkaku i zbatimit të sanksioneve të caktuara me sheriat, pra atij që është ekzekutuar me goditje me gurë ngase duke qenë i martuar ka bërë prostitucion, atij që mbyt vetveten dhe atij që është fëmijë i lindur prej prostitucionit.”.

Imam Ibn Abidin, në librin e tij “Ed-Derrul Muhtar” shprehet: “Kush mbyt veten qoftë edhe qëllimisht, duhet të lahet dhe t’i falet xhenazja dhe sipas këtij mendimi duhet të veprohet.”.

Mendimi mbizotërues për këtë çështje

Përveç faktit se vetëvrasja është një prej mëkateve të mëdha, shumica e dijetarëve janë të mendimit se personit të tillë duhet t’i falet namazi i xhenazes.

Po ashtu, duhet të nënvizojmë se mendimi i shumicës së dijetarëve është se përveçse duhet t’i falet namazi i xhenazes, duhet edhe të lahet si të gjithë njerëzit e tjerë që vdesin.

A do të qëndrojë përgjithmonë në xhehenem ai që vetëvritet?

Sipas mendimit të Ehlu Sunnetit dhe xhematit, as mëkatari i madh e as vetëvrasësi nuk do të qëndrojnë përgjithmonë në xhehenem, mirëpo Allahu i Lartësuar nëse dëshiron i dënon atë sa do e më pas i nxjerr nga dënimi i zjarrit të xhehenemit, ndërsa përse i përket asaj që përmendet në hadithin e të Dërguarit (s.a.v.s.), sipas të cilit vetëvrasësi do të qëndrojë përgjithmonë në xhehenem, duhet të kuptohet si një përhershmeri e përkohshme. (حلول مؤقتة)

Mallkimi ndaj atij që bën vetëvrasje

Nuk lejohet të mallkohet, por duhet t’i falet namazi i xhenazes dhe për të duhet t’i kërkohet sa më shumë falje dhe mëshirë Allahut të Lartësuar. Pra, pjesa dërmuese e dijetarëve mendojnë se duhet t’i falet namazi i xhenazes, sepse dihet qartë se namazi është lutje dhe kërkim falje.

A lejohet t’i shprehet ngushëllim familjes së atij që ka mbytur veten?

Shumica e dijetarëve janë të mendimit se lejohet t’i shprehet ngushëllim familjes së atij që ka bërë vetëvrasje, me arsyetimin se një njeri i tillë ka bërë një mëkat të madh, por nuk është bërë jobesimtar.

Varrimi i atij është vetëvarrë

Ai që ka bërë vetëvrasje duhet të pastrohet, të mbështillet me qefin, t’i falet namazi i xhenazes dhe të varroset në varrezat e myslimanëve, me arsyetimin se ky ka vdekur si mëkatari i madh, por jo si mosbesimtar. Edhe këtë, shumica



e dijetarëve e pranojnë.

Si përfundim mund të themi:

1. Mbytja e tjetrit dhe vetëvrasja janë prej mëkateve më të mëdha.
2. Dënimi për këtë fenomen është shumë i ashpër tek Allahu i Lartësuar.
3. Ai që mbyt veten apo tjetrin, do të mbetet nën vullnetin e Allahut, i Cili nëse do e fal, e nëse do e dënon.
4. Myslimani duhet të jetë i mbështetur krejtësisht te Allahu i Lartësuar dhe e ka urdhër të prerë të jetë durimtar ndaj çdo telashi e fatkeqësie të kësaj jete e kurrësi të mos bëjë vetëvrasje.
5. Sipas të gjithë dijetarëve, më e pakta që mund të thuhet në lidhje me fenomenin e vrasjes dhe vetëvrasjes, është: të gjithë bien dakord njëzëri se vepruesi i këtij akti është mëkatari i madh.
6. Myslimani duhet të largohet nga një akt i tillë dhe përveç kësaj duhet t’i këshillojë edhe të tjerët që të mos guxojnë as ta mendojnë një veprim të tillë e atë pak ta kryejnë.



Pse të përçarhemi?

Evans Drishti

Adhurimi i Krijuesit të gjithësisë nuk është tashmë diçka e pakuptimtë për kohën në të cilën jetojmë, për vetë faktin se liria e mendimit dhe ajo e veprimit u ndërthurën mes tyre, hulumtuan në shpirtin e mendjen e njeriut dhe hapën rrugë kthjellimi për të kuptuar më mirë se dje vetveten dhe rrethanat brenda të cilave jeton, duke u bërë pjesë e një shoqërie të caktuar me detyrime dhe objektiva të qarta për këtë jetë, në përgatitje të vazhdueshme për ahiretin. Adhurimi është diçka që nuk blihet me para, por megjithatë, edhe pse i tillë, mbetet përsëri enigmatik dhe si i pakuptueshëm në rrezatimet e tij të fshehta.

Fakti që besimi përbën mbi të gjitha një bindje shpirtërore, një vullnet të fuqishëm për të arritur diku, nisur nga çështje më e rëndësishme, pra që ky besim dhe ky vullnet shpirtëror ka ardhur i palëkundshëm nga brezi në brez, është një tregues mjaft domethënës i një uniteti ekzistues të një parimi të tillë nëpër breznitë ndryshme, unitet ky që pavarësisht rrethanave të ndryshme që sillen stuhitë historike, mbeti i palëkundshëm për qenien njerëzore.

Mbështetur në një nga parimet më jetike që na ofron Kurani Famëlartë nëpërmjet ajetit: **“Të gjithë besimtarët janë vëllezër me njëri-tjetrin”**¹, të parët tanë i qëndruan

besnikë me shpirt dhe me vepra këtij parimi, duke përcjellë tek njëri-tjetri unitetin e devotshmërisë dhe të solidaritetit, për më tepër duke i falur një pjesë të shpirtit të tyre fisnik vëllait të tyre besimtar, pasi vetë i dërguari i Allahut, Muhamedi (a.s.), e pati thënë:

*“Nuk është prej nesh ai që nuk mendon për vëllanë e tij besimtar atë që mendon edhe për vete.”*²

Të pakapshme dhe të pakuptimta ishin atëherë për ne edhe disa fraza që belbëzonin të parët tanë, por që me kalimin e kohës u bënë aq të njohura sa kuptuam edhe një tjetër anë të forcës dhe vullnetit të fortë që kishin si dhunti nga Krijuesi i gjithësisë. Ata e përshëndesnin njëri-tjetrin pikërisht me frazën domethënëse Islame: “Es-selamu alejkum” (Paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi ty). Duke qenë se besimi i tyre ishte i rrënjosur thellë në shpirtin, kjo përshëndetje ishte si një pikënisje e bashkëveprimit dhe e lidhjes rigoroze që kishin besimtarët ndërmjet tyre, ishte si një flad i lehtë pranveror që nuk pyeste për të nxehtë apo të ftohtë, pasi zemrat e besimtarëve të devotshëm rrihnin njëlloj si në dimër edhe në verë, përkushtimi i tyre ndaj Zotit nuk njihte stuhi apo furtunë, nuk njihte të nxehtin ekuatorial, nuk njihte

1. Huxhurat/10.

2. Buhari, Muslim.

breshër apo dëborë, po përkundrazi: ezani i namazit të sabahut deri tek ai i jacisë kishin të njëjtin mesazh.

Tesbihët e gjyshërve tanë, megjithëse të llojeve dhe ngjyrave të ndryshme, kishin të njëjtin kuptim dhe vlerë, përmendjen e Allahut, të madhështisë dhe plotfuqishmërisë së Tij, në çdo moment dhe kohë, pa dallim race, moshe apo vendi. Të gjithë besimtarët ishin të barabartë dhe në një unitet të paparë. Pavarësisht mundësive të ndryshme që u ofronte e përditshmja, ata përmendnin Allahun edhe në kohë të caktuar brenda një ecurie të caktuar, proces ky që u jepte një qetësi krejtësisht të ndryshme nga ajo që u ofronte e jashtmj. Universaliteti i Islamit nuk njihte kufij dhe me forcën e tij gjithëpërfshirëse trokiste në zemrën e çdo qenieje njerëzore, pavarësisht moshës apo problemeve të tjera, pasi paqja në vetvete ishte një forcë shprehëse dhe një vullnet i padiskutueshëm që e dëshironte çdokush që e quante veten njeri.

Kjo traditë nuk ishte vetëm për të parët tanë, ashtu siç e kuptoi gabimisht brezi i mëvonshëm i prindërve tanë, por ishte një mirësi dhe dhunti e Krijuesit të gjithësisë, e cila kishte vijuar për shekuj me radhë dhe fatmirësisht vijon edhe sot e kësaj dite.

Kështu, përveç pesë kohëve të namazit, të cilat Allahu i Lartmadhëruar ua bëri obligim besimtarëve, u dha edhe një mundësi tjetër për të qenë përsëri të bashkuar, duke u ofruar ditën e Xhuma si një tjetër tregues uniteti të pashoq për besimtarët e devotshëm. Megjithëse në mes të ditës, ezani Muhamedije i fton njerëzit në vendin e betejës, në vendin e lutjes, në vendin e paqes dhe të harmonisë, Zoti u hap përsëri dyert mbarë njerëzisë për të gjetur atë ngrohtësi të munguar gjatë asaj dite. Besimtarët mbledhen përsëri së bashku dhe përsëri në unitet. Shumë mendje të mbledhura në një të vetme, shumë botëkuptime dhe vizione që i nënshtrohen një botëkuptimi universal, shumë fytyra të ndryshme që dalin para një të Plotfuqishmi, sikurse gjyshja që mbledh nipërit dhe mbesat e veta për t'u treguar përrallën e radhës, por që këtë herë ajo që tregohet nuk është përrallë, por një e vërtetë e pamohueshme jo vetëm e njësisë së ekzistencës, por edhe e njohjes së të vetvetes, një mundësi më shumë për të kuptuar përkohshmërinë në këtë realitet marramendës. Ta pakuptimtat e deritanishme marrin një tjetër dimension domethënës për shumë mendje të pabarabarta.

Në fakt, kjo njësi fillon që në lindjen tonë si qenie të këtij universi, pasi ashtu siç mund ta kuptojmë më së miri, askush nuk lind bashkë me motrën apo vëllanë, me mikun apo të afërmin e tij. Gjithsecili prej nesh i thotë mirëmëngjes kësaj bote fillikat i vetëm, ashtu sikurse e

pa rrezën e diellit krejtësisht i vetëm, sepse i tillë erdhi në këtë jetë dhe natyrisht i tillë do largohet nga kjo jetë. Kështu, edhe frymëmarrja jonë është një e vetme, deri në momentin e frymës së fundit, siç pasqyrohet edhe në Kuranin Famëlartë, ku tregohet shumë qartë se në ditën e gjykimit të gjithë do të jenë të huaj për njëri-tjetrin, ku as prindi nuk do e njohë fëmijën e tij dhe as bashkëshorti bashkëshorten e vet.

Në fakt askush nuk na pyeti kur erdhëm në këtë jetë, por ishte përcaktimi hyjnor ai që e bëri të mundur një gjë të tillë. Askush nuk na pyeti se si duam të njihemi në këtë jetë, pra si të na thërrasin, por ishte dëshira dhe vullneti i prindërve tanë si dhunti hyjnore për të qenë ne këta që jemi sot.

Erdhëm në këtë jetë për një periudhë të përkohshme, për t'i dhënë lamtumirën përsëri kësaj jete pasi e vërteta do të jetë në botën tjetër, por është pikërisht kjo jetë ajo që na bën përgjegjes në përgatitjen për botën e përtejme, ku të gjithë do jemi përsëri së bashku, një grumbull i plotë, të gjithë të bashkuar dhe në unitet.

Islami predikon paqen dhe vëllazërimin mes njerëzve, duke na e ekspozuar më së miri në muajin e shenjtë të ramazanit, kur i madh e i vogël, i pasur e i varfër, pa dallim ngjyre apo race, pa dallim kombësie, ulemi gjithë së bashku në një sofër vetëm për një qëllim, për të fituar pëlqimin e Allahut, një tregues ky i mrekullueshëm i vëllazërimit dhe i unitetit mes besimtarëve.

Të gjithë myslimanët, kudo që ndodhen në rruzullin tokësor, pavarësisht nivelit të besimit, në mënyrë të vetëdijshme apo të pavetëdijshme, të vetëdijshëm apo jo, për shkak të shumë rrethanave bashkohen përsëri në unitet, në çdo punë që bëjnë në të përditshmen e tyre, duke shprehur frazën madhore **“Bismil-lahi Rrahmani Rrahim”**. (Në emër të Allahut, Bamirësit të përgjithshëm, Mëshiruesit, Mëshirbërësit) Këtë frazë e përmendim në çdo moment të ditës, në çdo kohë, për çdo punë apo veprim që bëjmë, duke treguar kështu lidhjen shpirtërore që kemi me Krijuesin e gjithësisë dhe në të njëjtën kohë duke pohuar me bindje të plotë se nuk jemi të pavarur në këtë jetë, se gjithçka ekzistuese në të ashtuquajturën “e jonë” është dhe mbetet “e Atij”.

A nuk e kuptojmë se ç'mrekulli!? Një mesazh unik për miliona mendje. Një shtëpi që zë miliona njerëz, një libër udhërrëfyes për miliona individë, ku të gjithë janë në një emërtim “besimtarë”, një Pejgamber udhëzues dhe një fe pa dallim race, kombi apo ngjyre. Ndërkohë që çdo gjë është një, një Krijues, një libër i shenjtë, një Pejgamber, një fe, pse të përçahemi?



Teuhidi në vargjet e Hafiz Jusuf Këlmendit

Muhamed Sytari

[“Ilahina shqip”- Rreshtue prej Haxhi Hafiz Jusuf Këlmendit, Imami xhamis Perashit përveçtëm, n’ Shkodër.] Kështu shkruhet mbi broshurën e shtypur në 32 faqe, pa vit e pa vend botimi. Ajo përbëhet nga pesë ilahi në gjuhën shqipe me shkrim arab, nga Haxhi Hafiz Jusuf Këlmendi (1876-1943) (sikurse sqarohet edhe në kokën e saj) dhe përmban 343 var-

gje, të ndara në 171 strofa dhe një varg.

Në dy strofat e para të ilahisë së parë të veprës së tij, autori (një prej dijetarëve të shquar të Shkodrës), tërheq vëmendjen e lexuesit drejt **teuhidit**. Ato bëjnë fjalë për Njësinë e Zotit, si baza kryesore e besimit islam. Ja si shprehet ai në këto vargje:

**Elif- I pari n’sharte turqnís
Zotit imân mej prû
Nji, ka ardh pej Perendís
me Kur’an na asht kallxu**

**Be- Bytyn xhin e insân
me kyt emër jan urdhnu
Me bâ tasdík me kemâl
hem me njôh me bisedu**

Nëpërmjet këtyre vargjeve autori bën me dije lexuesin se argumentimi i thënieve të tij bazohet në Kuranin Famëllartë.

Në këtë pikë referimi, ajetet kuranore që vërtetojnë Njësinë e Allahut dhe bëjnë fjalë për të, janë të shumta, sikurse dhe hadithet e ndryshme të Resulull-llahit (a.s.). Duke hedhur një vështrim serioz rreth kësaj teme në Librin e Allahut, do të gjejmë fakte të shumta që tërheqin vëmendjen e njerëzimit drejt Njesisë së Krijuesit të gjithësisë. Le të përmendim disa prej tyre:

- “Zoti juaj është *një Zot i vetëm!*”

- “Allahu është *vetëm një Zot* - qoftë lavdëruar Ai! Ai është tepër i lartësuar për të pasur fëmijë.”

- “Pa dyshim, janë jobesimtarë ata që thonë: ‘Allahu është njëri prej Trinisë!’ Nuk ka veçse *një Zot të Vetëm të vërtetë!*”

- “Ky (Kuran) është shpallje e qartë për njerëzit, me qëllim që ata të marrin paralajmërim nëpërmjet tij, që ta dinë se *Allahu është Një Zot i vetëm* dhe që të këshillohen njerëzit e mençur!”

- “Zoti juaj është *një Zot i vetëm.*”

- [Allahu ka thënë: “Mos adhuroni dy zota, sepse Ai është *një Zot i vetëm*, prandaj frikësohuni vetëm prej Meje!”]

- “... më është shpallur se Zoti juaj është *një Zot i vetëm.*”

- [Thuaj: “Mua më është shpallur që Zoti juaj është *një Zot i vetëm*; pra, a jeni myslimanë?”]

- “Zoti juaj është *një Zot i vetëm*, prandaj vetëm Atij përuljuni.”

- [Thuaj (O Muhamed!): “Në të vërtetë, unë jam një njeri si ju. Mua më është shpallur se Zoti juaj është *një Zot i vetëm*, prandaj ecni në rrugën e drejtë që të çon tek Ai dhe kërkoni falje prej Tij!”]

Përfundimisht, duke u bazuar në Kuranin Famëllartë, ne si myslimanë besojmë se Zoti i gjithësisë është Një, i Vetëm, pa shok, pa partner, pa bir e pa bijë, që nuk ka lindur prej kujt dhe as ka lindur ndokush prej Tij!

“Allahu vërtetoi se *nuk ka zot tjetër përveç Tij*, e dëshmuar edhe melekët e dijetarët dhe se Ai është Zbatues i drejtësisë. Nuk ka zot përveç Tij, Fuqiplotit e të Urtit.”

Nga këtu themi se *njësimi i Allahut, teuhidi*, është baza kryesore mbi të cilën ngrihet besimi dhe feja is-

lame. Dijetarët e akides islame, teuhidin (njësimin), e kanë përkufizuar si: “***Njësimi i të adhuruarit me adhurim, me besimin dhe bindjen në njësinë e Tij dhe vërtetimin e tij (njësimin), substancialisht, cilësisht dhe me vepra.***”

“Për njësinë e Allahut themi se me të vërtetë Allahu është Një, nuk ka shok, nuk ka send si Ai, nuk ka asgjë që mund ta pengojë Atë dhe nuk ka Zot tjetër përveç Tij. Ai është i përhershëm, pa fillim dhe pa mbarim. Nuk zhduket dhe as asgjësohet. Nuk mund të ndodhë ndonjë gjë tjetër, përveç asaj çka dëshiron Ai. Atë nuk mund ta përthekojë dot imagjinata dhe as mendja e njerëzve nuk mund të arrijë ta kuptojë se si është Ai...”

“Ai është Një, nuk ka lindur prej dikujt dhe as ka lindur kënd. Ai nuk ka partner dhe Atij nuk mund t’i bëhet rival askush në krijimin dhe sundimin e Tij.”

Transmetohet nga sahabiu Beride (r.a), se një ditë Profeti (a.s.) dëgjoi një burrë duke u lutur: “Allahumme, unë të lutem Ty duke dëshmuar se Ti je Allahu, *nuk ka Zot tjetër përveç Teje*, i Vetmi, i Përhjetshmi, që nuk ka lindur prej kujt, as ka lindur kush prej Tij dhe askush nuk është i barabartë me Të”. Pastaj Profeti (a.s.) tha: “Pasha Atë që shpirtin tim në dorën e Tij, ai i është lutur Allahut me emrin e Tij më të madhërishtëm; kur i lutet me këtë emër, Ai përgjigjet, dhe po t’i kërkohet, jep.”

“Besimi në Allahun e çliron njeriun nga zinxhirët e materializmit. Ai lartësohet mbi pasionet dhe nuk pyet për interesat personale a të kundërtën e tyre! Njeriu besimtar punon për veten, ymetin dhe për mbarë njerëzinë, brenda ligjeve të së vërtetës dhe traditave të bamirësisë.”

Besimi në Allah është garancia më e mirë për njeriun në jetën e tij, përballë çdo pasigurie dhe pengese. Si jo, kur: “Allahu është mbikëqyrës i atyre që besuan, i nxjerr ata prej errësirave në dritë. E kujdestarë të atyre që nuk besuan janë djajtë që i nxjerrin ata prej drite e i hedhin në errësirë. Ata janë banorë të zjarrit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë.”

Vlera e shkencës dhe e teknologjisë në Islam

Ma. Artur Tagani

Shkenca dhe teknologjia janë vlerësuar dhe nxitur gjithnjë në fenë Islame. Udhëheqësit myslimanë kanë përkrahur dhe motivuar shkencëtarët në kërkimet e tyre shkencore. Një nga Kalifët, Hz. Aliu (r.a.) ka thënë: *“Arij që më mëson një fjalë, i bëhem shërbëtor për dyzet vite”*.

Vlera e shkencës dhe e teknologjisë në Islam mund të analizohet në këto pika:

1. Shkenca dhe e vërteta

Sipas besimit Islam, shkenca dhe teknologjia ndihmojnë për të treguar të vërtetën e gjërave dhe për t'i njohur ato. Feja Islame ka mbrojtur idenë se shkencëtari duhet të jetë sa më objektiv në studimet e tij. Gjithashtu, paralajmëron se ai nuk duhet t'i përziejë paragjykimet dhe ideologjitë e tij në rezultatet shkencore.

2. Dobia e shkencës

Dobia e shkencës dhe e teknologjisë është përmen-
dur shpeshherë si në Kuran dhe në hadithe. Është bërë e ditur në mënyrë të qartë se toka dhe qielli janë krijuar në shërbim të njeriut. Shkencëtari duhet të udhëhiqet gjithmonë nga qëllimi për të punuar në shërbim dhe në dobi të njerëzimit. Argumenti më i qartë i kësaj është hadithi: *“I mbështetem Allahut ndaj diturisë së padobishme.”* Ndërkohë, janë kritikuar të

diturit që nuk veprojnë me diturinë dhe që e bëjnë të padobishme atë, madje ata janë krahasuar me gomarë që bartin ngarkesë në shpinë. (Xhuma'a, 5.)

3. Synimi i shkencës

Objektivi i largët i shkencës dhe i teknologjisë në Islam është që ta orientojë njeriun drejt autoritetit të Zotit. Në shumë hadithe dhe ajete, në mënyrë direkte apo indirekte është përmendur se një shkencëtar objektiv dhe i pakushtëzuar në shkencën e tij, mund të arrijë ta kuptojë ekzistencën dhe njësinë e Zotit.

Në shumë ajete të Kuranit është shpjeguar se të gjitha krijesat e gjithësisë përbëjnë “fakte” dhe “shenja” të ekzistencës së Allahut. Shkencëtarët që i vërejnë këto, ata të cilët deshifrojnë enigmat që ndodhen në to, mund të arrijnë të kuptojnë ekzistencën e Zotit. Shkencëtari i vërtetë qaset më pranë idesë së qenies së Zotit, kur kupton pafuqinë dhe dobësinë e tij para mjeshtërisë artistike dhe enigmatike në strukturën e krijesave. Prandaj, në Kuran thuhet: *“...Në të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët...”* (Fatir, 28.)

Nga ana tjetër, në shumë ajete Allahu i ndalon të flasin për Ekzistencën dhe Njësinë e Tij njerëzit që nuk kanë dituri. *“Disa njerëz diskutojnë për Allahun pa kurrfarë diturie, pa udhërrëfyes dhe pa Libër ndriçues.”* (Haxh, 8.)

Pra, dituria është kusht si për të njohur Zotin, si për të diskutuar rreth Zotit, ashtu edhe për t'i ftuar njerëzit në Islam. Shkenca sipas Kuranit nuk përfshin vetëm dituritë religjioze, por çdo lloj fushe dhe diturisë njerëzore.

Në fakt, kohët e fundit shkenca dhe teknologjia po marrin një trajtë të frikshme. Sot njerëzit po përdorin shkencën dhe teknologjinë si armë, si ideologji. Njerëzit po kërcënohen prej armëve dhe reaktorëve nuklearë, po ndotin dhe po prishin në një mënyrë të papërgjegjshme natyrën, si pasojë e së cilës bota sot po përjeton prishjen e ekuilibrit të saj. Me të drejtë njerëzit perceptojnë diçka negative apo të frikshme, sa herë që flitet për teknologjinë dhe shkencën.

Mirëpo, sidoqoftë, shkenca është e mirë në vetvete. Nëse ne s'i krijojmë gjallëri në çdo disiplinë të shkencës dhe arrijmë fuqinë e të folurit nëpërmjet shkencës, do të arrijmë sërish ta shndërrojmë shkencën në shërbim të lumturisë së njerëzve.

Brez pas brezi myslimanët e kanë përcjellë rëndësinë e formulës së një sistemi të shkencës dhe të etikës, duke ditur se këto janë të dobishme materialisht dhe shpirtërisht për njerëzit dhe se prej tyre nuk dëmtohet askush. Myslmanët e kanë përfshirë shkencën brenda etikës. E kanë ditur që atomi është zjarr, e kanë ditur dhe përbërjen e tij, por jo vetëm që nuk e kanë përdorur atë si ferr për njerëzit, por nëpërmjet tij janë munduar të shpjegojnë ekzistencën dhe njësinë e Allahut. Fjala vjen, Xhelaledin Rumi (v. 1273) që prej shekujsh e ka shpjeguar në mënyrë simbolike shpërbërjen e atomit: *"Nëse e ndan një atom, në mes do shohësh një Diell dhe përreth tij do vësh planetë që sillen pa u ndalur"*. Një tjetër mistik Islam, Davudu'l-Kajseri (v.1350) ka shprehur se esenca e atomit dhe e natyrës është energji. Ata nuk dëshironin t'i nxisnin njerëzit që të hynin në dyshime me këto mendime, as të merreshin me shpërbërjen e atomit, sepse nuk bëhej fjalë për probleme energjetike. Qëllimi i tyre ishte vetëm të thuhet një e vërtetë lidhur me përbërjen e materies dhe të gjithësisë.

XHABIR BIN HAJJAN



Xhabir Bin Hajjani mendohet të ketë lindur në Tus/Iran në vitin 721. Ai njihet si themeluesi i kimisë dhe i alkimisë Islame. Lidhur me jetën e tij ka pak të dhëna. Vitet e para i kaloi në Tus dhe mësimet e para i mori po aty. Më pas bëri disa udhëtime në gadishullin arabik. Më pas u vendos në qytetin Kufe. Shumicën e jetës së tij e kaloi në këtë vend, i cili në atë kohë ishte një qytet studimesh shkencore. Pas disa vitesh u transferua në Bagdad dhe si fillim mori famë në sarajin e Harun er-Rashidit. Ai mori pjesë në mësimet e Xhafer es-Sadikut, pasi Xhabiri ishte edhe një mistik Islam. Në vitin 815 mendohet të ketë vdekur në Bagdad. Sado që atij i atribuojnë 3000 vepra, vetëm një pjesë e tyre e vogël janë të tijat. Shumë vepra të tij janë përkthyer edhe në latinisht, nëpërmjet të cilave fitoi famë në Perëndim me emrin Geber dhe për shekuj me radhë ushtroi ndikim të fortë në botën perëndimore. Ai ka mjaft vepra, si në kimi e alkimi, po ashtu edhe në logjikë, filozofi, fizikë, mekanikë e mjekësi. Disa prej këtyre veprave janë: Kitabu's-sunduki'l-hikme, Kitabu'l-Mulk, Kitabu'r-Rahmeti's-Sagir, Kitabu'l-Mevazini's-Sagir, Kitabu'l-Arsi'l-Haxhar, Kitabu'l-Nari'l-Haxhar, Ketul fi'l-Xhism ve'l-Xhevher ve'l-Araz.

Xhabiri njihet si një nga përfaqësuesit më të mëdhenj të kohërave në kimi dhe alkimi. Ai ndoshta është i pari që ka ndërtuar një laborator kimie, i cili u pat gjetur në shtëpinë e tij, dyqind vjet pas vdekjes. Xhabiri e konsideronte kiminë si një shkencë eksperimentesh dhe jo teorie. Ai ishte themeluesi i njërës prej dy shkollave të kimisë që kishte bota Islame. Ai bën klasifikimin e lëndëve kimike, të cilat i ndan në tre grupe. Xhabiri është edhe zbuluesi i acidit nitrik dhe sulfurik, si dhe ka kontribuar në teknologjinë e kimisë, duke shpikur enë e vegla të ndryshme për operimet kimike, furra kimike dhe distiluese.

Teqja Xhelvetije në Berat

Në këtë numër do të flasim për ekzistencën e teqesë së një shkolle mistike jo shumë të njohur në Shqipëri. Ajo shkolla msitike e xhelvetive, e cila u formua nën mësimet e përshpirtshme të udhëheqësit shpirtëror Aziz Mahmut Hydaji.

Albanologu i njohur Franz Babingeri flet në veprat e tija për ekzistencën e një teqeje që i përkiste këtij riti në vitet e para të shekullit të XX. Mesa duket Babingeri kishte parë rrënojat e kësaj teqeje dhe kishte mësuar nga të pranishmit se cilit tarikat i takonte ajo.

Ndërkaq një vakëfname që gjendet në dosjet e fondit të Sherijes së Beratit, në arkivin e shtetit shqiptar vërteton prerazi ekzistencën e një teqeje të tillë. Përpara se të flasim për dokument në fjalë do të japim të dhëna të shkurtra për themeluesin e tarikatit xhelveti Aziz Mahmud Hydaji.

Themeluesi i tarikatit xhelveti Aziz Mahmud Hydaji ka qenë një nga prijësit e mëdhenj shpirtërorë të Stambollit të periudhës osmane. Emrin e vërtetë e ka patur Mahmud. Emri i dytë, Hydaji, që do të thotë i perëndishëm ose hyjnor, është, në fakt, një atribut. Si ky, ashtu dhe atributi tjetër Aziz që do të thotë i shenjtë ose shenjtor, i janë dhënë më vonë.

Ai lindi në qytezën Koçhisar të Turqisë në vitin 1541 dhe e kaloi fëmijërinë në Sivrihisar. Ai ka jetuar afro një shekull dhe ka njohur periudhat e sundimit të tetë sulltanëve! Hirësia Hydaji zotëronte një shkallë të shkëlqyer në fushat e diturive fetare, tasavvufit (mistikës islame) dhe letërsisë.

Sipas kërkesës së shehulislamit **Hoxha Sadedin Efendiut**, Hydaji u vendos në Stamboll. Dergahu që ngriti ai në Yskydar, brenda një kohe të shkurtër u shndërrua në një shkollë kulture shpirtërore që i drejtohej çdo njeriu të çdo sh-trese. Ajo tërhoqi konsideratën dhe interesimin e sovranëve botërorë. Ajo i përfshiu edhe ata mes dervishëve të saj. Veçanërisht, sulltanët **Murati III, Ahmeti I, Osmani i Ri II** dhe **Murati IV** merituan udhëzimin konfidencial të Hirësisë Hydaji. Aziz Mahmut Hydaji vdiq në vitin 1628.

Vakëfnameja është hartuar nga Kapllan pasha, mytesarifi me arpallëk i Vlorës, në dhjetëditëshin e parë (evail) të muajit korrik të vitit 1806 (xhumadel evel 1221 H). Sipas kësaj vakëfnameje Kapllan pasha është njëkohësisht edhe personaleti me fondet e të cilit që ngritur zavijeja e tarikatit xhelveti në Berat, për mbarështimin e së cilës ai linte të ardhurat e mullirit që kishte në Mallkastër. Të ardhurat e kësaj zavijeje duhet të kenë qenë të konsiderueshme pasi që në ekonominë osmane të ardhurat e mullinjve që bluanin misrin kanë qenë ndër burimet me të ardhurat më të pasura dhe njëkohësisht më të taksueshmet. Dëshmitarë të këtij akti përmenden Ali beu, Mahmut beu, haxhi Mehmed efendiu, sehh Ibrahim efendiu, Sylejman efendiu, Mahmut efendiu, Abdullah efendiu, personi që mund të japë fetva Abidin efendiu, sekretari i thesarit Hasan aga, ke-thyda Hysen aga dhe të tjerë.

Një karakteristikë që haset edhe në dertimin e objekteve mistike në shqipëri, edhe në rastin e te-



qesë në fjalë, është që ato ndërtoheshin pranë objekteve të tjera të kultit xhamive apo medreseve. Në rastin e teqesë xhelvetije në Berat pranë saj u ndërtua edhe një shkollë e nivelit të parë (mek-tep), mësuesi i të cilës do të edukonte ata që vinin në teqe me mësimet bazë të fesë dhe të sheriatit islam. Shehu, mësuesi dhe myteveliu i teqesë kushtëzohen me anë të të vakëfnamesë që të lexonin cdo ditë tre herë suren Ihlas, në muajt rexheb, shaban dhe ramazan të këndonin Kuranin nga fillimi deri në fund (hatme) dhe sevapin që mund të fitohej nga kryerja e këtij riti fetar t'ia dhuronin shpirttrave të profetit Muhamed, familjes së tij të ndershme, sahateve, bamirësit që ndërtoi këtë teqe dhe familjes së tij.

Ashtu sic haset dhe qe traditë në vakëfnametë e periduhës osmane në to përfshihen mendimet e ndryshme të imamëve bazë të medhhebit hane-

fi, Ebu Hanifesë, Ebu Jusufit dhe Muhamedit në lidhje me vakfin dhe përsëritet mallkimi mbi ata që do të veprojnë në kundërshtim me rregullat e caktuara në këtë vakëfname nga ana e banirësit.

Është e njohur duaja që bënte Aziz Mahmut Hydaji:

“O Zot! Ata që, gjer në kiamet, do të jenë në rrugën tonë, që do të na duan ne dhe që një herë në jetë do të vijnë në tyrben tonë dhe do të këndojnë një Fatiha për shpirtin tonë, janë tanët... Ata që janë tanët, mos u mbytshin në det, mos pafshin varfëri kurrë në jetë, mos vdekshin pa besim, e marrshin vesh dhe e lajmërofshin qysh më parë vdekjen e vet dhe kufoma mos u rëntë e mos u humbtë në det!..”



Familja

Allahu i Lartësuar ka krijuar gruan dhe burrin të barabartë në aspektin njerëzor dhe në këndvështrimin e adhurimit. Të dy palëve u ka dhënë aftësi dhe mundësi për të përmbushur detyrat njerëzore dhe përuljen ndaj Zotit. Islami ka përcaktuar familjen, si vatër e lindjes, zhvillimit dhe plotësimit të tipareve njerëzore, martesën si rruga më e mirë e përmbushjes së këtyre tipareve dhe ka ndaluar rreptësisht çdo marrëdhënie jashtëmartesore.

Islami, si feja e fundit hyjnore, nuk ka përcaktuar asnjë kufi lidhur me përmasat e familjes, por e ka lënë këtë të lirë të përshtatet mbi bazën e kulturës, zakoneve dhe traditave të vendit. Kështu, sipas Islamit familja bërthamë dhe familja e gjerë kanë të njëjtën vlerë. Megjithatë përmasat e familjes, Islami nuk ka lënë pa përmendur rëndësinë e lidhjeve farefisnore, lidhje të cilat nuk duhen shkëputur, prishur apo dëmtuar për asnjë arsye. Këtë çështje e ka përforcuar me një sërë argumentesh:

“O besimtarë!- nuk ju lejohet të bëheni përdhunisht trashëgimtarë të grave dhe mos i pengoni ato me qëllim që t’ua merrni një pjesë nga dhuratave që ua keni dhë-

në, përveç nëse bëjnë gabime sheshazi. Jetoni e silluni mirë me to! Në qoftë se ato nuk ju pëlqejnë aq shumë, (duron!) sepse është e mundur që juve të mos ju pëlqejë diçka, por që Allahu në atë do t’ju sjellë shumë të mira.”
(Nisa 4/19)

Dijetarët e jurisprudencës Islame nisur nga shumë ajete dhe hadithe janë të mendimit se: “Nëse gruaja nuk ka dëshirë dhe nuk aprovon, burri nuk ka të drejtë të strehojë të afërmit, përveç fëmijëve të tij që nuk kanë arritur moshën madhore, edhe gruaja po ashtu nuk mund të strehojë askënd jashtë dëshirës dhe aprovimit të burrit.”

Sipas këtij mendimi, në shtëpi mund të strehohen fëmijët e vetë çiftit dhe fëmijët e secilit prej tyre (nëse kanë të tillë), përveç këtyre, strehimi i të afërmeve të tjerë është në varësi të dëshirës dhe aprovimit të secilës palë. Kjo do të thotë që Islami sheh me prioritet familjen bërthamë dhe nga ana tjetër lë dyert e hapura edhe për familjen e gjerë..

Televizioni dhe ndikimi i tij në formimin e fëmijëve

Një ndër temat aktuale që po diskutohet gjithnjë e më shumë gjatë viteve të fundit, është dhe ndikimi apo roli i televizionit në formimin e fëmijëve. Siç dihet, TV-esh-të media, e cila ndikon dhe arrin të depërtojë thellë në sjelljet dhe formimin e fëmijëve. Masa e këtij ndikimi është e lidhur ngushtë me faktin se si dhe sa shpesh përdoret ky mjet në raport me moshën e fëmijës.

Tv përbën një ndër gjetjet më të rëndësishme të historisë njerëzore në shekujt e fundit dhe nëse përdoret në mënyrë të kontrolluar, përbën vërtet një burim të madh informacioni për njerëzit. Me anë të transmetimeve është e mundur të ndjekim nga afër në një kohë të shkurtër ngjarje të rëndësishme që ndodhin në çdo vend të botës, por për fëmijët e moshës 0-3 vjeçare Tv ka një ndikim tjetër.

Duke pasur parasysh vështirësitë ekonomike-sociale, problemet psikologjike të pjesëtarëve të familjes, angazhimet e ndryshme për mirëmbajtjen e shtëpisë, vëmë re se koha që prindërit duhet t'u kushtojnë fëmijëve është tepër e kufizuar. Kjo sjell që fëmijët të përballen vetëm me pamjet fizike të prindërve të tyre. Periudha 0-3 vjeçare e fëmijëve përbën bazën e formimit të ndjenjave të tyre, moshë kjo në të cilën fillon edhe kontakti me botën që i rrethon. Ajo çka duhet të realizojmë në këtë periudhë është t'i përqafojmë shpesh, t'i lehtëtojmë, t'u themi fjalë të bukura, të luajmë me ta, t'u kushtojmë vëmendje dhe t'ua bëjmë të ditur se sa të çmuar janë për ne.

Parë në këndvështrimin e fëmijëve, koha që ata e kalojnë përballë Tv është tejet e varfër nga nxitjet dhe stimujt moralë e ndjesorë, kohë kjo, që i privon ata nga të qenit afër njerëzve që i rrethojnë dhe i duan.

Fëmijët e kësaj periudhe, në pamundësi të marrin pjesë në mjediset shkollore e sociale, nuk zotërojnë asnjë mundësi tjetër për të përmbushur këto mangësi, përveç ekranit të Tv.

Kjo është edhe arsyeja që disa fëmijëve të kësaj moshë si "pa e ditur" u mungon dëshira e komunikimit, shkathtësia, përqendrohen vetëm në një ambient, nuk



janë të ndjeshëm, flasin vonë etj., si pasojë shkaktohen anomali të ndryshme si "mbyllja në vetvete".

Ndërsa fëmijët e moshës 4-7 vjeçare duke iu shtuar rrethi shoqëror kanë arritur tashmë të pozicionohen dhe të krijojnë një përshtatje me mjedisin që i rrethon. Tashmë fëmijët e kësaj moshë kanë disa një mundësi zgjedhjeje mes Tv dhe lojërave me shokët, por, tek fëmijët e kësaj moshë problemi qëndron në faktin se nuk e kanë të zhvilluar mjaftueshëm inteligjencën abstrakte, si pasojë çdo gjë që shohin e konsiderojnë si të vërtetë. Sado që t'u thuhet se pamjet mbeten vetëm në kuadrin e një filmi, ata nuk arrijnë ta përceptojnë një gjë të tillë, duke ngjallur në mendje frikë, fakt ky që ndikon negativisht në zhvillimin e mëtejshëm të fëmijëve.

Për t'u ruajtur nga këto ndikime negative, prindërit duhet të tregojnë një kujdes të veçantë në përdorimin e Tv. Duhet ta konsiderojnë atë vetëm si një mjet informacioni masiv, por mund të zgjedhin edhe programe të tjera me tema të ndryshme edukuese, duke iu përshatur gjithnjë moshës së fëmijëve. Edhe pse në një masë të vogël, këto programe të kontrolluara do ndikojnë pozitivisht në formimin e fëmijëve. Me një fjalë, aq sa është i dëmshëm, Tv mund të jetë edhe i dobishëm, por gjithnjë nëse arrijmë të kontrollojmë çdo emision, duke pasur parasysh se ata që ulen përballë ekranit janë fëmijët tanë. Si përfundim, Tv përbën një faktor të jashtëm të rëndësishëm në formimin e fëmijëve.



Me TV dhe PC, fëmijë josocialë


Teknologjia dhe mjetet e reja të komunikimit si interneti apo celularët, janë mjete, të cilat gjithmonë e më tepër po i bëjnë fëmijët josocialë. Në një përfundim të tillë ka arritur një kërkim i realizuar në Universitetin e Çikagos.

Sipas tij, fëmijët të cilët kalojnë shumë kohë para televizionit dhe kompjuterëve janë më të prirur që të bëjnë një jetë më pak sociale, krahasuar

me të tjerët.

Studimi i publikuar në revistën "Pediatrics", i realizuar nga ekspertë të mjekësisë në Universitetin në Çikagos, të drejtuar nga Rosalina Richards, pohon se si adoleshentët të lidhur me ekranin e televizionit apo me përdorimin e tepër të kompjuterit, internetit, kanë më pak emocione.

Shpikje e rrallë Kompjuter i shpejtë sa drita



Në shumë pak vjet do të kemi në dispozicion kompjutera, të cilët do të jenë po aq të shpejtë sa drita. Këtë ide e kanë mbështetur kërkuesit e MIT.

Shkencëtarët kanë arritur të realizojnë lazerin e parë, i cili bën të mundur transmetimin e informacionit në lidhje me temperaturën e ambientit.

Ky është një hap mjaft i rëndësishëm, i cili bën të mundur zëvendësimin e këtyre lidhjeve me lidhjet tradicionale elektrike.

Këto do të bëjnë të mundur mbartjen e informacionit nëpër mikroçipe dhe do ta transmetojnë atë me një sasi më të madhe të dhënash dhe me një shpejtësi tepër të madhe.

Interneti tani... edhe në makinë

Në fillim ai mbërriti në shtëpitë tona, më pas në aparatet e celularit e tani duket se do të depërtojë edhe në makina, duke e shtrirë në këtë mënyrë përhapjen e tij kudo dhe në çdo moment të jetës sonë, përveç gjumit. Fjala është për internetin, i cili duket se do të bëhet edhe më i pandashëm për ne kur të "ecë" edhe ai mbi 4 rrotat e makinave. Sipas një studimi të realizuar nga firma "Strategy Analytics" parashikohet që deri në vitin 2016, afërsisht 90 për qind e makina-

ve të prodhuara në Amerikën Veriore dhe Europë, të jenë të pajisura me internet.

Ajo që mbetet problem, është fakti sesi interneti në makinë do të jetë në atë mënyrë që të mos dëmtojë vëmendjen e shoferit, duke i shkaktuar atij aksident rrugor nga pavëmendja.

Prandaj, mendohet që kjo të realizohet mes komandave të ndryshme virtuale, megjithatë ekspertët ende po punojnë mbi një fakt të tillë.

Pajisja I - Key do të zëvendësojë çelësat

Kompania Apple ka njoftuar se planifikon të zëvendësojë çelësat tradicional me një alternativë të teknologjisë së lartë.

Teknologjia I- Key është ende në zhvillim e sipër dhe falë saj përdoruesit nuk do të duhet të marrin me vete një sasi çelësash, por me një pajisje teknologjike do të mund të hapin dyert e automjetit, të hyrjes së banesës apo zyrës.

Informacioni për arritjen e re teknologjike të Apple është bërë publik, pasi kompania ka paraqitur kërkesën për të zotëruar e vetme patentën duke thënë se edhe seria më e re e celularëve do të mund ta përmbante këtë pajisje.

"Pajisja mund të komunikojë me një pajisje tjetër të jashtme për hapjen e bravave. Për shembull, kjo pa-

jisje do të mund të ishte modeli I-Phone", thuhet në kërkesën për patentë, të cilën Apple ia ka parashtruar zyrës amerikane për patenta.

"Pajisja e jashtme mund të jetë cilado pajisje përkatëse elektronike siç është një media player bartës apo bravë elektronike me anë të cilës mund të hapen dyert e shtëpisë, automjetit apo çfarëdo hapësire tjetër", thuhet në kërkesën për patentë.

IKey përdor teknologji të ngjashme me kartelat për hyrje dhe Apple shpreson se kjo pajisje do të heqë prej përdorimit numrin e madh të çelësve, që njerëzit marrin me vete, por edhe kartela për hyrje, të cilat sot i përdorin kryesisht kompanitë me numër të madh punëtorësh.

Këshilla për të kursyer karburant

Edhe nëse nuk keni mundësi të blini automjet, që harxhon më pak, ka mundësi të shumta për të kursyer të holla pavarësisht se çfarë veture përdorni.

Ja disa këshilla dhe njëkohësisht edhe disa shpjegime të paragjyqimeve, të cilat shumica e përdoruesve i kanë.

Kursimet më të mëdha të parave nuk vijnë për shkak të ndonjë risie teknologjike, por nga disa rregulla të vjetra: ndajeni udhëtimin me dikë. Nëse keni ndonjë mik ose fqinj, me të cilin mund të shkoni në punë dhe të ktheheni sërish me një veturë, kurseni 50% të harxhimit. Nuk ka asnjë mënyrë tjetër që do t'u kursejë aq para. Po ashtu, nëse familja juaj ka dy automjete, atëherë përdorni atë që harxhon më pak sa më shumë

që mundeni.

Edhe udhëtimi me trafik urban po ashtu mund t'ju kursejë. Kjo ndihmon gjithashtu edhe në uljen e ngarkesës në rrugë, në mënyrë që përveç vetes do tu ndihmojë edhe të tjerëve.

Ngarkesa në peshë është armik natyror i ekonomisë. Prandaj me largimin e sendeve të panevojshme, ose edhe personave, nga vetura juaj kurseni edhe karburant.

Që në nisje, ju mund të kurseni karburant, duke marrë parasysh se ecni me shpejtësi apo ngadalë. Nisja e menjëhershme rrit harxhimin e karburantit në mënyrë të pabesueshme.



Shëndeti

Mjeksi

Xhel për kurimin e plagëve në kokë

Një xhel i krijuar nga substanca natyrale dhe sintetike, që injektohet në tru mund të jetë në gjendje të stimulojë zonat e dëmtuara që të rikthehen në gjendjen e mëparshme.

Zbulimi vjen nga një ekip shkencëtarësh të Clemson University në Karolinën e Jugut, që kanë kryer

studime të financuara edhe nga Ministria e Mbrojtjes amerikane.

Xheli, i provuar deri tani te minjtë, mund të testohet te trupat njerëzorë brenda tre vitesh, duke i hapur kështu rrugë kurimit të plagëve në kokë.

Cigaret po vrasin 5 milionë njerëz

Një "helm" i vërtetë është ai i tymosjes së cigares, pasi është bërë e ditur se ajo tashmë e ka çuar në vdekjen e njerëzve, rreth një milion të tillë brenda një viti.

Një mesatare mjaft e frikshme kjo duke parë që në çdo 6 sekonda mund të vdesë një person në të gjithë botën dhe arsyeja e saj është pikërisht cigarja.

Këto kanë qenë fjalët me të cilën ka hapur deklaratën e saj, drejtorja e përgjithshme e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, Margaret Chan, e cila ka shprehur dëshirën e saj për një luftë të vërtetë kundër duhanit.

Ajo ka kërkuar që të merren masa të ashpra në drejtim të tij dhe të mos lejohet në shumë vende.



Ilaçet kundër depresionit në shtatzani "çmend" beben

Një studim i zhvilluar në Danimarkë ka treguar se foshnjat, veçanërisht djemtë, të cilët lindin nga nëna që marrin ilaçe kundër depresionit gjatë shtatzënisë, kanë një vështirësi më të madhe për t'u zhvilluar se të tjerët. Mesatarisht, thuhet se këta fëmijë janë në gjendje të ulen rreth 16 ditë me vonesë dhe të ecin një muaj më vonë se fëmijët e tjerë, por ndikimi prek edhe fushën e gjuhës, zhvillimit motorik si dhe aftësinë për të ecur.

Rezultatet e studimit të botuara në revistën "Pediatrics", kanë alarmuar shumë nëna, të cilat bëhen pre e shumë ilaçeve kundër depresionit gjatë periudhës së shtatzënisë.

"Nëse nëna është me depresion ose potencialisht vrasëse, ajo ka nevojë të kurohet me kujdes gjatë shtatzënisë", tha lidhur me një fakt të tillë, dr. Ashton.

Zbulime

Truri, ja proteina që zhdruk kujtimet

Nëse sjellim një person ndër mend dhe emrin e tij e kujtojmë me pak vështirësi, faji qëndron tek një proteinë e caktuar, e cilësuar RAC, e cila ka aftësi të largojë kujtimet, sidomos ato të shkurtra, të krijuara në trurin tonë. Zbuluar nga Yi Zhong në Laboratorin “Spring Harbor” (CSHL), e ashtuquajtura “proteina-fshirëse” është e dobishme për të hequr informata të tepërta apo jo aktuale nga truri ynë.

Kështu, në qoftë se rritet proteina në tru, hulumtuesit kanë treguar se shumë shpejt harrojmë informatat dhe anasjelltas, nëse RAC është reduktuar eksperimentalisht, kujtimet afatshkurtra arrijnë të mbeten të qëndrueshme për ditë të tëra.

Studimi u referohet kryesisht kujtimeve të tipit, kur harron ndonjë numër telefoni apo adresën e sapo thënë, pra kujtimet afat-shkurtra.

Këto gjëra ndodhin, por deri tani ishte menduar se ata ishin për shkak të harresës pasive, por hulumtuesit amerikanë kanë zbuluar se në fletoren tonë nervore informacioni rreth shërbimeve të shpejta është hequr në mënyrë aktive nga RAC.

Thuhet se mekanizmi ka edhe arsytet e tij: Ai na ndihmon që të mos përmbetet truri me shënime të panevojshme.

Kafeja, kush duhet ta pijë dhe kush jo

Dihet se një kafe na bën mirë të gjithëve, pasi na mban sytë hapur në orët e para të punës, kur nisemi në mëngjes, apo edhe në shëtitjet e mbrëmjes pasi jemi zgjuar nga dremitja e pasdites së orës 4-5. Ky të paktën është më shumë një konfirmim zakonor, i krijuar nga vetë njeriu, sepse po të jetë për shkencën, ajo nuk e rekomandon për të gjithë njerëzit pirjen e një kafeje ekspres në ditë.

Lajmi konfirmohet nga studiues italianë, sipas të cilëve, edhe vetëm një “ekspres” në ditë mund të ketë

efekt të dëmshëm në shëndetin e zemrës të një pjesë e popullatës.

Sipas tyre, një filxhan me kafe është i mjaftueshëm për të ngadalësuar qarkullimin e gjakut në zemër dhe vetëm një orë pas pirjes së kafes.

Prandaj, këta shkencëtarë rekomandojnë me fanatizëm se njerëzit që janë shumë të ndjeshëm ndaj kafeinës, nuk duhet të konsumojnë aspak pije që përmbajnë lëndë të tillë.

Duhanpirja pasive dëmton enët e gjakut

Fëmijët, të cilët i ekspozohen tymit të cigares, janë të rrezikuar që të zhvillojnë mbishtresa të rrezikshme në enët e gjakut- paralajmërojnë shkencëtarët finlandezë.

Veç dëmtimit të enëve të gjakut, të fëmijët që i ekspozohet tymit të duhanit, që nga mosha 13 vjeçare fillojnë të paraqiten edhe faktorë tjerë të rrezikut për sëmundjet e zemrës.

Të dhënat e publikuara në revistën *Circulation: Cardiovascular Quality and Outcomes*, janë grumbulluar

nga hulumtimi, i cili është bërë te 494 fëmijë të moshave ndërmjet 8 dhe 13 vjeç.

Është vërtetuar se fëmijët e ekspozuar ndaj duhanit, kishin prirje për nivel të lartë të apolipoproteinës B, faktor i rëndësishëm për praninë e të ashtuquajturit LDL-kolesterolit (kolesterolit të keq).

Erdogan pret Topallin: Vendet tona faktor stabiliteti në rajon

Pasi ka marrë pjesë në Samitin Botëror “Të drejtat e Grave lidhin lindjen me perëndimin”, kryetarja e parlamentit Jozefina Topalli është pritur veçanërisht nga kryeministri turk Erdogan. Në takimin mes tyre

është theksuar se Shqipëria dhe Turqia po kthehen në dy partnerë strategjikë dhe faktorë të rëndësishëm të stabilitetit dhe sigurisë në rajon.

Turqia: SHBA, pasoja nëse nuk bllokoi rezolutën për gjenocidin

Turqia ka paralajmëruar administratën e presidentit Obama për pasojë diplomatike negative nëse nuk e bllokoi një rezolutë që bën thirrje që ta quajë gjenocid vrasjen e armenëve nga turqit gjatë luftës së Parë Botërore.

Turqia menjëherë e ka thirrur ambasadorin e saj nga Shtetet e Bashkuara, pasi një panel i kongresit amerikan miratoi një rezolutë jo detyruese për çështjen në fjalë.

Në një konferencë për shtyp të zhvilluar të premten, ministri i jashtëm turk Ahmet Davutoglu tha se administrata amerikane nuk ka bërë përpjekje të mjaftueshme për të bllokuar një votim nga komisioni i dhomës së përfaqësuesve për politikë të jashtme. Ministri Davutoglu tha se ai pret që administrata amerikane të ndalë këtë rezolutë nga kalimi i saj për një votë të përgjithshme në dhomën e përfaqësuesve.

Megjithatë, ministri i jashtëm turk tha se Turqia është e vendosur të vazhdojë me përpjekjet e saj për të normalizuar marrëdhëniet me Armeninë, edhe pse Turqia kundërshton presionin e jashtëm lidhur me këtë çështje.

Turqia ka thënë se kjo rezolutë e akuzon atë për një krim që nuk e ka kryer. Zyrtarët gjithashtu kanë shprehur shqetësim se kjo masë mund të dëmtojë marrëdhëniet mes Shteteve të Bashkuara dhe Turqisë.

Shtëpia e Bardhë dhe Departamenti i Shtetit kanë kundërshtuar miratimin e kësaj mase, e cila tani do të hidhet për votim në dhomën e përfaqësuesve.



Parlamenti shqiptar miratoi në parim një rezolutë në mbështetje të procesit të liberalizimit të vizave



Në Shqipëri parlamenti miratoi në parim një rezolutë në mbështetje të procesit të liberalizimit të vizave. Rezoluta u miratua me votat e shumicës dhe opozitës, e cila hyri në sallën e parlamentit vetëm për të marrë pjesë në këtë pikë të rendit të ditës.

Për rreth dy orë palët u përfshinë në debate lidhur

me procesin, por edhe me disa pika të përmbajtjes së tekstit të rezolutës së propozuar nga Partia Demokratike, veçanërisht në pjesët ku sipas opozitës shumica lavdëronte punën e qeverisë së saj. Megjithatë, në fund palët ranë dakord që ta votojnë atë në parim, ndërkohë që përfaqësues të shumicës dhe opozitës do të punojnë për disa ndryshime në përmbajtje për të arritur në një variant të pëlqyeshëm për të gjithë.

Gjatë seancës, ministri i brendshëm Lulzim Basha bëri një prezantim të hapave të marrë nga Shqipëria në përmbushje të udhërrëfyesit të komisionit European për vizat. Ai deklaroi se autoritetet shqiptare i janë përgjigjur plotësisht detyrimeve që rrjedhin nga udhërrëfyesi.

Ekspertët European kanë përfunduar tashmë verifikimet për masat e marra nga Shqipëria dhe Komisioni European do të duhet të hartojë raportin e tij brenda muajit prill, për t'i kaluar më pas propozimin për vendim Këshillit dhe Parlamentit European.

Meta pritet me lule dhe valle në Preshevë

Gjatë vizitës së tij në Preshevë, Meta u prit nga kryetari i komunës, z. Ragmi Mustafa, kryetari i Kuvendit z. Skënder Destani, si dhe nga qindra qytetarë, të cilët kishin dalë për të pritur zyrtarin e parë nga qeveria e Shqipërisë. Meta së pari, zhvilloi një bisedë me zyrtarët e pushtetit lokal në zyrën e kryetarit e më pastaj mbajti një fjalim sallën e Kuvendit para këshilltarëve. Kryetari i Komunës së Presheves ndau një mirënjohje me z. Meta për vizitën e parë të një zyrtari në qytetin e Presheves. Gjatë takimit në zyrën e kryetarit të komunës, z. Meta i luti të pranishmit për një minutë përkujtim dhe heshtje për Kryeministrin e ndjerë Xhinxiç. Qëndrimi i Metës në Preshevë ishte i shkurtër për arsye se agjenda e tij vazhdonte edhe në Bujanovc. Gjatë qëndrimit në qytet ai u nderua me mirënjohje nga kryetari i komunës, z. Mustafa, për vi-

zitën e parë të një zyrtari nga qeveria shqiptare. Para nisjes drejt Luginës së Presheves, kreu i dikasterit të jashtëm zhvilloi një konferencë për shtyp në ambientet e ambasadës shqiptare në Beograd, ku zbuloi edhe një detaj. Meta tha se para vizitës në Serbi ka pasur një bisedë telefonike me Kryeministrin kosovar Hashim Thaçi, duke marrë mirëkuptimin e tij në lidhje me këtë çështje.

Ndërsa në intervistën dhënë për VOA, Meta preku edhe çështjen e akuzave të ish-kryeprokurores së Hagës, Karla Del Ponte, duke deklaruar se akuzat e saj janë të pabaza, por nga ana tjetër shprehu gatishmërinë e zhvillimit të hetimeve si një mënyrë për të vërtetuar se nuk ka asgjë të vërtetë në atë që thuhet.